IV – XXI

KOLANA: Dokumentet e Kishës Katolike

1. Karta e të Drejtave të Familjes
2. Bashkësia Familjare (*Familiaris Consortio)*
3. Kisha nga Eukaristia (*Ecclesia de Eucharistia*)
4. Rerum Novarum
5. Paqja në Tokë (*Pacem in Terris*)
6. Hyji është Dashuri (*Deus caritas est)*
7. Zhvillimi i popujve (*Populorum Progressio*)
8. Besimtarët laikë të Krishtit (*Christifideles laici)*
9. Sakramenti i dashurisë (*Sacramentun Caritatis)*
10. Lufta kundër korrupsionit
11. Dashuria në të Vërtetën (*Caritas in Veritate*)
12. Dinjiteti i Gruas (*Mulieris Dignitatem*)
13. Fjala e Zotit (*Verbum Domini*)
14. Dhuratë dhe Mister, Papa Gjon Pali II
15. Evangelii Nuntiandi, Papa Pali VI
16. Novo Millennio Ineunte, Papa Gjon Pali II
17. Besoj. Koment i shkurtër i Besojmës Apostolike, Imzot Angelo Massafra
18. Drita e Fesë (*Lumen Fidei*), Papa Françesku
19. Gëzimi i Ungjillit (*Evangelii Gaudium)*, Papa Françesku
20. Bashkësia Familjare (*Familiaris Consortio*) *(Ribotim*)
21. Fytyra e Mëshirës (*Misericordie Vultus*), Papa Françesku
22. Ti qofsh lëvduar (*Laudato si'*), Papa Françesku
23. Do t'ju jap barinj (*Pastores dabo vobis)*, Papa Gjon Pali II

24. Gëzimi i dashurisë (*Amoris Laetitia*), Papa Françesku
25. Mëshira dhe mëkatarja (*Misericordia et misera)*, Papa Françesku
26. Emri i Zotit është Mëshirë, Papa Françesku
27. Humanae Vitae (*Jeta njerëzore*), Papa Pali VI
28. Misteri dhe Dinjiteti i Gruas, Shën Gjon Pali II
29. Gëzoni e Galdoni (*Gaudete et Exultate*), Papa Françesku
30. Shëlbuesi i botës (*Redemptor hominis)*, Shën Gjon Pali II
31. Krishti jeton (*Christus vivit*), Papa Françesku
32. Orientime baritore kundër trafikimit të qënieve njerëzore
33. Fratelli tutti (*Vëllezër të gjithë*), Papa Françesku

FRATELLI TUTTI

(VËLLEZËR TË GJITHË)

LETRA ENCIKLIKE
E ATIT TË SHENJTË FRANÇESKU
MBI VËLLAZËRINË
DHE MIQËSINË SHOQËRORE

Enti Botues:
Arqipeshkvia Metropolitane
Shkodër-Pult

Janar 2021

Përkthyese
LORETA TOMAj

Korektoi
DOM GJOVALIN SIMONI

Faqosja dhe grafika
LUIGJ MILA

© Copyright: www.vatican.va

© Copyright në shqip
ARQIPESHKVIA METROPOLITANE
SHKODËR-PULT

Shtypur
SHTYPSHKRONJA
“GJERGJ FISHTA ”

Janar 2021

PARAQITJE

Duke nënshkruar Enciklikën e tij të tretë në Asizi, Ati i shenjtë ka dashur që të njohë frymëzimin e tij prej Shën Françeskut, në gjurmët e të cilit na ka ftuar që të ëndërrojmë së bashku dhe që t'u bëjmë ballë hijeve të konfliktit, të vuajtjeve dhe të konformizmit.

Botimi i kësaj Enciklike në gjuhën shqipe është një tjetër rast ofruar popullit tonë për të hyrë në kontakt me mendimin e Papa Françeskut dhe me Magjisterin e tij, duke shijuar drejtpërdrejt në gjuhën tonë përmbajtjet e Letrës që këtu më pëlqen ta paraqes në mënyrë shumë të përmbledhur, duke ju ftuar që, me qetësi, ta lexoni atë të plotë.

Hijet e një bote të mbyllur

Jemi gjithnjë e më të ndarë, gjithnjë e më vetëm. Skartohen ata që janë të padobishëm, që nuk duhen më. Shumë prej njerëzve

humbasin të drejtat e tyre dhe vuajnë për shkak të formave të reja të skllavërisë. Ku është dinjiteti njerëzor?

Një i huaj në rrugë

Samaritani i Mirë na tregon se ekzistojnë ecje shprese. Njeriu i plagosur që qëndron në rrugë shpërfillet prej shumë vetëve. Vetëm njëri ndalet dhe i dhuron afërsinë e vet. Në botën e sotme, me kaq plagë të hapura, a vazhdojmë rrugën, shpërfillës? A jemi Samaritanë të Mirë? Duhet të zgjedhim!

Të mendosh dhe të krijosh një botë
të hapur

Të shkosh nëpër periferi ku jetojnë "të mërguarit e padukshëm". Të mendosh për dinjitetin e çdo personi. Të kujdesemi për njëri-tjetrin. T'u dhurohemi sinqerisht të tjerëve. Mund të bëjmë shumë gjëra për të shmangur rrezikun më të keq: të mos duam.

Një zemër e hapur ndaj mbarë botës

Qenia njerëzore nuk ka kufij. Përpara kufizimeve të këtyre pengesave, mund t'i pranojmë, t'i mbrojmë, t'i nxisim dhe t'i

integrojmë personat e ndryshëm që vijnë. T'ia hapim atë që është vendore universales, duke u pasuruar nga kultura të tjera.

Politika më e mirë

A mund të ekzistojnë vëllazëria universale dhe paqja pa një politikë të mirë, që të jetë shuma e vullnesës së individëve dhe që të shkojë kah drejtësia për të gjithë? Një politikë që e vë dinjitetin njerëzor në qendër dhe që e ka bamirësinë shoqërore si shtyllë, që i trajton problemet e botës së sotme dhe që i ripërtërin strukturat e organizmat shoqërorë, që na hap ndaj gjithçkaje dhe që i globalizon të drejtat themelore njerëzore.

Dialogu dhe miqësia shoqërore

Dialogu duhet të jetë baza e politikës. Një dialog që respekton këndvështrimin e tjetrit. Si edhe që kërkon miqësinë shoqërore në takimin me më të lënët pas dore. Në këtë mënyrë, mund të bëjmë më shumë: të mjekojmë plagët e krijuara prej përplasjes dhe të rivendosim paqen.

Rrugëtime për një ecje të re

Pajtimi i vërtetë arrihet në mënyrë pro-aktive, "në" konflikt, duke e tejkaluar atë nëpërmjet dialogut. Vetëm kështu do të arrijmë realisht te falja dhe pajtimi.

Besimet fetare në shërbim të vëllazërisë në botë

Dialogu mes besimeve fetare e bën të pranishëm Hyjin në shoqëritë tona. Dhuna nuk gjen asnjë bazë në bindjet fetare, por vetëm në deformimet e tyre. Mes besimeve fetare është e mundur që të vendosen lidhje miqësie, paqeje, harmonie dhe bashkëndarjeje vlerash: një ecje paqeje. Pika e nisjes duhet të jetë shikimi i Hyjit, sepse Hyji nuk shikon me sy, por me zemër.

U uroj të gjithë atyre që do t'i lexojnë këto faqe kaq të pasura me përmbajtje se i bën mirë zemrës dhe shpirtit gjetja e stimujve të duhur për një angazhim konkret në realizimin e një vëllazërie të vërtetë edhe në tokën tonë; të një vëllazërie jo të bazuar në të jetuarit e qetë të atij që nuk dëshiron të ketë probleme, por në kërkimin e sinqertë

të së mirës së përbashkët dhe të asaj që na bashkon më shumë; të një vëllazërie të bazuar në atësinë e Hyjit, sepse nëse jemi "vëllezër të gjithë" kjo është falë faktin se kemi një Atë të vetëm, Hyjin.

† Angelo Massafra O.F.M.
Arqipeshkëv Metropolit Shkodër-Pult

FRATELLI TUTTI

1. “Fratelli tutti” “*Vëllezër të gjithë*”[1] shkruante Shën Françesku i Asizit për t’iu drejtuar të gjithë vëllezërve e motrave dhe për t’u propozuar atyre një formë jete me shije Ungjilli. Mes këshillave të tij dua të evidentoj një, ku ai fton për një dashuri që shkon përtej pengesave gjeografike dhe hapësinore. Këtu ai deklaron të lumë atë që e do tjetrin “si nëse është larg tij, ashtu edhe nëse është përkrah tij”.[2] Me këto fjalë të pakta dhe të thjeshta, ai shpjegoi thelbësoren e një vëllazërie të hapur, e cila bën të mundur njohjen, vlerësimin dhe dashurinë e çdo personi përtej afërsisë fizike, përtej vendit në botë ku ka lindur ose ku jeton.

2. Ky Shenjt i dashurisë vëllazërore, i thjeshtësisë dhe i gëzimit, i cili më frymëzoi për të shkruar Enciklikën *Laudato si’ (Ti qofsh lëvduar*), sërish më motivon që t’ia

kushtoj këtë Enciklikë të re vëllazërisë dhe miqësisë shoqërore. Në fakt, Shën Françesku, i cili e ndiente veten vëlla me diellin, detin dhe erën, e dinte se ai ishte edhe më i bashkuar me ata që ishin nga mishi i tij. Kudo mbolli paqe dhe eci përkrah të varfërve, të braktisurve, të sëmurëve, të të flakurve tej (të të skartuarve), të të fundmëve.

PA KUFI

3. Ekziston një episod në jetën e tij, që na tregon zemrën e tij të pakufishme, të aftë për të kapërcyer largësitë për shkak të origjinës, të kombësisë, të ngjyrës ose të besimit fetar. Është vizita e tij bërë Sulltanit Malik-al-Kamil në Egjipt, vizitë që i kushtoi një përpjekje të madhe për shkak të varfërisë së tij, të burimeve të pakta që kishte, të largësisë dhe të ndryshimit në gjuhë, kulturë dhe besim fetar. Ky udhëtim, në atë moment historik të shënuar nga Kryqëzatat, tregonte edhe më shumë madhështinë e dashurisë që ai dëshironte të jetonte, i etur për t'i përqafuar të gjithë. Besnikëria ndaj Zotit të vet ishte në përpjesëtim me dashurinë e tij për vëllezërit dhe motrat e veta. Pa shpërfillur vështirësitë dhe rreziqet, Shën

Françesku shkoi ta takonte Sulltanin me po atë qëndrim që kërkoi prej nxënësve të vet: që, pa mohuar identitetin e vet, duke qenë "midis saraçenëve ose të pabesëve të tjerë [...], nuk duhet të bënin grindje ose mosmarrëveshje, por t'i nënshtroheshin çdo krijese njerëzore për dashurinë ndaj Hyjit".[3] Në atë kontekst ishte një kërkesë e jashtëzakonshme. Na prek se si, tetëqind vjet më parë, Françesku porosiste që të shmangej çdo formë agresioni ose grindjeve, si edhe të jetohej një "nënshtrim" i përvuajtë dhe vëllazëror, madje edhe ndaj atyre që nuk bashkëndanin besimin e tyre fetar.

4. Ai nuk bënte luftë dialektike duke imponuar doktrina, por komunikonte dashurinë e Hyjit. Kishte kuptuar se "Hyji është Dashuri, dhe, kush mbetet në dashuri, mbetet në Hyjin dhe Hyji mbetet në të" (1Gjn 4,16). Në këtë mënyrë ka qenë një baba i frytshëm, që realizoi ëndrrën e një shoqërie vëllazërore, sepse "vetëm njeriu që pranon t'u afrohet njerëzve të tjerë në lëvizjen e tyre, jo për t'i mbajtur te e vetja, por për t'i ndihmuar që të jenë më shumë vetvetja, bëhet me të vërtetë baba".[4] Në atë botë plot kulla vrojtimi dhe mure mbrojtëse,

qytetet përjetonin luftëra të përgjakshme midis familjeve të fuqishme, ndërsa rriteshin zonat e varfra të periferive të përjashtuara. Aty Françesku mori brenda vetes paqen e vërtetë, u lirua nga çdo dëshirë për t'i zotëruar të tjerët, u bë një nga të fundit dhe u përpoq të jetonte në harmoni me të gjithë. Motivimi i këtyre faqeve i detyrohet atij.

5. Çështjet e lidhura me vëllazërinë dhe miqësinë shoqërore kanë qenë gjithmonë ndër shqetësimet e mia. Vitet e fundit u jam referuar atyre disa herë dhe në vende të ndryshme. Kam dashur t'i përmbledh në këtë Enciklikë shumë nga këto ndërhyrje, duke i vendosur ato në një kontekst më të gjerë reflektimi. Për më tepër, nëse për shkrimin e Enciklikës *Laudato si'* kam pasur si burim frymëzimi vëllain tim Bartolomeun, Patriark Ortodoks, i cili propozoi fuqimisht kujdesin ndaj krijimit, në këtë rast u ndjeva i nxitur në mënyrë të veçantë nga Imami i Madh Ahmed Al-Tayyeb-i, me të cilin u takova në Abu Dabi për të kujtuar se Hyji "i ka krijuar të gjitha qeniet njerëzore të barabarta në të drejta, detyra e dinjitet dhe i ka thirrur që të jetojnë së bashku si vëllezër midis tyre".[5] Nuk ishte thjesht një akt diplomatik, por një

reflektim i bërë në dialog dhe një angazhim i përbashkët. Kjo Enciklikë përmbledh dhe zhvillon temat e mëdha të paraqitura në atë Dokument që kemi nënshkruar së bashku. Këtu kam paraqitur gjithashtu, me gjuhën time, dokumente dhe letra të shumta që kam marrë nga shumë njerëz dhe grupe prej gjithë botës.

6. Faqet në vijim nuk pretendojnë që të përmbledhin doktrinën mbi dashurinë vëllazërore, por përqendrohen në përmasën e saj universale, në hapjen e saj ndaj të gjithëve. E dorëzoj këtë Enciklikë shoqërore si një kontribut të përvuajtë ndaj reflektimit, me qëllim që, përballë mënyrave të ndryshme aktuale për t'i eliminuar ose për t'i shpërfillur të tjerët, jemi në gjendje të reagojmë me një ëndërr të re të vëllazërisë dhe të miqësisë shoqërore, që nuk ndalet te fjalët. Edhe pse e kam shkruar duke u nisur nga bindjet e mia të krishtera, të cilat më gjallërojnë dhe më ushqejnë, jam përpjekur që ta bëja në atë mënyrë që reflektimi t'i hapet dialogut me të gjithë njerëzit vullnetmirë.

7. Pikërisht kur isha duke e shkruar këtë letër, pandemia Covid-19 papritur depërtoi

dhe vuri në dukje siguritë e rreme. Përtej përgjigjeve të larmishme dhënë nga vende të ndryshme, u bë e dukshme pamundësia për të vepruar së bashku. Pavarësisht hiperlidhjes, u vu re një copëzim që e bën më të vështirë zgjidhjen e problemeve që na prekin të gjithëve. Nëse dikush mendon se bëhej fjalë vetëm që të funksiononte më mirë ajo që bënim apo se mesazhi i vetëm është që ne t'i përmirësojmë sistemet dhe rregullat ekzistuese, po mohon realitetin.

8. Dëshiroj shumë që, në këtë kohë që na është dhënë të jetojmë, duke njohur dinjitetin e çdo personi njerëzor, të ringjallim te të gjithë një aspiratë mbarëbotërore drejt vëllazërimit. Mes të gjithëve: "Ja një sekret shumë i bukur për të ëndërruar dhe për ta bërë jetën tonë një aventurë të bukur. Askush nuk mund t'i bëjë ballë jetës i izoluar […] Kemi nevojë për një bashkësi që na mbështet, që na ndihmon dhe në të cilën ndihmojmë njëri-tjetrin për të shikuar përpara. Sa e rëndësishme është që të ëndërrojmë së bashku! [...] Vetëm rrezikojmë të kemi mirazhe, të shohim diçka që nuk ekziston; ëndrrat ndërtohen së bashku".[6] Le të ëndërrojmë si një njerëzim, si udhëtarë që kanë të njëjtin mish njerëzor, si bij të kësaj

toke që na mikpret të gjithëve, secili me pasurinë e besimit fetar apo të bindjeve të veta, secili me zërin e vet, të gjithë vëllezër!

KAPITULLI I PARË

HIJET E NJË BOTE TË MBYLLUR

9. Pa pretenduar që të bëj një analizë shteruese ose t'i marr në konsideratë të gjitha aspektet e realitetit në të cilin jetojmë, propozoj t'i kushtoj vëmendje vetëm disa prirjeve të botës aktuale, që pengojnë zhvillimin e vëllazërisë universale.

Ëndrra që thyhen

10. Për dekada me radhë, bota dukej se kishte mësuar nga luftërat dhe dështimet e shumta dhe ngadalë po shkonte drejt formave të ndryshme të integrimit. Për shembull, është zhvilluar ëndrra për një Evropë të bashkuar, e aftë të njohë rrënjët e përbashkëta dhe të gëzohet për larminë e saj. Kujtojmë "bindjen e vendosur të Etërve themelues të Bashkimit Evropian, të cilët dëshironin një të ardhme të bazuar në aftësinë për të punuar së bashku për kapërcimin e ndarjeve dhe

për nxitjen e paqes e të bashkësisë midis të gjithë popujve të kontinentit”.[7] Po ashtu, u bë e fortë aspirata për integrimin e Amerikës Latine dhe filluan të hidheshin disa hapa. Në vende dhe rajone të tjera ka pasur përpjekje për paqëtim dhe afrim, që kanë dhënë fryte dhe të tjera që dukeshin premtuese.

11. Por historia po jep shenja të një kthimi prapa. Ndizen konflikte anakronike që konsideroheshin të kapërcyer, rilindin nacionalizma të mbyllur, të egërsuar, të inatosur dhe agresivë. Në vende të ndryshme, një ide e njësisë së popullit dhe e kombit, e mbarsur me ideologji të ndryshme, krijon forma të reja egoizmi dhe humbjeje të ndjenjës shoqërore të maskuar nga një mbrojtje e pretenduar e interesave kombëtare. Dhe kjo na kujton se “çdo brez duhet t’i bëjë të veta luftërat dhe arritjet e brezave të mëparshëm dhe t’i çojë ato drejt qëllimeve edhe më të larta. Kjo është rruga. E mira, si dhe dashuria, drejtësia dhe solidariteti, nuk arrihen njëherë e përgjithmonë; duhet të fitohen çdo ditë. Nuk është e mundur që të jemi të kënaqur me atë që është arritur në të kaluarën dhe të ndalemi, dhe të kënaqemi me të sikur kjo situatë të na bëjë të injorojmë që

shumë nga vëllezërit tanë ende vuajnë situata padrejtësie që na interpelojnë të gjithëve”. [8]

12. “T’i hapemi botës” është një shprehje që sot është përvetësuar nga ekonomia dhe financa. I referohet ekskluzivisht hapjes ndaj interesave të huaja apo lirisë së fuqive ekonomike për të investuar pa lidhje ose komplikime në të gjitha vendet. Konfliktet lokale dhe mosinteresimi për të mirën e përbashkët shfrytëzohen nga ekonomia globale për të diktuar një model të vetëm kulturor. Kjo kulturë njëson botën, por i ndan njerëzit dhe kombet, pasi “shoqëria gjithnjë e më e globalizuar na bën të afërt, por nuk na bën vëllezër”.[9] Jemi më vetëm se kurrë në këtë botë të standartizuar, që favorizon interesat individuale dhe dobëson përmasën bashkësiore të ekzistencës. Përkundrazi, rriten tregjet, ku njerëzit luajnë rolin e konsumatorëve ose të spektatorëve. Përparimi i këtij globalizmi normalisht favorizon identitetin e më të fortëve që mbrojnë veten, por kërkon të shpërbëjë identitetet e rajoneve më të dobëta dhe më të varfra, duke i bërë më të prekshme dhe të varura. Në këtë mënyrë politika bëhet gjithnjë e më e brishtë përballë fuqive ekonomike

transnacionale që zbatojnë politikën "*divide et impera*" (përçaj e sundo).

Fundi i vetëdijes historike

13. Për të njëjtën arsye favorizohet gjithashtu një humbje e ndjenjës së historisë, e cila shkakton një shpërbërje të mëtejshme. Ndihet një depërtim kulturor i një lloj "dekonstruksionizmi", ku liria njerëzore pretendon të ndërtojë gjithçka nga e para. Mbetet gjallë vetëm nevoja për të konsumuar pa kufi dhe theksimi i shumë formave të individualizmit pa përmbajtje. Në këtë kontekst vihej një këshillë që u dhashë të rinjve: "Nëse një person ju bën një propozim dhe ju thotë që ta shpërfillni historinë, që të mos e merrni parasysh përvojën e të moshuarve, që të përbuzni gjithçka që ka kaluar dhe të shikoni vetëm drejt së ardhmes që ai ju ofron, a nuk është kjo një mënyrë e lehtë për t'ju tërhequr me propozimin e tij, që ju të bëni vetëm atë që ai ju thotë? Ai person ka nevojë që të jeni të zbrazët, të çrrënjosur, mosbesues ndaj gjithçkaje, me qëllim që t'u zini besë vetëm premtimeve të tij dhe t'u nënshtroheni planeve të tij. Kështu funksionojnë ideologjitë e ngjyrave të

ndryshme, që shkatërrojnë (ose ç-ndërtojnë) gjithçka që është e ndryshme dhe në këtë mënyrë mund të sundojnë pa kundërshtime. Për ta arritur këtë qëllim ata kanë nevojë për të rinj që e përbuzin historinë, që e refuzojnë atë pasuri shpirtërore dhe njerëzore që na kanë përçuar brezat e mëparshëm, që shpërfillin gjithçka që ka ekzistuar përpara tyre".[10]

14. Këto janë format e reja të kolonizimit kulturor. Të mos harrojmë se "popujt që tjetërsojnë traditën e tyre dhe, nga mania imituese, dhuna e diktuar, neglizhenca apo apatia e pafalshme, tolerojnë që t'u merret atyre shpirti, humbasin, bashkë me fizionominë e tyre shpirtërore, edhe qëndrueshmërinë morale dhe, në fund, pavarësinë ideologjike, ekonomike dhe politike".[11] Një mënyrë e efektshme për të shkatërruar vetëdijen historike, të menduarit kritik, angazhimin për drejtësinë dhe rrugëtimet e integrimit është heqja e domethënies apo ndryshimi i fjalëve të mëdha. Çfarë kuptimi kanë sot shprehje të tilla, si p.sh. demokracia, liria, drejtësia, njësia? Janë manipuluar dhe deformuar për t'i përdorur si mjete sundimi, si tituj

përmbajtjesh boshe që mund të shërbejnë për të justifikuar çdo veprim.

Pa një projekt për të gjithë

15. Mënyra më e mirë për të sunduar dhe për të përparuar pa kufij është mbjellja e mungesës së shpresës dhe ngjallja e mosbesimit të vazhdueshëm, edhe pse të maskuar nga mbrojtja e disa vlerave. Sot në shumë vende përdoret mekanizmi politik i acarimit, i egërsimit dhe i polarizimit. Me mënyra të ndryshme u mohohet të tjerëve e drejta për të ekzistuar dhe për të menduar, për këtë qëllim përdoret strategjia e talljes së tyre, e hedhjes së dyshimeve rreth tyre, e rrethimit të tyre. Nuk pranohet pjesa e tyre e të vërtetës, vlerat e tyre dhe në këtë mënyrë shoqëria varfërohet dhe bie nën arrogancën e më të fortit. Kështu, politika nuk është më një diskutim i shëndetshëm mbi projektet afatgjata për zhvillimin e të gjithëve dhe e të mirës së përbashkët, por vetëm receta dritëshkurtra marketingu që gjejnë në shkatërrimin e tjetrit burimin më të efektshëm. Në këtë lojë meskine skualifikimesh, debati manipulohet për ta mbajtur atë në një gjendje polemikash dhe

kundërshtimesh.

16. Në këtë përplasje interesash që na vë të gjithëve kundër të gjithëve, ku fitorja është sinonim i shkatërrimit, si mund ta ngresh kokën për të njohur fqinjin tënd apo të qëndrosh pranë atyre që janë rrëzuar gjatë rrugës? Një projekt me objektiva të mëdha për zhvillimin e krejt njerëzimit sot tingëllon si një delir. Distancat midis nesh rriten dhe rruga e vështirë dhe e ngadaltë drejt një bote të bashkuar dhe më të drejtë pëson një tërheqje të re dhe drastike.

17. Të kujdesemi për botën që na rrethon dhe na mbështet do të thotë të kujdesemi për veten tonë. Por kemi nevojë të bëhemi një "ne", që jeton në Shtëpinë e përbashkët. Një kujdes i tillë nuk është në interes të fuqive ekonomike që kanë nevojë për të ardhura të shpejta. Shpesh zërat që ngrihen në mbrojtje të mjedisit heshtohen ose tallen, duke mbuluar me racionalitet ato që janë vetëm interesa të veçanta. Në këtë kulturë që jemi duke prodhuar, të zbrazët, të orientuar drejt të menjëhershmes dhe pa një projekt të përbashkët, "është e parashikueshme që, përballë shterjes së disa burimeve, të fillojë

të krijohet një skenar i volitshëm për luftëra të reja, të maskuara me kërkesa fisnike”.[12]

Skarcoja botërore

18. Disa pjesë të njerëzimit duken të sakrifikueshme për të mirën e një përzgjedhjeje që favorizon një sektor njerëzor të denjë për të jetuar pa kufij. Në fund, “njerëzit nuk ndihen më si një vlerë parësore për t’u respektuar dhe për t’u mbrojtur, veçanërisht nëse janë të varfër ose me aftësi të kufizuara, nëse “nuk janë më të nevojshëm”- si të palindurit – ose “nëse nuk janë më të nevojshëm” - si të moshuarit. Jemi bërë të pandjeshëm ndaj çdo forme shpërdorimi, duke filluar nga ai ushqimor, që është ndër më të qortueshmit”.[13]

19. Mungesa e fëmijëve, e cila shkakton plakje të popullsisë, bashkë me braktisjen e të moshuarve në një vetmi të dhimbshme, pohon në mënyrë të heshtur se gjithçka përfundon me ne, se vlejnë vetëm interesat tona individuale. Kështu, “objekt i skartos nuk janë vetëm ushqimi apo mallrat e tepërta, por shpesh vetë qeniet njerëzore”.[14] Kemi parë se çfarë u ka ndodhur të moshuarve në

disa vende të botës për shkak të koronavirusit. Nuk duhej të kishin vdekur ashtu. Por në realitet diçka e ngjashme kishte ndodhur edhe më përpara për shkak të ngrohtësisë dhe të rrethanave të tjera: skartuar mizorisht. Nuk e kuptojmë se izolimi i të moshuarve dhe lënia e tyre në dorë të të tjerëve, pa shoqërimin e duhur dhe të kujdesshëm të familjes, gjymton dhe varfëron vetë familjen. Po ashtu, arrin deri aty t'i privojë të rinjtë nga kontakti i nevojshëm me rrënjët e tyre dhe me një mençuri që rinia nuk mund të arrijë vetë.

20. Ky skartim shfaqet në shumë mënyra, si në fiksimin për uljen e kostove të punës, pa kuptuar pasojat serioze që kjo gjë shkakton, sepse papunësia që prodhon ka si efekt të drejtpërdrejtë zgjerimin e kufijve të varfërisë.[15] Po ashtu, skartimi merr forma të neveritshme që besonim se i kishim tejkaluar, siç është racizmi, i cili fshihet dhe rishfaqet pa pushim. Shprehjet e racizmit rinovojnë në ne turpin, duke treguar se përparimet e pretenduara të shoqërisë nuk janë aq reale dhe nuk janë të garantuara njëherë e përgjithmonë.

21. Ekzistojnë rregulla ekonomike që janë të efektshme për rritjen, por jo aq për zhvillimin tërësor njerëzor.[16] Është rritur pasuria, por pa barazi, dhe kështu ajo që ndodh është se "lindin varfëri të reja".[17] Kur thuhet se bota moderne ka zvogëluar varfërinë, kjo gjë bëhet duke e matur atë me kritere të epokave të tjera, të pakrahasueshme me realitetin aktual. Në fakt, në kohë të tjera, për shembull, mos-pasja e energjisë elektrike nuk konsiderohej shenjë varfërie dhe nuk ishte shkak shqetësimi serioz. Varfëria gjithmonë analizohet dhe kuptohet në kontekstin e mundësive reale të një momenti konkret historik.

Të drejta të njeriut jo aq universale

22. Shumë herë vërehet se të drejtat e njeriut nuk janë të njëjta për të gjithë. Respektimi i këtyre të drejtave "është një parakusht për vetë zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të një vendi. Kur dinjiteti i njeriut respektohet dhe të drejtat e tij njihen dhe garantohen, krijimtaria dhe sipërmarrja lulëzojnë gjithashtu dhe personaliteti njerëzor mund t'i shpalosë nismat e veta të shumta në favor të së mirës së përbashkët".[18] Por

“duke vëzhguar me kujdes shoqëritë tona bashkëkohore, ndeshen shumë kontradikta që na shtyjnë të pyesim nëse dinjiteti i barabartë i të gjitha qenieve njerëzore, shpallur solemnisht 70 vjet më parë, njihet, respektohet, mbrohet dhe promovohet në çdo rrethanë. Forma të shumta padrejtësie vazhdojnë ende sot në botë, të ushqyera nga vizione antropologjike reduktuese dhe nga një model ekonomik bazuar në fitim, i cili nuk heziton ta shfrytëzojë, ta skartojë e madje edhe ta vrasë njeriun. Ndërsa një pjesë e njerëzimit jeton në pasuri, një pjesë tjetër sheh dinjitetin e vet të shpërfillur, të përbuzur ose të shkelur dhe të drejtat e veta themelore të injoruara apo të shkelura”.[19] Çfarë do të thotë kjo për barazinë e të drejtave bazuar në të njëjtin dinjitet njerëzor?

23. Në mënyrë të ngjashme, organizimi i shoqërive në të gjithë botën është ende larg pasqyrimit të qartë se gratë kanë saktësisht të njëjtin dinjitet dhe kanë të drejta identike si burrat. Me fjalë pohohen disa gjëra, por vendimet dhe realiteti përçojnë një mesazh tjetër. Është fakt që “dyfish më të varfra janë gratë që duhet të durojnë situata përjashtimi, keqtrajtimi dhe dhune, meqë shpesh nuk janë

në gjendje t'i mbrojnë të drejtat e tyre".[20]

24. Gjithashtu pranojmë që, "megjithëse bashkësia ndërkombëtare ka miratuar marrëveshje të shumta për t'i dhënë fund skllavërisë në të gjitha format e saj dhe ka nisur strategji të ndryshme për ta luftuar këtë fenomen, ende sot miliona njerëz - fëmijë, burra dhe gra të çdo moshe - privohen nga liria e tyre dhe detyrohen të jetojnë në kushte të ngjashme me ato të skllavërisë. […] Sot si dje, në rrënjë të skllavërisë gjendet një konceptim i personit njerëzor që pranon mundësinë e trajtimit të tij si një objekt.[...] Personi njerëzor, i krijuar në shëmbëlltyrë dhe përngjasim të Hyjit, me forcë, me mashtrim ose me kufizim fizik apo psikologjik, privohet nga liria, kthehet në mall apo në pronë të dikujt; trajtohet si një mjet dhe jo si një qëllim". Rrjetet kriminale "përdorin me zgjuarsi teknologjitë moderne informatike për të joshur të rinj dhe fëmijë në çdo kënd të botës".[21] Devijimi nuk ka kufij kur nështrohen gra, që pastaj detyrohen të abortojnë. Një akt i neveritshëm që arrin deri në rrëmbimin e personave me qëllim shitjen e organeve të tyre. E gjithë kjo bën që trafikimi i qenieve njerëzore dhe forma

të tjera të skllavërisë të bëhen një problem botëror, i cili kërkon të merret seriozisht nga njerëzimi në tërësinë e tij, sepse "ashtu si organizatat kriminale përdorin rrjete globale për të arritur qëllimet e tyre, edhe veprimi për ta mposhtur këtë fenomen kërkon një përpjekje të përbashkët dhe po aq globale nga ana e aktorëve të ndryshëm që përbëjnë shoqërinë".[22]

Konflikti dhe frika

25. Luftërat, atentatet, përndjekjet për arsye racore ose fetare dhe shumë padrejtësi kundër dinjitetit njerëzor gjykohen në mënyra të ndryshme në varësi të faktit nëse ato i përshtaten apo jo interesave të veçanta, the lbësisht ekonomike. Ajo që është e vërtetë kur i përshtatet një personi të pushtetshëm, pushon së qeni e tillë kur nuk është më në interesin e tij. Situata të tilla dhune janë "shumëzuar dhimbshëm në shumë vende të botës, aq sa kanë marrë tiparet e asaj që mund të quhet si "lufta e tretë botërore në copa".[23]

26. Kjo gjë nuk na habit nëse vërejmë mungesën e horizonteve të afta që të na

bëjnë të bashkohemi, sepse në çdo luftë ajo që shkatërrohet është "vetë projekti i vëllazërisë, që gjendet i shkruar në thirrjen e familjes njerëzore", kështu që "çdo situatë kërcënuese ushqen mosbesim dhe mbyllje në vetvete".[24] Kështu, bota jonë përparon në një dikotomi të pakuptimtë, me pretendimin e "garantimit të stabilitetit dhe të paqes në bazë të një sigurie të rreme të mbështetur nga një mendësi e frikës dhe e mosbesimit". [25]

27. Në mënyrë paradoksale, ekzistojnë frika atavike që nuk janë kapërcyer nga progresi teknologjik; madje, kanë ditur të fshihen dhe të forcohen pas teknologjive të reja. Edhe sot, pas mureve të qytetit antik është humnera, territori i të panjohurës, shkretëtira. Ajo që vjen prej atje nuk është e besueshme, sepse nuk njihet, nuk është familjare, nuk i përket fshatit. Është territori i asaj që është "barbare", nga e cila njeriu duhet të mbrohet me çdo kusht. Si pasojë, krijohen pengesa të reja vetëmbrojtjeje, kështu që bota nuk ekziston më dhe ekziston vetëm bota "ime", deri në atë pikë sa shumë vetë nuk konsiderohen më qenie njerëzore me një dinjitet të patjetërsueshëm dhe bëhen

thjesht “ata”. Rishfaqet “tundimi për të krijuar një kulturë të mureve, për të ngritur mure, mure në zemër, mure në tokë për ta penguar këtë takim me kulturat e tjera, me njerëzit e tjerë. Dhe ai që ngre një mur, ai që ndërton një mur do të përfundojë skllav brenda mureve që ka ndërtuar, pa horizonte. Sepse atij i mungon kjo tjetërsi e tjetrit”.[26]

28. Vetmia, frikat dhe pasiguria e shumë njerëzve, të cilët ndihen të braktisur nga sistemi, krijon një tokë pjellore për mafiet. Këto, në fakt, diktohen duke e paraqitur veten si “mbrojtës” të të harruarve, shpesh përmes llojeve të ndryshme të ndihmës, ndërsa ndjekin interesat e tyre kriminale. Ekziston një pedagogji tipike mafioze e cila, me një frymë të rreme bashkësiore, krijon lidhje varësie dhe vartësie nga të cilat është shumë e vështirë të lirohesh.

Globalizimi dhe përparimi pa një drejtim të përbashkët

29. Bashkë me Imamin e Madh Ahmad Al-Tayyeb-i nuk i anashkalojmë zhvillimet pozitive që kanë ndodhur në shkencë, teknologji, mjekësi, industri

dhe mirëqenie, veçanërisht në vendet e zhvilluara. Sidoqoftë, "theksojmë se, së bashku me këto përparime historike, të mëdha dhe të vlerësuara, ka ndodh edhe një përkeqësim i etikës, që kushtëzon veprimin ndërkombëtar, dhe një dobësim i vlerave shpirtërore dhe i ndjenjës së përgjegjësisë. E gjithë kjo kontribuon në përhapjen e një ndjesie të përgjithshme frustrimi, vetmie dhe dëshpërimi […]. Lindin vatra tensioni dhe grumbullohen armë dhe municione, në një situatë botërore të sunduar nga pasiguria, zhgënjimi dhe frika për të ardhmen dhe të kontrolluar nga interesa dritëshkurtëra ekonomike". Gjithashtu tregojmë "krizat e rënda politike, padrejtësinë dhe mungesën e një shpërndarjeje të drejtë të burimeve natyrore.[…] Përballë krizave të tilla që shkaktojnë vdekjen prej urisë të miliona fëmijëve, shndërruar fillimisht në skelete njerëzore - për shkak të varfërisë dhe të urisë -, mbretëron një heshtje e papranueshme ndërkombëtare".[27] Përpara kësaj panorame, edhe pse na tërheqin shumë përparime, nuk gjejmë një drejtim vërtet njerëzor.

30. Në botën e sotme, ndjenjat e përkatësisë në të njëjtin njerëzim dobësohen,

ndërsa ëndrra për të ndërtuar së bashku drejtësinë dhe paqen duket një utopi e kohëve të tjera. Shohim se si sundon indiferenca e rehatisë, e ftohtë dhe e globalizuar, bijë e një zhgënjimi të thellë që qëndron pas mashtrimit të një iluzioni: besimi se mund të jemi të gjithëfuqishëm dhe të harrojmë se të gjithë jemi në të njëjtën barkë. Ky zhgënjim, i cili lë pas vlerat e mëdha vëllazërore, çon "drejt një lloj cinizmi. Ky është tundimi me të cilin përballemi nëse shkojmë në këtë rrugë zhgënjimi.[...] Izolimi dhe mbyllja në vetvete ose në interesat vetjake nuk janë kurrë mënyra për ta rivendosur shpresën dhe për të sjellë ripërtëritje, por është afërsia, është kultura e takimit. Izolimi, jo; afërsia, po. Kultura e ndeshjes, jo; kultura e takimit, po".[28]

31. Në këtë botë që kalon pa një drejtim të përbashkët, thithet një atmosferë në të cilën "distanca midis fiksimit për mirëqenien vetjake dhe lumturisë së njerëzimit të bashkëndarë duket se po zmadhohet: deri në pikën sa të bën të mendosh se midis individit dhe bashkësisë njerëzore është duke ndodhur një ndarje e vërtetë.[…] Sepse një gjë është të ndihesh i detyruar të

jetosh së bashku dhe krejt tjetër gjë është të vlerësosh pasurinë dhe bukurinë e farave të jetës së përbashkët që duhen kërkuar dhe kultivuar së bashku".[29] Teknologjia po bën përparime të vazhdueshme, por "sa bukur do të ishte sikur rritja e inovacioneve shkencore dhe teknologjike të shoqërohej edhe me një drejtësi dhe përfshirje sociale gjithnjë e më të madhe! Sa bukur do të ishte nëse, ndërsa zbulojmë planete të reja të largëta, të rizbulonim nevojat e vëllait dhe të motrës që sillen rreth meje!".[30]

Pandemitë dhe shuplaka të tjera të historisë

32. Një tragjedi globale siç është pandemia e Covid-19 ka zgjuar efektivisht për njëfarë kohe vetëdijen se jemi një bashkësi botërore që lundron në të njëjtën barkë, ku e keqja e dikujt shkon në dëm të të gjithëve. Jemi kujtuam se askush nuk shpëton vetëm, se mund të shpëtojmë vetëm së bashku. Kjo është arsyeja pse kam thënë se "stuhia ia keq maskën cenueshmërinë tonë dhe i lë zbuluar të gjitha ato siguri të rreme dhe të tepërta me të cilat kemi ndërtuar axhendat tona, projektet tona, zakonet dhe përparësitë tona.

[…] Me stuhinë, ka rënë mashtrimi i atyre stereotipeve me të cilët maskonim "egot" tona gjithmonë të shqetësuara për imazhin e tyre; dhe ka mbetur zbuluar, edhe një herë, ajo përkatësi (e bekuar) e përbashkët të cilës nuk mund t'i shpëtojmë: përkatësia si vëllezër".[31]

33. Bota po lëvizte në mënyrë të pamëshirshme drejt një ekonomie që, duke përdorur përparimet teknologjike, kërkonte të ulte "kostot njerëzore", dhe dikush pretendonte të na bënte të besonim se mjaftonte liria e tregut që gjithçka të konsiderohej e sigurt. Por goditja e fortë dhe e papritur e kësaj pandemie jashtë kontrolli na ka detyruar që të mendojmë për qeniet njerëzore, për të gjithë, më shumë sesa për përfitimin e disave. Sot mund të pranojmë se "jemi ushqyer me ëndrra shkëlqimi dhe madhështie dhe kemi përfunduar duke ngrënë shpërqendrim, mbyllje dhe vetmi; e kemi mbytur veten me lidhje dhe kemi humbur shijen e vëllazërimit. Kemi kërkuar një rezultat të shpejtë dhe të sigurt dhe e gjejmë veten të shtypur nga padurimi dhe ankthi. Të burgosur të virtualitetit, kemi humbur shijen dhe lezetin e realitetit".[32]

Dhimbja, pasiguria, frika dhe vetëdija për kufijtë vetjakë që pandemia ka ngjallur, i bëjnë jehonë thirrjes për t'i rimenduar stilet tona të jetës, marrëdhëniet tona, organizimin e shoqërive tona dhe mbi të gjitha domethënien e ekzistencës sonë.

34. Nëse gjithçka është e lidhur, është e vështirë të mendosh se kjo katastrofë botërore nuk ka të bëjë me qëndrimin tonë ndaj realitetit, duke pretenduar se jemi zotër absolutë të jetës sonë dhe të gjithçkaje që ekziston. Nuk dua të them se është një lloj dënimi hyjnor. As nuk do të mjaftonte të thoja se dëmi shkaktuar natyrës në fund kërkon llogarinë e padrejtësive tona. Është vetë realiteti që rënkon dhe rebelohet. Më vjen në mendje vargu i famshëm i poetit Virgjil i cili evokon ngjarjet e mjerueshme njerëzore.[33]

35. Shpejt i harrojmë mësimet e historisë, "mësuese jete".[34] Pas mbarimit të krizës shëndetësore, reagimi më i keq do të ishte të binim edhe më shumë në një konsumizëm të etur dhe në forma të reja vetëmbrojtjeje egoistike. Dashtë Zoti që në fund të mos jenë më "të tjerët", por vetëm një "ne". Që

të mos ketë qenë ngjarja e panumërt e rëndë historike nga e cila nuk kemi qenë në gjendje të mësojmë asgjë. Nuk duhet t'i harrojmë të moshuarit që vdiqën nga mungesa e respiratorëve, pjesërisht si rezultat i shkatërrimit të sistemeve shëndetësore vit pas viti. Që një dhimbje kaq e madhe të mos jetë e kotë, që të bëjmë një hap drejt një mënyre të re jete dhe të zbulojmë njëherë e përgjithmonë se kemi nevojë dhe se jemi borxhlinj të njëri-tjetrit, në mënyrë që njerëzimi të rilindë me të gjitha fytyrat, të gjitha duart dhe të gjithë zërat, përtej kufijve që kemi krijuar.

36. Nëse nuk arrijmë ta rimarrim pasionin e përbashkët për një bashkësi përkatësie dhe solidariteti, të cilit t'i kushtojmë kohë, angazhim dhe të mira, iluzioni global që na mashtron do të shembet shkatërrueshmërisht dhe do t'i lërë shumë vetë në kthetrat e neverisë dhe të zbrazëtisë. Po ashtu, nuk duhet të shpërfillet me naivitet se "fiksimi për një stil konsumist jete, sidomos kur vetëm pak vetë mund ta kenë atë, do të nxiste vetëm dhunë dhe shkatërrim të ndërsjellë".[35] "Të shpëtojë kush të mundet" do të përkthehet shpejt në "të gjithë kundër të gjithëve", dhe

kjo do të jetë më e keqe sesa pandemia.

Pa dinjitet njerëzor në horizont

37. Si nga disa regjime politike populiste, ashtu edhe nga pozicione ekonomike liberale, argumentohet se ardhja e migrantëve duhet të shmanget me çdo kusht. Në të njëjtën kohë, argumentohet se duhet të kufizohet ndihma për vendet e varfra, në mënyrë që ato të prekin fundin dhe të vendosin të miratojnë masa shtrënguese. Nuk e kuptojmë se, prapa këtyre deklaratave abstrakte që janë të vështira për t'u mbështetur, ka shumë jetë të shkatërruara. Shumë po ikin nga lufta, përndjekja, katastrofa natyrore. Të tjerët, me të drejtë, "janë në kërkim të shanseve për veten dhe familjen e tyre. Ëndërrojnë një të ardhme më të mirë dhe dëshirojnë të krijojnë kushtet që kjo të realizohet".[36]

38. Për fat të keq, të tjerë ndihen "të tërhequr prej kulturës perëndimore, duke ushqyer nganjëherë pritshmëri jo realiste që i vënë para zhgënjimeve të mëdha. Pastaj janë trafikantët e paskrupuj, shpesh të lidhur me organizatat e drogës e të armëve, të cilët shfrytëzojnë dobësinë e migrantëve, që gjatë

rrugëtimit të tyre shpesh ndeshin dhunën, tregtinë, abuzimin psikologjik e fizik dhe vuajtje të patregueshme".[37] Ata që emigrojnë "përjetojnë ndarjen nga konteksti i tyre i origjinës dhe shpesh edhe një çrrënjosje kulturore e fetare. Kjo ndarje ka lidhje edhe me bashkësitë e prejardhjes, të cilat humbasin elementet e tyre më të fuqishëm e sipërmarrës, si edhe me familjet, veçanërisht kur migron njëri apo të dy prindërit, duke i lënë fëmijët në vendin e prejardhjes".[38] Si pasojë, "ripohohet e drejta për të mos emigruar, domethënë të jesh në gjendje të rrish në tokën tënde".[39]

39. Për më tepër, "në disa prej vendeve ku ata mbërrijnë, dukuritë migratore ngjallin alarm e frikë, shpesh të nxitura e të shfrytëzuara për qëllime politike. Kështu përhapet një mendësi ksenofobe, mbylljeje në vetvete".[40] Migrantët konsiderohen jo aq të denjë sa të marrin pjesë në jetën shoqërore si kushdo tjetër dhe harrohet se kanë të njëjtin dinjitet të brendshëm si çdo person tjetër. Prandaj, duhet të jenë "protagonistë të shpërblimit të tyre".[41] Nuk do të thuhet kurrë se ata nuk janë qenie njerëzore, por në praktikë, me vendimet dhe mënyrën e

trajtimit të tyre, bëhet e qartë se konsiderohen me vlerë më të vogël, më pak të rëndësishëm, më pak njerëzorë. Është e papranueshme që të krishterët të bashkëndajnë këtë mendësi dhe këto qëndrime, duke bërë që ndonjëherë të mbizotërojnë preferencat e caktuara politike, sesa bindjet e thella të fesë së tyre: dinjiteti i patjetërsueshëm i çdo personi njerëzor pavarësisht origjinës, ngjyrës apo fesë, dhe ligji suprem i dashurisë vëllazërore.

40. "Migrimet do të përbëjnë një element themelor të së ardhmes së botës".[42] Por sot ata vuajnë nga një "humbje e asaj ndjenje të përgjegjësisë vëllazërore, mbi të cilën bazohet çdo shoqëri civile".[43] Evropa, për shembull, rrezikon seriozisht të shkojë drejt kësaj rruge. Sidoqoftë, "e ndihmuar nga trashëgimia e saj e madhe kulturore dhe fetare, [ajo i ka] mjetet për të mbrojtur qendërsinë e personit njerëzor dhe për të gjetur ekuilibrin e duhur midis detyrës së dyfishtë morale të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve të saj dhe garantimit të ndihmës e të pritjes së migrantëve".[44]

41. E kuptoj se disa njerëz kanë dyshime ose frikë kur përballen me migrantët. E

kuptoj si një aspekt të instinktit natyror të vetëmbrojtjes. Por është gjithashtu e vërtetë se një person dhe një popull janë të frytshëm vetëm nëse dinë të integrojnë në mënyrë krijuese brenda vetes hapjen ndaj të tjerëve. Ju ftoj që të shkoni përtej këtyre reagimeve të para, sepse "problemi është kur [ato] kushtëzojnë mënyrën tonë të të menduarit dhe të të vepruarit deri në atë pikë sa të na bëjnë intolerantë, të mbyllur, mbase madje - pa e kuptuar - racistë. Dhe kështu frika na privon nga dëshira dhe aftësia për ta takuar tjetrin".[45]

Iluzioni i komunikimit

42. Në mënyrë paradoksale, ndërsa rriten qëndrime të mbyllura dhe intolerante që na izolojnë nga të tjerët, distancat zvogëlohen ose zhduken deri në atë pikë sa nuk ekziston më e drejta për intimitet. Gjithçka bëhet një lloj spektakli që mund të përgjohet, të vëzhgohet dhe jeta ekspozohet ndaj një kontrolli të vazhdueshëm. Në komunikimin dixhital personat duan të tregojmë gjithçka dhe çdo individ bëhet objekt i vështrimeve që rrëmojnë, zhveshin dhe përhapin, shpesh në mënyrë anonime. Respekti për tjetrin

shkërmoqet dhe në këtë mënyrë, në të njëjtën kohë që e lëviz, e shpërfill dhe e mbaj larg, pa treguar pikë cipe mund të ndërhyj në jetën e tij deri në ekstrem.

43. Nga ana tjetër, lëvizjet dixhitale të urrejtjes dhe të shkatërrimit nuk janë - siç do të donin të na bënin të besonim disa - një formë e shkëlqyer e ndihmës së ndërsjellë, por thjesht shoqata kundër një armiku. Përkundrazi, "mediat dixhitale mund ta vënë personin në rrezikun e varësisë, të izolimit dhe të humbjes progresive të kontaktit me realitetin konkret, duke penguar zhvillimin e marrëdhënieve të vërteta ndërpersonale". [46] Ka nevojë për gjeste fizike, shprehje të fytyrës, heshtje, gjuhë trupi, madje edhe parfum, dridhje duarsh, skuqje, djersitje, sepse e gjithë kjo flet dhe është pjesë e komunikimit njerëzor. Marrëdhëniet dixhitale, që përjashtojnë nga angazhimi për të kultivuar një miqësi, një ndërsjellshmëri të qëndrueshme dhe një konsensus që piqet me kalimin e kohës, vetëm në dukje janë shoqërizuese. Nuk ndërtojnë me të vërtetë një "ne", por zakonisht maskojnë dhe amplifikojnë të njëjtin individualizëm që shprehet në ksenofobinë dhe në përbuzjen

ndaj të dobëtve. Lidhja dixhitale nuk mjafton për të ndërtuar ura, nuk është në gjendje ta bashkojë njerëzimin.

Agresion i paturpshëm

44. Pikërisht ndërsa mbrojnë izolimin e tyre konsumistik dhe të rehatshëm, personat zgjedhin të lidhen në një mënyrë të vazhdueshme dhe obsesive. Kjo favorizon gëlimin e formave të pazakonta të agresionit, të fyerjeve, të keqtrajtimeve, të ofendimeve, të fshikullimeve verbale deri në prishjen e figurës së tjetrit, me një mospërmbajtje që nuk mund të ekzistojë në kontaktin trup me trup, sepse do të përfundonim duke shkatërruar njëri-tjetrin. Agresiviteti shoqëror gjen te pajisjet e lëvizshme dhe te kompjuterat një hapësirë të pashembullt përhapjeje.

45. Kjo ka mundësuar që ideologjitë të braktisin çdo ndjenjë cipe. Ajo që deri para pak vitesh nuk mund të thuhej për askënd pa rrezikuar humbjen e respektit të të gjithë botës, sot mund të shprehet në mënyrën më të vrazhdë të mundshme edhe për disa autoritete politike dhe të mbetet e pandëshkuar. Nuk duhet të shpërfillet që “në botën dixhitale

veprojnë interesa tejet të mëdha ekonomike, të afta të krijojnë forma kontrolli sa të holla aq edhe depërtuese, duke krijuar mekanizma manipulimi të ndërgjegjeve dhe të procesit demokratik. Funksionimi i shumë platformave shpesh favorizon takimin mes personave që mendojnë në të njëjtën mënyrë, duke penguar ballafaqimin mes ndryshimeve. Këto qarqe të mbyllura lehtësojnë përhapjen e informacioneve dhe të lajmeve të rreme, duke nxitur paragjykime dhe urrejtje”.[47]

46. Duhet të pranohet se fanatizmat që çojnë në shkatërrimin e të tjerëve kanë si protagonistë edhe persona fetarë, pa përjashtuar të krishterët, të cilët “mund të marrin pjesë në rrjete të dhunës verbale nëpërmjet internetit dhe fushave apo hapësirave të ndryshme të shkëmbimit dixhital. Edhe në mediat katolike mund të kalohen kufijtë, të tolerohen shpifja dhe përgojimi, dhe duket sikur përjashtohet çdo etikë dhe respekt ndaj emrit të mirë të tjetrit”.[48] Duke vepruar kështu, çfarë kontributi i jepet vëllazërimit që Ati i përbashkët na propozon?

Informacion pa urti

47. Urtia e vërtetë presupozon takimin me realitetin. Por sot gjithçka mund të prodhohet, të fshihet, të ndryshohet. Kjo bën që takimi i drejtpërdrejtë me kufijtë e realitetit të bëhet i padurueshëm. Si pasojë, hyn në veprim një mekanizëm "përzgjedhës" dhe krijohet zakoni i ndarjes së menjëhershme mes asaj që më pëlqen dhe asaj që nuk më pëlqen, mes gjërave tërheqëse dhe atyre që janë të pakëndshme për mua. Me të njëjtën logjikë zgjidhen personat me të cilët vendoset që të bashkëndahet bota. Kështu personat ose situatat që kanë plagosur ndjeshmërinë tonë ose që kanë qenë të padëshirueshëm për ne sot thjesht eliminohen në rrjetet virtuale, duke ndërtuar një rreth virtual që na izolon nga bota në të cilën jetojmë.

48. Ulja ndenjur për ta dëgjuar tjetrin, karakteristikë e një takimi njerëzor, është paradigmë e një qëndrimi mikpritës, i atij që kapërcen narcizizmin dhe mikpret tjetrin, i kushton vëmendje, i bën vend në rrethin e tij. Sidoqoftë, "bota e sotme në pjesën më të madhe të saj është një botë e shurdhër […]. Ndonjëherë shpejtësia e botës

moderne na pengon që të dëgjojmë mirë atë që personi tjetër thotë. Dhe kur është në gjysmë të bisedës, e ndërpresim dhe duam t'i përgjigjemi ndërsa ai ende nuk ka mbaruar së foluri. Nuk duhet ta humbasim aftësinë për të dëgjuar". Shën Françesku i Asizit "ka dëgjuar zërin e Zotit, ka dëgjuar zërin e të varfrit, ka dëgjuar zërin e të sëmurit, ka dëgjuar zërin e natyrës. Dhe gjithë këtë e ka kthyer në një stil jete. Shpresoj që fara e Shën Françeskut të rritet në shumë zemra". [49]

49. Duke humbur heshtjen dhe të dëgjuarin, si dhe duke shndërruar gjithçka në batuta dhe mesazhe të shpejta dhe të padurueshme, rrezikohet struktura themelore e një komunikimi të urtë njerëzor. Krijohet një stil i ri jete ku ndërtojmë atë që duam të kemi përpara, duke përjashtuar gjithçka që nuk mund ta kontrollojmë apo ta njohim sipërfaqësisht dhe menjëherë. Kjo dinamikë, për shkak të logjikës së saj të brendshme, pengon reflektimin e qetë që mund të na çojë drejt një urtie të përbashkët.

50. Mund ta kërkojmë bashkë të vërtetën në dialog, në bisedën e qetë ose në diskutimin

e zjarrtë. Është një udhëtim ngulmues, i përbërë edhe nga heshtja dhe vuajtjet, i aftë që të mbledhë me durim përvojën e gjerë të individëve dhe të popujve. Grumbullimi shtypës i informacionit që na përmbyt nuk është i barabartë me një urti më të madhe. Urtia nuk prodhohet nga kërkimet e paduruara në *internet* dhe nuk është një shumë informacioni vërtetësia e të cilës nuk është e siguruar. Në këtë mënyrë nuk piqet në takimin me të vërtetën. Bisedat sillen rreth të dhënave të fundit, janë thjesht horizontale dhe kumulative. Nuk i kushtohet një vëmendje e gjatë dhe depërtuese në zemrën e jetës, nuk njihet ajo që është thelbësore për t'i dhënë domethënie ekzistencës. Kështu, liria bëhet një iluzion që na shitet dhe që ngatërrohet me lirinë për të lundruar përpara një ekrani. Problemi është se rrugën e vëllazërisë, vendore dhe të gjithëmbarshme, mund ta përshkojnë vetëm shpirtrat e lirë dhe të gatshëm për takime reale.

Nënshtrim dhe përçmim i vetvetes

51. Disa vende të forta ekonomikisht paraqiten si modele kulturore për vendet e pazhvilluara, në vend që të sigurohet që

secili të rritet me stilin e vet, duke zhvilluar aftësitë e veta për t'u përtërirë duk u bazuar te vlerat e kulturës së vet. Kjo nostalgji sipërfaqësore dhe e trishtë, e cila induce kopjimin e blerjen dhe jo krijimin, krijon një vetëvlerësim kombëtar shumë të ulët. Në sektorët e pasur të shumë vendeve të varfra, dhe nganjëherë në ata që kanë arritur të dalin nga varfëria, ndeshet një paaftësi për të pranuar karakteristikat dhe proceset vetjake, duke rënë në një përbuzje të identitetit të tyre kulturor, sikur të ishte shkaku i të gjitha të këqijave.

52. Prishja e vetëvlerësimit të dikujt është një mënyrë për ta sunduar atë. Pas tendencave që synojnë homogjenizimin e botës, shfaqen interesa pushteti që përfitojnë nga vetëvlerësimi i ulët, në momentin në të cilin, përmes mediave dhe rrjeteve, bëhen përpjekje për të krijuar një kulturë të re në shërbim të më të fuqishmëve. Nga kjo përfitojnë oportunizmi i spekulimit financiar dhe shfrytëzimi, ku të varfrit janë ata që humbasin gjithmonë. Nga ana tjetër, injorimi i kulturës së një populli bën të mundur që shumë udhëheqës politikë të mos jenë në gjendje që të promovojnë një projekt të

efektshëm, që lirisht mund të përdoret dhe të vazhdohet për njëfarë kohe.

53. Harrojmë se "nuk ka tjetërsim më të keq sesa të përjetosh se nuk ke rrënjë, se nuk i përket askujt. Një tokë do të jetë e frytshme, një popull do të japë fryte dhe do të jetë në gjendje të krijojë një të ardhme vetëm në masën që krijon marrëdhënie përkatësie mes anëtarëve të vet, në masën që krijon lidhje integrimi mes brezave dhe bashkësive të ndryshme që e përbëjnë atë; si dhe në masën që ajo thyen spiralet që turbullojnë shqisat, duke u larguar gjithmonë nga njëra-tjetra". [50]

Shpresa

54. Me gjithë këto hije të dendura, të cilat nuk duhet të shpërfillen, në vijim dëshiroj t'u jap zë shumë shtigjeve shprese. Në fakt, Hyji vazhdon të mbjellë farëra të mira te njerëzit. Pandemia që po kalojmë na ka mundësuar që të rimarrim dhe të vlerësojmë shumë shokë dhe shoqe udhëtimi të cilët, edhe pse me frikë, kanë reaguar duke dhënë jetën e tyre. Kemi qenë në gjendje të pranojmë se jetët tona janë të ndërthurura dhe të mbështetura nga persona të zakonshëm të cilët, pa dyshim,

kanë shkruar ngjarjet përcaktuese të historisë sonë të përbashkët: mjekë, infermierë dhe infermiere, farmacistë, punëtorë të supermarketeve, pastrues, kujdestarë, transportues, burra dhe gra që punojnë për të ofruar shërbime thelbësore dhe siguri, vullnetarë, priftërinj, rregulltare,... kanë kuptuar se askush nuk shpëton vetëm.[51]

55. Ju ftoj që të keni shpresë, e cila "na flet për një realitet që është rrënjosur thellë te qenia njerëzore, pavarësisht rrethanave konkrete dhe kushtëzimit historik në të cilin ajo jeton. Na flet për një etje, për një aspiratë, për një dëshirë të zjarrtë për plotësi, për një jetë të realizuar, për një matje të vetes me atë që është e madhe, me atë që mbush zemrën dhe lartëson shpirtin drejt gjërave të mëdha, të tilla si e vërteta, mirësia dhe bukuria, drejtësia dhe dashuria. [...] Shpresa është e guximshme, di të shohë përtej rehatisë personale, sigurive të vogla dhe kompensimeve që ngushtojnë horizontin, për t'u hapur ndaj idealeve të mëdha që e bëjnë jetën më të bukur dhe më dinjitoze".[52] Ecim me shpresë.

KAPITULLI I DYTË

NJË I HUAJ NË RRUGË

56. Gjithçka që kam përmendur në kapitullin e mëparshëm është më shumë sesa një përshkrim aseptik i realitetit, pasi "gëzimet dhe shpresat, trishtimet dhe ankthet e njerëzve të sotëm, sidomos të të varfërve dhe të të gjithë atyre që vuajnë, janë edhe gëzimet dhe shpresat, trishtimet dhe ankthet e nxënësve të Krishtit, dhe nuk ka gjë përnjëmend njerëzore që nuk gjen jehonë në zemrën e tyre".[53] Me qëllimin për të kërkuar një dritë në mes të asaj që po përjetojmë dhe para se të caktoj disa linja veprimi, dëshiroj t'i kushtoj një kapitull një shëmbëlltyre të rrëfyer nga Jezusi dy mijë vjet më parë. Në fakt, edhe pse kjo Letër u drejtohet të gjithë njerëzve vullnet mirë, pavarësisht bindjeve të tyre fetare, shëmbëlltyra shprehet në atë mënyrë që çdokush prej nesh të ndihet i interpeluar prej saj.

<<Dhe ja, u ngrit një dijetar Ligji dhe, me qëllim që ta provojë, e pyeti: "Mësues, çka duhet të bëj për të fituar jetën e pasosur?". "Çka shkruan në Ligj? - iu përgjigj Jezusi - Si lexon atje?". Dijetari iu përgjigj: "'Duaje Zotin, Hyjin tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë fuqinë tënde, dhe me gjithë mendjen tënde edhe 'të afërmin tënd porsi vetveten!'". *Jezusi i tha: "Mirë u përgjigje! Vepro kështu dhe do të jetosh!". Por ai, duke dëshiruar të përligjej, e pyeti Jezusin: "Kush është i afërmi im?". Jezusi vazhdoi e tha: "Një njeri po zbriste prej Jerusalemit në Jeriho e ra ndër cuba. Këta e plaçkitën, e rrahën dhe ikën dhe e lanë veç gjallë. Rastësisht po asaj rruge po zbriste një prift. E pa, iu shmang e vazhdoi rrugën. Po ashtu edhe një levit, kur arriti aty, e pa, iu shmang dhe vazhdoi udhën. Kurse një samaritanas, duke udhëtuar, kur erdhi tek ai dhe e pa, pati mëshirë për të, iu afrua, ia lidhi plagët duke ia pasë larë me verë e me vaj. Pastaj e vuri mbi shtazën e vet, e çoi në bujtinë dhe u kujdesua për të. Të nesërmen, nxori dy denarë, ia dha bujtinarit dhe i tha: 'M'u kujdes për të dhe, çka të shpenzosh më*

shumë, do t'i jap kur të kthehem'. Cili prej këtyre të treve, të thotë mendja, u dëftua i afërmi i atij njeriu që ra ndër cuba?". Ai iu përgjigj: "Ai që pati mëshirë për të!". "Shko - i tha Jezusi - e bëj edhe ti kështu!">> (Lk 10, 25-37).

SFONDI

57. Kjo shëmbëlltyrë mbledh një sfond shekujsh. Pak pas rrëfimit të krijimit të botës dhe të qenies njerëzore, Bibla paraqet sfidën e marrëdhënieve midis nesh. Kaini eliminon vëllanë e tij Abelin dhe tingëllon pyetja e Zotit: "Ku është vëllai yt, Abeli?" (Zan 4,9). Përgjigja është e njëjtë me atë që ne shpesh japim: "Pse a mos jam unë rojtari i tim vëllai?" (po aty). Me pyetjen e tij, Hyji vë në diskutim çdo lloj determinizmi ose fatalizmi që pretendon të justifikojë indiferencën si përgjigjen e vetme të mundshme. Përkundrazi, kjo na aftëson për të krijuar një kulturë tjetër, që na udhëzon t'i tejkalojmë armiqësitë dhe të kujdesemi për njëri-tjetrin.

58. Libri i Jobit i referohet faktit se kemi të njëjtin Krijues si bazë për të mbështetur

disa të drejta të përbashkëta: “A s’janë ata si unë vepër e Tij? S’na formoi një Hyj në krah’ror të nënës?” (Job 31,15). Shumë shekuj më vonë, Shën Ireneu do të shprehet në një mënyrë tjetër me imazhin e melodisë: “Prandaj kushdo që e do të vërtetën nuk duhet ta lërë veten të tërhiqet nga ndryshimi i secilit tingull ose të imagjinojë se dikush është autori dhe krijuesi i këtij tingulli dhe një tjetër është autori dhe krijuesi i tjetrit [...], por duhet të mendojë se e ka bërë një i vetëm”.[54]

59. Në traditat hebraike, domosdoshmëria për ta dashur dhe për t’u kujdesur për tjetrin dukej se kufizohej në marrëdhëniet midis anëtarëve të të njëjtit komb. Porosia e lashtë: “Duaje të afërmin tënd porsi vetveten” (Lev 19,18) zakonisht u referohej bashkatdhetarëve. Sidoqoftë, veçanërisht në Judaizëm që u zhvillua jashtë tokës të Izraelit, kufijtë u zgjeruan. Filloi të përdorej ftesa që të mos u bësh të tjerëve atë që nuk dëshiron që ata të ta bëjnë ty (krh. Tob 4,15). Hillel-i i mençur (shekulli I para Krishtit) në lidhje me këtë ka thënë: “Ky është Ligji dhe Profetët. E gjithë pjesa tjetër është koment”.[55] Dëshira për t’i imituar

qëndrimet hyjnore çoi në kapërcimin e asaj prirjeje për t'u kufizuar vetëm te më të afërmit: "Mëshira e njerëzve ushtrohet ndaj të afërmit, ndërsa mëshira e Hyjit ushtrohet ndaj të gjithë të gjallëve" (Sir 18,12).

60. Në Besëlidhjen e Re, porosia e Hillel-it ka gjetur shprehje pozitive: "Gjithçka dëshironi t'ju bëjnë juve njerëzit, bëni edhe ju atyre! Ja, vërtet Ligji dhe Profetët" (Mt 7,12). Ky apel është universal, ka prirje t'i përqafojë të gjithë, vetëm për shkak të gjendjes së tyre njerëzore, sepse i Tejetlarti, Ati qiellor "bën të lindë dielli i tij mbi të këqij e mbi të mirë" (Mt 5,45). Dhe për pasojë kërkohet: "Bëhuni edhe ju të mëshirshëm sikurse (edhe) Ati juaj është i mëshirshëm" (Lk 6,36).

61. Ekziston një arsye për ta zmadhuar zemrën në mënyrë që ajo të mos e përjashtojë të huajin dhe kjo arsye gjendet në tekstet më të lashta të Biblës: përkujtimi i vazhdueshëm i popullit hebre i faktit se jetonin si të huaj në Egjipt: "Mos e shfrytëzo as mos e shtyp të huajin, sepse edhe ju qetë të huaj në dheun e Egjiptit" (Dal 22,20). "Mos e nëpërkëmbni të ardhurin, sepse e njihni jetën e ardhacakut;

edhe ju keni qenë ardhacakë në dheun e Egjiptit" (Dal 23,9). "Nëse jeton me ty i huaji në tokën tuaj, mos e shtypni; por le të jetë ndër ju si vendas dhe duaje si vetveten: edhe ju keni qenë të huaj në dheun e Egjiptit" (Lev 19,33-34). "Nëse e ke vjelë vreshtin tënd, mos i mblidh vilet që kanë mbetur, por le të mbesin për t'i përdorur ardhacaku, bonjaku e vejusha. Mos harro se edhe ti ke qenë skllav në Egjipt!" (Lp 24,21-22). Në Besëlidhjen e Re tingëllon me forcë apeli i dashurisë vëllazërore: "Sepse i tërë Ligji përmblidhet në këtë urdhër: *Duaje të afërmin tënd porsi vetveten!"* (Gal 5,14). "Kush e do vëllain e vet, ai është vazhdimisht në dritë, në të s'ka asgjë që ta bëjë të gabojë. Kush e urren vëllain e vet, gjendet në errësirë" (1Gjn 2,10-11). "Ne e dimë se kemi kaluar prej vdekjes në jetë, për arsye se i duam vëllezërit. Kush nuk ka dashuri, mbetet në vdekje" (1Gjn 3,14). "Sepse kush nuk e do vëllain e vet që e sheh, Hyjin që nuk e sheh, s'mund ta dojë" (1Gjn 4,20).

62. Edhe ky propozim dashurie mund të keqkuptohej. Jo më kot, përpara tundimit të bashkësive të para të krishtera për të formuar grupe të mbyllura dhe të izoluara, Shën Pali i

nxiste nxënësit e vet që të kishin dashuri midis tyre "dhe ndaj të gjithë njerëzve" (1Sel 3,12); dhe në bashkësinë e Gjonit lindte pyetja nëse u bëhej mirë edhe "vëllezërve,... (edhe pse) të huaj (3 Gjn 5). Ky kontekst na ndihmon për të kuptuar vlerën e shëmbëlltyrës së samaritanit të mirë: dashuria nuk interesohet nëse vëllai i plagosur vjen nga këtu apo atje. Sepse është "dashuria ajo që thyen zinxhirët që na izolojnë dhe ndajnë, duke ndërtuar ura; dashuri që na mundëson të ndërtojmë një familje të madhe ku të gjithë mund të ndihemi si në shtëpi […]. Dashuri që njeh dhembshurinë dhe dinjitetin".[56]

I BRAKTISUR

63. Jezusi tregon se ishte një i plagosur shtrirë buzë rrugës, i cili ishte sulmuar nga cubat. Njerëz të ndryshëm kaluan pranë tij, por u larguan, nuk u ndalën. Ishin njerëz me funksione të rëndësishme në shoqëri, të cilët nuk kishin dashuri në zemrat e tyre për të mirën e përbashkët. Nuk qenë në gjendje të humbnin disa minuta për ta ndihmuar të plagosurin ose të paktën për të kërkuar ndihmë. Njëri ndaloi, iu afrua, e mjekoi me duart e veta, pagoi nga xhepi i tij dhe u kujdes

për të. Mbi të gjitha i dha diçka që në këtë botë të nxituar kursejmë shumë: i dha kohën e vet. Me siguri ai kishte planet e tij për ta përdorur atë ditë në përputhje me nevojat, orarin ose dëshirat e tij. Por ai qe në gjendje që të linte gjithçka mënjanë përpara atij të plagosuri dhe pa e njohur atë, e konsideroi të denjë që të merrte si dhuratë kohën e tij.

64. Me kë identifikohesh? Kjo pyetje është e vështirë, e drejtpërdrejtë dhe vendimtare. Cilit prej tyre i përngjet? Duhet ta njohim tundimin që na rrethon për të mos u interesuar për të tjerët, veçanërisht për më të ligshtët. Le ta pranojmë, jemi rritur në shumë aspekte, por jemi analfabetë në shoqërimin, kujdesin dhe mbështetjen e më të brishtëve dhe më të dobëtve të shoqërive tona të zhvilluara. Jemi mësuar t'i largojmë sytë, të kalojmë përbri, t'i shpërfillim situatat derisa ato nuk na prekin drejtpërdrejt.

65. Sulmojnë një person në rrugë dhe shumë ikin sikur të mos kishin parë asgjë. Shpesh ka njerëz që godasin dikë me makinën e tyre dhe ikin. Thjesht mendojnë që të mos kenë probleme, nuk ka rëndësi nëse një qenie njerëzore vdes për shkak të

tyre. Por këto janë shenja të një stili jete të përgjithësuar, i cili shfaqet në mënyra të ndryshme, ndoshta më të holla. Për më tepër, meqë të gjithë jemi shumë të përqendruar në nevojat tona, kur shohim dikë që vuan na bezdis, na shqetëson, sepse nuk duam të humbasim kohë për shkak të problemeve të të tjerëve. Këto janë simptoma të një shoqërie të sëmurë, sepse synon të ndërtohet duke i kthyer shpinën dhimbjes.

66. Më mirë të mos biem në këtë mjerim. Le të shohim modelin e samaritanit të mirë. Është një tekst që na fton të ringjallim thirrjen tonë si qytetarë të vendit tonë dhe të mbarë botës, ndërtues të një lidhjeje të re shoqërore. Është një thirrje gjithnjë e re, edhe pse është shkruar si një ligj themelor i qenies sonë: shoqëria duhet të ecë drejt ndjekjes së të mirës së përbashkët dhe, duke u nisur nga ky qëllim, gjithmonë ta rindërtojë rendin e vet politik dhe shoqëror, strukturën e vet të marrëdhënieve, projektin e vet njerëzor. Me gjestet e tij, samaritani i mirë tregoi se "ekzistenca e secilit prej nesh është e lidhur me atë të të tjerëve: jeta nuk është kohë që kalon, por kohë takimi".[57]

67. Kjo shëmbëlltyrë është një ikonë ndriçuese, e aftë të nxjerrë në pah opsionin themelor që duhet të bëjmë për ta rindërtuar këtë botë që na shkakton dhimbje. Përpara shumë dhimbjesh, shumë plagësh, e vetmja rrugëdalje është që të jemi si samaritani i mirë. Çdo zgjedhje tjetër na vë në anën e cubave ose në atë të atyre që kalojnë aty pa pasur dhembshuri për vuajtjet e njeriut të plagosur buzë rrugës. Shëmbëlltyra na tregon se me çfarë nismash mund të rindërtohet një bashkësi duke filluar nga burra dhe gra që marrin përsipër dobësinë e të tjerëve, që nuk lejojnë të ndërtohet një shoqëri përjashtimi, por bëhen të afërt, ngrejnë dhe rehabilitojnë njeriun e rrëzuar, me qëllim që e mira të jetë e zakonshme. Në të njëjtën kohë, shëmbëlltyra na paralajmëron për disa qëndrime të caktuara të njerëzve që shikojnë vetëm veten e tyre dhe nuk marrin parasysh kërkesat e pashmangshme të realitetit njerëzor.

68. Tregimi, le ta themi qartë, nuk përçon një mësim idealesh abstrakte dhe as nuk kufizohet në funksionalitetin e një morali etiko-shoqëror. Na zbulon një karakteristikë thelbësore të qenies njerëzore, shpesh të harruar: jemi krijuar për plotësinë

që arrihet vetëm në dashuri. Të jetojmë shpërfillësh përpara dhimbjes nuk është një zgjedhje e mundshme; nuk mund të lëmë që dikush të mbetet "buzë jetës". Kjo duhet të na indinjojë, deri në pikën që të na bëjë të zbresim nga qetësia jonë për të na tronditur me vuajtjet njerëzore. Ky është dinjitet.

Një histori që përsëritet

69. Rrëfimi është i thjeshtë dhe linear, por përmban krejt dinamikën e luftës së brendshme që zhvillohet në përpunimin e identitetit tonë, në çdo ekzistencë të projektuar në rrugën për të realizuar vëllazërinë njerëzore. Sapo të nisemi, në mënyrë të pashmangshme takohemi me njeriun e plagosur. Sot, dhe gjithnjë e më shumë, ka njerëz të plagosur. Përfshirja apo përjashtimi i atyre që vuajnë gjatë rrugës përcakton të gjitha projektet ekonomike, politike, sociale dhe fetare. Çdo ditë përballemi me zgjedhjen për të qenë samaritanë të mirë ose kalimtarë shpërfillës që vazhdojnë rrugën. Dhe nëse e hedhim shikimin tonë në tërësisë e historisë sonë dhe të botës si një e tërë, të gjithë jemi ose kemi qenë si këta personazhe: të gjithë kemi diçka nga i plagosuri, diçka nga cubat,

diçka nga ata që vazhdojnë rrugën dhe diçka nga samaritani i mirë.

70. Është interesante se si ndryshimet midis personazheve të tregimit dalin plotësisht të shndërruar kur ballafaqohen me shfaqjen e dhimbshme të njeriut të rrëzuar, të poshtëruar. Nuk ka më dallim midis një banori të Judesë dhe një banori të Samarisë, nuk ka asnjë prift ose tregtar; thjesht ka dy lloje njerëzish: ata që marrin përsipër dhimbjen dhe ata që vazhdojnë rrugën; ata që përkulen duke njohur njeriun e rrëzuar dhe ata që shikojnë larg dhe shpejtojnë hapin e tyre. Në fakt, maskat tona të shumta, etiketat dhe maskimet tona bien: është ora e të vërtetës. A do të përkulemi për t'i prekur dhe për t'i shëruar plagët e të tjerëve? A do të përkulemi për ta vënë në shpinë njëri-tjetrin? Kjo është sfida aktuale, nga e cila nuk duhet të kemi frikë. Në momente krize, zgjedhja bëhet e ngutshme: mund të themi se, në këtë moment, kushdo që nuk është cub dhe nuk vazhdon rrugën, ose është i plagosur ose po mban disa të plagosur në shpinë.

71. Historia e samaritanit të mirë përsëritet: është gjithnjë e më e qartë se

neglizhenca sociale dhe politike i bën shumë vende në botë rrugë të shkreta, ku mosmarrëveshjet e brendshme dhe ndërkombëtare, si dhe plaçkitja e mundësive lënë shumë të mënjanuar buzë rrugës. Në shëmbëlltyrën e tij, Jezusi nuk paraqet rrugë alternative, të tilla si p.sh.: çfarë do t'i kishte ndodhur të plagosurit rëndë ose atij që e ka ndihmuar nëse inati ose etja për hakmarrje do të kishin zënë vend në zemrat e tyre? Ai beson në pjesën më të mirë të shpirtit njerëzor dhe me këtë shëmbëlltyrë e inkurajon atë që t'i përmbahet dashurisë, të rikuperojë të vuajturin dhe të ndërtojë një shoqëri të denjë për këtë emër.

Personazhet

72. Shëmbëlltyra fillon me cubat. Pika e nisjes që Jezusi zgjedh është një skenë agresioni. Kjo nuk na bën që të ndalemi dhe të ankohemi për këtë fakt, nuk e drejton vështrimin tonë drejt cubave. Ne i njohim ata. I kemi parë të përparojnë në botë hijet e dendura të braktisjes, të dhunës së përdorur për interesa meskine të pushtetit, të grumbullimit dhe të ndarjes. Pyetja mund të jetë: a do ta lëmë personin e plagosur në tokë

për ta mbrojtur veten prej dhunës apo për t'i ndjekur cubat? A do të jetë ai i plagosur justifikimi i ndarjeve tona të papajtueshme, i shpërfilljes sonë mizore, i betejave tona të brendshme?

73. Pastaj shëmbëlltyra na bën ta ngulim shikimin tonë tek ata që vazhdojnë rrugën. Kjo shpërfillje e rrezikshme për të shkuar përtej pa u ndalur, e pafajshme ose jo, fryt i përbuzjes apo i një shpërqendrimi të trishtë, i bën personazhet e priftit dhe të levitit një pasqyrim jo më pak të trishtuar të asaj largësie që i izolon ata nga realiteti. Ka shumë mënyra për të vazhduar rrugën, plotësuese të njëra-tjetrës. Njëra është të mbyllemi në vetvete, ta humbasim interesin për të tjerët, të jemi shpërfillës. Një tjetër do të ishte thjesht të shikonim jashtë. Në lidhje me këtë mënyrë të fundit të të vazhduarit e rrugës, në disa vende apo në disa sektorë të caktuar të tyre, ekziston një përbuzje ndaj të varfërve dhe kulturës së tyre, dhe ndaj një të jetuari që e hedh vështrimin jashtë, sikur një projekt vendi i importuar të përpiqej të zinte vendin e tyre. Kështu mund të justifikohet shpërfillja e disave, sepse ata që mund të prekin zemrat e tyre me kërkesat e

veta thjesht nuk ekzistojnë. Ata janë jashtë horizontit të tyre të interesave.

74. Tek ata që vazhdojnë rrugën ekziston një detaj që nuk mund ta shpërfillim: ata ishin njerëz fetarë. Për më tepër, merreshin me adhurimin e Hyjit: një prift dhe një levit. Kjo është për t'u theksuar: tregon se besimi dhe adhurimi ndaj Hyjit nuk garanton që të jetojmë ashtu siç i pëlqen Hyjit. Një person fetar mund të mos jetë besnik ndaj gjithçkaje që kërkon feja, e megjithatë mund të ndihet afër Hyjit dhe të mbahet më i denjë sesa të tjerët. Nga ana tjetër, ka mënyra për ta jetuar fenë që favorizojnë hapjen e zemrës ndaj vëllezërve dhe kjo do të jetë garancia e një hapjeje autentike ndaj Hyjit. Shën Gjon Gojarti arriti ta shprehte me shumë qartësi këtë sfidë që u paraqitet të krishterëve: "A dëshiron vërtet ta nderosh trupin e Krishtit? Mos e përbuz kur ai është lakuriq. Mos e ndero në tempull me rroba mëndafshi, ndërsa jashtë e lë që ai të vuajë të ftohtin dhe lakuriqësinë".[58] Paradoksi është që, nganjëherë, ata që thonë se nuk besojnë mund ta jetojnë vullnesën e Hyjit më mirë sesa vetë besimtarët.

75. “Cubat e rrugës” zakonisht kanë si aleatë të fshehtë ata që “kalojnë përgjatë rrugës duke shikuar nga ana tjetër”. Rrethi mbyllet midis atyre që e përdorin dhe e mashtrojnë shoqërinë për ta përtharë atë dhe atyre që mendojnë se po mbajnë pastërtinë në funksionin e tyre kritik, por në të njëjtën kohë jetojnë nga ai sistem dhe burimet e tij. Ekziston një hipokrizi e trishtë aty ku pandëshkueshmëria e krimit, e përdorimit të institucioneve për interesa personale ose të korporatave, dhe të këqija të tjera që ne nuk mund t’i eleminojmë, kombinohen në një skualifikim të përhershëm të gjithçkaje, me mbjelljen e vazhdueshme të dyshimit duke propaganduar mosbesim dhe mëdyshje. Mashtrimit se “gjithçka shkon keq” i përgjigjet një “askush nuk mund t’i rregullojë gjërat”, “çfarë mund të bëj unë?”. Në këtë mënyrë, ushqehen zhgënjimi dhe mungesa e shpresës, dhe kjo nuk inkurajon një shpirt solidariteti dhe bujarie. Zhytja e një populli në dekurajim është mbyllja e një rrethi të përsosur vicioz: kështu vepron diktatura e padukshme e interesave të fshehura, të cilat kanë kapur burimet dhe aftësinë për të pasur mendime dhe për të menduar.

76. Tani në fund, le të shohim të plagosurin. Ndonjëherë ndihemi si ai, të plagosur rëndë dhe përtokë buzë rrugës. Ndihemi edhe të braktisur nga institucionet tona të çarmatosura dhe të mangëta apo që synojnë shërbimin e interesave të disave, brenda dhe jashtë. Në fakt, "në shoqërinë e globalizuar, ekziston një mënyrë elegante për të shikuar nga ana tjetër që praktikohet zakonisht: nën veshjen e politikisht korrektes apo të modave ideologjike dikush shikon personin që vuan pa e prekur atë, e tregojnë në televizion drejtpërdrejt, bëhet edhe një diskutim në dukje tolerant dhe plot eufemizma".[59]

T'ia rifillosh

77. Çdo ditë na ofrohet një mundësi e re, një etapë e re. Nuk duhet të presim gjithçka nga ata që na qeverisin, do të ishte fëminore. Gëzojmë një hapësirë bashkë-përgjegjësie të aftë për të filluar dhe për të prodhuar procese dhe shndërrime të reja. Duhet të jemi pjesë aktive në rehabilitimin dhe në mbështetjen e shoqërive të plagosura. Sot jemi përballë mundësisë së madhe për të qenë vëllezër, për të qenë samaritan të tjerë të mirë që

marrin përsipër dhimbjen e dështimeve, në vend që të nxisin urrejtje dhe mllefe. Ashtu si kalimtari i rastit në historinë tonë, duhet vetëm dëshira falas, e pastër dhe e thjeshtë për të qenë popull, për të qenë të qëndrueshëm dhe të palodhshëm në angazhimin për të përfshirë, për të integruar dhe për të ngritur atë që është rrëzuar; edhe pse shumë herë e gjejmë veten të zhytur dhe të dënuar për ta përsëritur logjikën e të dhunshmëve, të atyre që ushqejnë ambicie vetëm për veten e tyre dhe që përhapin konfuzion e gënjeshtra. Që të tjerë vazhdojnë ta mendojnë politikën apo ekonominë për lojërat e tyre të pushtetit. Le të ushqejmë atë që është e mirë dhe të vihemi në shërbim të së mirës.

78. Është e mundur që të fillojmë nga poshtë dhe rast pas rasti, të luftojmë për atë që është më konkrete dhe lokale, deri në cepin më të fundit të atdheut dhe të botës, me të njëjtin kujdes që kalimtari nga Samaria pati për çdo plagë të të plagosurit. T'i kërkojmë të tjerët dhe të marrim përgjegjësinë e realitetit që na përket, pa pasur frikë nga dhimbja ose pafuqia, sepse aty është gjithë e mira që Hyji ka mbjellë në zemrën e qenies njerëzore. Vështirësitë që duken të

stërmëdha janë mundësia për t'u rritur dhe jo justifikimi për trishtimin e plogësht që favorizon nënshtrimin. Por mos ta bëjmë atë vetëm, individualisht. Samaritani kërkoi dikënd që të kujdesej për atë njeri, ashtu sikurse ne jemi të thirrur që të ftojmë dhe të takohemi në një "ne", që është më i fortë sesa shuma e individualiteteve të vogla; të kujtojmë se "e tëra është më e madhe se një pjesë e veçantë, por është gjithashtu më e madhe se shuma e pjesëve të saj".[60] Të heqim dorë nga meskiniteti dhe mllefi i partikularizmave sterilë, të kontradiktave pa fund. Të reshtim së fshehuri dhimbjen e humbjeve dhe të marrim përgjegjësinë e krimeve tona, të plogështive tona dhe të gënjeshtrave tona. Pajtimi riparues do të na ringjallë dhe do të bëjë që ne dhe të tjerët të mos kemi më frikë.

79. Samaritani i rrugës u largua pa pritur mirënjohje ose falënderime. Përkushtimi ndaj shërbimit ishte kënaqësia e madhe përpara Hyjit dhe jetës së vet, dhe për këtë arsye një detyrë. Të gjithë kemi një përgjegjësi për atë të plagosur, që është vetë populli dhe të gjithë popujt e tokës. Të kujdesemi për dobësinë e çdo burri, të çdo gruaje, të çdo fëmije dhe

të çdo personi të moshuar, me atë qëndrim solidar dhe të vëmendshëm, qëndrimin e afërsisë së samaritanit të mirë.

I AFËRMI PA KUFIJ

80. Jezusi e propozoi këtë shëmbëlltyrë për t'iu përgjigjur një pyetjeje: kush është i afërmi im? Fjala "i afërm" në shoqërinë e kohës së Jezusit zakonisht tregonte atë që është më afër. Kuptohej se ndihma duhet t'i jepej para së gjithash atij që i përkiste të njëjtit grup, të njëjtës racë. Një samaritan, për disa hebrenj të asaj kohe, konsiderohej një person i përbuzur, i papastër dhe për këtë arsye nuk përfshihej midis të afërmve të cilëve duhej t'u jepej ndihmë. Jezusi judeas e përmbys krejtësisht këtë normë: nuk na thërret për të na pyetur se kush është afër nesh, por për t'u bërë ne të afërt.

81. Propozimi është që të jemi të pranishëm tek personi që ka nevojë për ndihmë, pa shikuar nëse i përket rrethit tonë apo jo. Në këtë rast, samaritani ka qenë ai që *është bërë i afërmi* i judeut të plagosur. Për t'u bërë i afërt dhe i pranishëm, ai ka tejkaluar të gjitha barrierat kulturore dhe historike.

Përfundimi i Jezusit është një kërkesë: “Hajt e bëj edhe ti kështu” (Lk 10,37). Domethënë na kërkon që t’i lëmë mënjanë të gjitha ndryshimet dhe, përballë vuajtjes, të bëhemi të afërmit e kujdo. Prandaj, nuk them më që kam “të afërm” për të ndihmuar, por që ndihem i thirrur për t’u bërë i afërmi i të tjerëve.

82. Problemi është se, shprehimisht, Jezusi vë në dukje se i plagosuri ishte një judeas - një banor i Judesë - ndërsa ai që ndaloi dhe e ndihmoi atë ishte një samaritan - një banor i Samarisë -. Ky detaj ka një rëndësi shumë të madhe për të reflektuar mbi një dashuri që është e hapur ndaj të gjithëve. Samaritanit banonin në një rajon që ishte ndotur nga rite pagane dhe për judejtë kjo i bënte ata të papastër, të urryeshëm, të rrezikshëm. Në fakt, një tekst i lashtë hebraik, që përmend kombet e denja për përbuzje, i referohet Samarisë duke pohuar madje se “as që është popull” (Sir 50,27) dhe shton duke e quajtur atë “popullin e marrë që banon në Sikem” (rr. 28).

83. Kjo shpjegon pse një grua samaritane, kur Jezusi i kërkoi ujë, iu përgjigj prerë: “Si?

Ti që je judeas, kërkon ujë prej meje që jam samaritane? (Gjn 4,9). Ata që po kërkonin akuza që mund ta diskreditonin Jezusin, gjëja më fyese që gjetën ishte t'i thoshin atij "se në trup e ke djallin" dhe "samaritanas" (Gjn 8,48). Prandaj, ky takim i mëshirshëm midis një samaritani dhe një judeasi është një provokim i fuqishëm, i cili mohon çdo manipulim ideologjik, me qëllim që ne ta zgjerojmë rrethin tonë, duke i dhënë aftësisë sonë për të dashur një përmasë universale, në gjendje për t'i kapërcyer të gjitha paragjykimet, të gjitha barrierat historike ose kulturore, të gjitha interesat meskine.

Apeli i të huajit

84. Në fund, kujtoj se në një pjesë tjetër të Ungjillit Jezusi tha: "Isha shtegtar e më përbujtët" (Mt 25,35). Jezusi mund t'i thoshte këto fjalë, sepse ai kishte një zemër të hapur që i bënte të vetat dramat e të tjerëve. Shën Pali nxiste: "Gëzohuni me ata që gëzojnë, qani me ata që qajnë!" (Rom 12,15). Kur zemra merr këtë qëndrim, është e aftë ta identifikojë veten me tjetrin, pavarësisht se ku ka lindur apo nga vjen. Duke hyrë në këtë dinamikë, si përfundim ai përjeton se të

tjerët janë “farefisi yt” (krh. Is 58,7).

85. Për të krishterët, fjalët e Jezusit kanë gjithashtu një përmasë tjetër, transhendente. Përfshijnë njohjen e Krishtit në çdo vëlla të braktisur ose të përjashtuar (krh. Mt 25,40.45). Në realitet, feja mbush njohjen e tjetrit me motivacione të papara, sepse ai që beson mund të pranojë se Zoti e do çdo qenie njerëzore me një dashuri të pafund dhe se “kështu i jep atij një dinjitet të pafund”. [61] Kësaj i shtojmë faktin se besojmë që Krishti derdhi gjakun e tij për të gjithë dhe për secilin, dhe për këtë arsye askush nuk mbetet jashtë dashurisë së tij universale. Dhe nëse shkojmë te burimi i fundit, që është jeta intime e Hyjit, takohemi me një bashkësi prej tre Personash, origjina dhe modeli i përsosur i çdo jete të përbashkët. Teologjia vazhdon të pasurohet falë reflektimit mbi këtë të vërtetë të madhe.

86. Ndonjëherë më trishton fakti që, megjithëse ishte e pajisur me motivime të tilla, Kisha mori kaq shumë kohë për të dënuar me forcë skllavërinë dhe format e ndryshme të dhunës. Sot, me zhvillimin e përshpirtërisë dhe të teologjisë, nuk kemi

më justifikime. Sidoqoftë, ka akoma nga ata që ndihen të inkurajuar ose të paktën të autorizuar nga feja e tyre për të mbështetur forma të ndryshme nacionalizmi të mbyllur dhe të dhunshëm, qëndrime ksenofobe, përbuzje dhe madje edhe keqtrajtime të atyre që janë të ndryshëm. Feja, me humanizmin që frymëzon, duhet të mbajë gjallë një sens kritik përballë këtyre prirjeve dhe të ndihmojë për të reaguar shpejt kur ato fillojnë të shfaqen. Prandaj është e rëndësishme që katekeza dhe predikimi ta përfshijnë në mënyrë më të drejtpërdrejtë dhe të qartë kuptimin shoqëror të ekzistencës, përmasën vëllazërore të përshpirtërisë, bindjen në dinjitetin e patjetërsueshëm të çdo personi dhe motivimet për t'i dashur dhe për të mikpritur të gjithë.

KAPITULLI I TRETË

TË MENDOSH DHE TË KRIJOSH NJË BOTË TË HAPUR

87. Një qenie njerëzore është bërë në mënyrë të tillë që ai të mos realizohet, të mos zhvillohet dhe të mos e gjejë plotësinë e tij përveçse "nëpërmjet një dhurimi të sinqertë të vetvetes".[62] Po ashtu nuk arrin që ta njohë plotësisht të vërtetën e vet përveçse në takimin me të tjerët: "Nuk komunikoj me veten time përveçse në masën me të cilën komunikoj me tjetrin".[63] Kjo shpjegon pse askush nuk mund ta përjetojë vlerën e jetës pa fytyra konkrete për të dashur. Këtu qëndron një sekret i ekzistencës autentike njerëzore, sepse "jeta ekziston atje ku ka lidhje, bashkësi, vëllazëri; dhe është një jetë më e fortë se vdekja kur ndërtohet mbi marrëdhënie të vërteta dhe lidhje besnikërie. Përkundrazi, nuk ka jetë aty ku dikush pretendon se i përket vetëm vetvetes dhe se jeton si ishull: në këto qëndrime

mbizotëron vdekja”.[64]

PËRTEJ

88. Nga thellësia e çdo zemre, dashuria krijon lidhje dhe zgjeron ekzistencën kur e nxjerr personin nga vetja e tij drejt tjetrit.[65] Jemi krijuar për dashurinë dhe në secilin prej nesh ka “një lloj ligji ‘ekstaze’: të dalësh prej vetes për të gjetur tek të tjerët një shtim të vetes”.[66] Prandaj “në çdo rast, njeriu gjithashtu duhet të vendosë që të dalë menjëherë jashtë vetvetes”.[67]

89. Nga ana tjetër, nuk mund ta zvogëloj jetën time duke pasur marrëdhënie vetëm me një grup të vogël apo edhe vetëm me familjen time, sepse është e pamundur që ta kuptoj veten time pa një strukturë më të gjerë marrëdhëniesh: jo vetëm atë aktuale, por edhe atë që më paraprin dhe që ka marrë formë gjatë gjithë jetës sime. Marrëdhënia ime me një person që vlerësoj nuk mund të shpërfillë faktin se ai person nuk jeton vetëm për marrëdhënien e tij me mua dhe as unë nuk jetoj vetëm për të pasur marrëdhënie me të. Marrëdhënia jonë, nëse është e shëndetshme dhe autentike, na hap ndaj të

tjerëve, që na rrisin dhe pasurojnë. Ndjenja më fisnike shoqërore sot lehtësisht anullohet pas intimizmave egoistë me aparencën e marrëdhënieve intensive. Përkundrazi, dashuria që është autentike, që të ndihmon të rritesh dhe format më fisnike të miqësisë banojnë zemra që ia lejojnë vetes që të plotësohen. Lidhja e çiftit dhe e miqësisë është e orientuar që të na e hapë zemrën përreth nesh, me qëllim që të bëhemi të aftë të dalim prej vetvetes deri në atë sa t'i mikpresim të gjithë. Grupet e mbyllura dhe çiftet vetë-referuese, të cilët e ndërtojnë veten si një "ne" që i kundërvihet mbarë botës, zakonisht janë forma të idealizuara të egoizmit dhe janë thjesht për vetëmbrojtje.

90. Nuk është rastësi që shumë popullsi të vogla, që kanë mbijetuar në zonat shkretinore, kanë zhvilluar një aftësi bujare për t'i mikpritur shtegtarët që kalojnë aty, duke dhënë kështu një shenjë shembullore të detyrës së shenjtë të mikpritjes. E kanë përjetuar edhe bashkësitë mesjetare të manastireve, siç shihet në Rregulloren e Shën Benediktit. Megjithëse mund të prishte rregullin dhe heshtjen e manastireve, Benedikti kërkonte që të varfrit dhe shtegtarët

të trajtoheshin "me gjithë respektin dhe kujdesin e mundshëm".[68] Mikpritja është një mënyrë konkrete për të mos e privuar veten nga kjo sfidë dhe nga kjo dhuratë që është takimi me njerëzimin përtej grupit vetjak. Ata njerëz e kuptuan se të gjitha vlerat që ata mund të kultivonin duhej të shoqëroheshin nga kjo aftësi për ta kapërcyer veten në një hapje ndaj të tjerëve.

Vlera unike e dashurisë

91. Njerëzit mund të zhvillojnë disa qëndrime të caktuara që i paraqesin si vlera morale: fortësi, thjeshtësi, zell dhe virtyte të tjera. Por, për t'i orientuar siç duhet veprimet e virtyteve të ndryshme morale, duhet të merret parasysh edhe se në çfarë mase ato zhvillojnë një dinamizëm hapjeje dhe bashkimi me njerëzit e tjerë. Ky dinamizëm është dashuria-bamirësi që Zoti përhap. Përndryshe, ndoshta do të kemi vetëm një aparencë virtytesh që nuk do të jenë në gjendje të ndërtojnë një jetë në bashkësi. Prandaj Shën Toma i Akuinit - duke cituar Shën Agustinin - thoshte se vetëpërmbajtja e një personi koprrac nuk është aq e virtytshme.[69] Me fjalë të tjera, Shën

Bonaventure shpjegonte se virtytet e tjera, pa dashurinë-bamirësi, nuk i përmbushin urdhërimet "ashtu siç i kupton Zoti".[70]

92. Masa shpirtërore e një ekzistence njerëzore përcaktohet nga dashuria, e cila në fund të fundit është "kriteri për vendimin përfundimtar mbi vlerën ose mosvlerën e një jete njerëzore".[71] Sidoqoftë, ka besimtarë që mendojnë se madhështia e tyre qëndron në diktimin e ideologjive të tyre të tjerëve, në mbrojtjen e dhunshme të së vërtetës apo në shfaqjet e mëdha të forcës. Të gjithë ne besimtarët duhet ta pranojmë këtë: në radhë të parë është dashuria, ajo që nuk duhet të vihet kurrë në rrezik është dashuria, rreziku më i madh është të mos duajmë (krh. 1Kor 13,1-13).

93. Duke u përpjekur që të saktësojë se çfarë është përvoja e dashurisë, që Zoti e bën të mundur falë hirit të vet, Shën Toma i Akuinit e shpjegonte atë si një lëvizje që e përqendron vëmendjen tek tjetri "duke e konsideruar atë si një gjë të vetme me vetveten".[72] Vëmendja afektive që i jepet tjetrit të orienton që të kërkosh të mirën e tij falas. E gjithë kjo zë fill nga një vlerësim,

një çmuarje, që në fund të fundit është ajo që qëndron pas fjalës "dashuri-bamirësi": personi që dua është edhe "i dashur" dhe "i shtrenjtë" për mua, domethënë e konsideroj si një qenie që ka vlerë të madhe.[73] Dhe "prej dashurisë, e cila më bën që ta pëlqej një person të caktuar, rrjedhin kënaqësitë ndaj tij".[74]

94. Prandaj, dashuria nënkupton diçka më shumë sesa një seri veprimesh të dobishme. Veprimet rrjedhin nga një bashkim që anon gjithnjë e më shumë drejt tjetrit, duke e konsideruar atë si të çmueshëm, të denjë, të këndshëm dhe të bukur, përtej dukjeve të jashtme fizike ose morale. Dashuria për tjetrin ashtu si ai është na shtyn që të kërkojmë më të mirën për jetën e tij. Vetëm duke kultivuar këtë mënyrë të krijimit të marrëdhënies do të bëjmë të mundur atë miqësi shoqërore që nuk përjashton askënd dhe atë vëllazëri të hapur ndaj të gjithëve.

Hapja progresive e dashurisë

95. Në fund, dashuria na bën të priremi drejt bashkimit universal. Askush nuk pjeket apo nuk e arrin plotësinë e vet duke u izoluar.

Nga vetë dinamikën e saj, dashuria kërkon një hapje progresive, një aftësi më të madhe për t'i mikpritur të tjerët, në një aventurë që nuk përfundon kurrë, që i bashkon të gjitha periferitë drejt një ndjenje të plotë përkatësie të ndërsjellë. Jezusi na ka thënë: "Ju të gjithë jeni vëllezër" (Mt 23,8).

96. Kjo nevojë për të shkuar përtej kufijve vetjakë vlen edhe për rajonet dhe vendet e ndryshme. Në fakt, "numri gjithnjë në rritje i ndërlidhjeve dhe i komunikimeve që mbështjellin planetin tonë e bën më të prekshme vetëdijen e njësisë dhe të bashkëndarjes së një fati të përbashkët midis kombeve të tokës. Në dinamizmat e historisë, me gjithë larminë e grupeve etnike, të shoqërive dhe të kulturave, shohim të mbjellur thirrjen për të formuar një bashkësi të përbërë nga vëllezër që mirëpriten në mënyrë të ndërsjellë, duke u kujdesur për njëri-tjetrin".[75]

Shoqëri të hapura që i integrojnë të gjithë

97. Ka periferi që janë afër nesh, në qendër të një qyteti apo në familjen tonë.

Ekziston edhe një aspekt i hapjes universale të dashurisë që nuk është gjeografik, por ekzistencial. Është aftësia e përditshme për ta zgjeruar rrethin tim, për të arritur ata që spontanisht nuk i ndiej pjesë të botës sime të interesave, megjithëse janë afër meje. Nga ana tjetër, çdo vëlla ose motër që vuan, që është i braktisur ose që shpërfillet nga shoqëria ime është një i huaj ekzistencial, edhe pse ka lindur në të njëjtin vend. Mund të jetë një qytetar me të gjitha gjërat në rregull, por e bëjnë të ndihet si i huaj në tokën e tij. Racizmi është një virus që ndryshon lehtë dhe në vend që të zhduket fshihet, por është gjithnjë në pritë.

98. Dua të kujtoj "mërgimtarët e fshehtë", që trajtohen si trupa të huaj të shoqërisë. [76] Shumë persona me aftësi të kufizuara "ndiejnë se ekzistojnë pa i përkitur dhe pa marrë pjesë" në të. Ka akoma shumë gjëra "që [i pengojnë] ata që të kenë një shtetësi të plotë". Objektivi nuk është vetëm që t'i ndihmojmë ata, por "pjesëmarrja e tyre aktive në bashkësinë civile dhe kishtare. Është një ecje kërkuese dhe e lodhshme, e cila do të kontribuojë gjithnjë e më shumë në formimin e ndërgjegjeve të afta për ta

njohur secilin si një person të vetëm dhe të papërsëritshëm". Po ashtu mendoj edhe për të moshuarit "të cilët, edhe për shkak të aftësive të tyre të kufizuara, ndonjëherë përjetohen si barrë". Sidoqoftë, të gjithë mund të japin "një kontribut të veçantë për të mirën e përbashkët përmes biografisë së tyre origjinale". Përsëris: duhet "të kemi guximin që t'u japim një zë atyre që janë të diskriminuar për shkak të aftësisë së tyre të kufizuar, pasi fatkeqësisht në disa vende, ende sot, është e vështirë që të njihen si persona me dinjitet të barabartë".[77]

Kuptime të papërshtatshme të një dashurie universale

99. Dashuria që shtrihet përtej kufijve ka si bazë atë që ne e quajmë "miqësi shoqërore" në çdo qytet dhe në çdo vend. Kur është e pastër, kjo miqësi shoqërore brenda një shoqërie është kusht për mundësinë e një hapjeje të vërtetë universale. Nuk bëhet fjalë për universalizmin e rremë të atyre që kanë nevojë të udhëtojnë vazhdimisht, sepse nuk e durojnë dhe nuk e duan popullin e tyre. Kushdo që i shikon njerëzit e vet me përbuzje, vendos në shoqërinë e tij kategori

të klasit të parë dhe të dytë, persona me më pak apo me më shumë dinjitet dhe të drejta. Duke vepruar kështu, mohon se ka vend për të gjithë.

100. As nuk po propozoj një universalizëm autoritar dhe abstrakt, të diktuar apo të planifikuar nga disa persona dhe të paraqitur si një ideal të supozuar me qëllime homogjenizimi, dominimi dhe plaçkitjeje. Ekziston një model globalizimi që "synon me vetëdije një uniformitet njëdimensional dhe përpiqet t'i zhdukë të gjitha ndryshimet dhe traditat në një kërkim sipërfaqësor njësie.[…] Nëse një globalizim pretendon se i bën të gjithë të barabartë, si të ishte një sferë, ky globalizim shkatërron veçantinë e secilit person dhe të çdo populli". [78] Kjo ëndërr e rreme universalistike e privon botën nga larmia e ngjyrave të saj, nga bukuria e saj dhe në fund nga humaniteti i saj. Sepse "e ardhmja nuk është 'monokromatike', por, nëse kemi guxim, është e mundur që ta shohim atë në larminë dhe shumëllojshmërinë e kontributeve që secili mund të japë. Sa shumë ka nevojë familja jonë njerëzore për të mësuar të jetojë së bashku në harmoni dhe paqe, pa pasur

nevojë që të jemi të gjithë njësoj!”.[79]

Të shkosh përtej një bote ortakësh

101. Le të kthehemi te shëmbëlltyra e samaritanit të mirë, e cila ka akoma shumë për të na ofruar. Në rrugë ishte një i plagosur. Personazhet që kaluan pranë tij nuk u përqëndruan në thirrjen e brendshme për të qenë afër tij, por në funksionin e tyre, në pozicionin shoqëror që ata kishin, në një profesion prestigjioz në shoqëri. Ndiheshin të rëndësishëm për shoqërinë e asaj kohe dhe ajo që kishte rëndësi për ta ishte roli që duhej të luanin. Njeriu i plagosur dhe i braktisur bazë rrugës ishte një shqetësim për këtë projekt, një ndërprerje dhe ai nuk kishte asnjë funksion për ta. Ishte një “askush”, nuk i përkiste një grupi të denjë për t’u marrë në konsideratë, nuk kishte asnjë rol në ndërtimin e historisë. Ndërkohë, samaritani bujar u rezistoi këtyre klasifikimeve të mbyllura, edhe pse ai vetë ishte jashtë të gjitha këtyre kategorive dhe ishte thjesht një i huaj, pa vendin e tij në shoqëri. Kështu, i lirë nga çdo titull dhe strukturë, qe në gjendje të ndërpriste udhëtimin e tij, t’i ndryshonte planet e veta, të ishte i gatshëm që t’i hapej

njeriut të plagosurit që kishte nevojë për të.

102. Çfarë reagimi mund të provokojë ky rrëfim sot, në një botë ku shfaqen dhe rriten vazhdimisht grupe shoqërore që kapen pas një identiteti që i ndan ata nga të tjerët? Si mund t'i mallëngjejë kjo shëmbëlltyrë ata që priren të organizohen në atë mënyrë që të parandalojnë çdo prani të huaj që mund ta shqetësojë këtë identitet dhe këtë organizatë vetëmbrojtëse dhe vetë-referuese? Në këtë skemë përjashtohet mundësia për t'u bërë i afërm dhe është e mundur që të jemi të afërt vetëm ndaj atyre që mundësojnë konsolidimin e avantazheve personale. Kështu fjala "i afërm" humbet çdo domethënie dhe merr kuptim vetëm fjala "ortak", ai me të cilin qëndrohet për interesa të caktuara.[80]

Liri, barazi dhe vëllazëri

103. Vëllazëria nuk është vetëm rezultat i kushteve të respektimit të lirive individuale, as i njëfarë barazie të rregulluar. Edhe pse këto janë kushte mundësie, nuk mjaftojnë që ajo të burojë prej tyre si rezultat i domosdoshëm. Vëllazëria ka diçka pozitive për t'i ofruar lirisë dhe barazisë. Çfarë ndodh

pa vëllazërinë e kultivuar me vetëdije, pa një vullnet politik vëllazërie, përkthyer në një edukim në vëllazëri, në dialog, në zbulimin e ndërsjellshmërisë dhe të pasurimit të ndërsjellë si vlera? Ndodh që liria të zvogëlohet, duke rezultuar kështu më tepër si një gjendje e vetmisë, e një autonomie të pastër për t'i përkitur dikujt ose diçkaje, ose vetëm për të zotëruar dhe për të shijuar. Kjo nuk e shteron në asnjë mënyrë pasurinë e lirisë, e cila është e orientuar kryesisht kah dashuria.

104. As barazia nuk arrihet duke përcaktuar në mënyrë abstrakte se "të gjitha qeniet njerëzore janë të barabarta", por është rezultat i kultivimit të vetëdijshëm dhe pedagogjik të vëllazërisë. Ata që janë të aftë për të qenë vetëm ortakë, krijojnë botë të mbyllura. Çfarë kuptimi mund të ketë në këtë skemë personi që nuk i përket rrethit të ortakëve dhe arrin duke ëndërruar një jetë më të mirë për veten dhe familjen e vet?

105. Individualizmi nuk na bën më të lirë, më të barabartë, më vëllezër. Shuma e interesave individuale nuk është në gjendje që të krijojë një botë më të mirë

për njerëzimin. As nuk mund të na ruajë nga kaq shumë të këqija që bëhen gjithnjë e më globale. Por individualizmi radikal është virusi më i vështirë për t'u mposhtur. Mashtron. Na bën të besojmë se gjithçka konsiston në lënien të lirë të ambicjeve tona, sikur duke grumbulluar ambicje dhe siguri individuale mund ta ndërtojmë të mirën e përbashkët.

Dashuri universale që promovon njerëzit

106. Ekziston një njohje themelore, thelbësore që duhet bërë për të ecur drejt miqësisë shoqërore dhe vëllazërisë universale: të kuptojë sa vlen një qenie njerëzore, sa vlen një person, gjithmonë dhe në çdo rrethanë. Nëse të gjithë vlejnë shumë, duhet thënë me qartësi dhe vendosmëri se "fakti që vetëm disa njerëz kanë lindur në vende me burime më të pakta apo më pak të zhvilluara nuk e shfajëson faktin që ata të jetojnë me më pak dinjitet".[81] Ky është një parim elementar i jetës shoqërore, që vazhdimisht dhe në mënyra të ndryshme shpërfillet nga ata që shohin se nuk i përshtatet vizionit të tyre për botën ose nuk

u shërben qëllimeve të tyre.

107. Çdo qenie njerëzore ka të drejtë që të jetojë me dinjitet dhe të zhvillohet tërësisht, dhe asnjë vend nuk mund ta mohojë këtë të drejtë themelore. Të gjithë e kanë atë, edhe nëse është pak e efektshme, edhe nëse ka lindur ose është rritur me kufizime; në fakt, kjo nuk e zvogëlon dinjitetin e tij të jashtëzakonshëm si person njerëzor, i cili nuk bazohet në rrethana, por në vlerën e qenies së tij. Kur ky parim elementar nuk mbrohet, nuk ka të ardhme as për vëllazërinë dhe as për mbijetesën e njerëzimit.

108. Ka shoqëri që pjesërisht e pranojnë këtë parim. E pranojnë se ka mundësi për të gjithë, por argumentojnë se, duke pasur parasysh këtë, gjithçka varet prej secilit. Sipas kësaj perspektive të pjesshme, nuk do të kishte kuptim të bësh përpjekje "për të ndihmuar të ngadaltët, të dobëtit apo më pak të talentuarit që të gjejnë mundësi në jetë". [82] Investimi në favor të njerëzve të brishtë mund të mos jetë fitimprurës, mund të çojë në më pak efektshmëri. Kërkon një shtet të pranishëm dhe aktiv, si dhe institucione të shoqërisë civile që shkojnë përtej lirisë së

mekanizmave të efektshëm të disa sistemeve ekonomike, politike ose ideologjike, me qëllim që me të vërtetë të orientohen para së gjithash tek njerëzit dhe e mira e përbashkët.

109. Disa lindin në familje me të ardhura të mira ekonomike, marrin një arsimim të mirë, rriten të ushqyer mirë, ose kanë natyrshëm aftësi të rëndësishme. Ata me siguri nuk do të kenë nevojë për një shtet aktiv dhe do të kërkojnë vetëm liri. Por padyshim që i njëjti rregull nuk zbatohet për një person me aftësi të kufizuara, për ata që kanë lindur në një shtëpi të varfër, për ata që janë rritur me një edukim pak cilësor dhe me pak mundësi për t'i mjekuar siç duhet sëmundjet e tyre. Nëse shoqëria bazohet kryesisht në kriteret e lirisë dhe të efektshmërisë së tregut, nuk ka vend për ta, dhe vëllazëria do të jetë në rastin më të mirë një shprehje romantike.

110. Fakti është se "thjesht shpallja e lirisë ekonomike, kur kushtet reale nuk lejojnë që shumë njerëz ta kenë atë realisht dhe kur kufizohet mundësia për punë, bëhet një fjalim kontradiktor".[83] Fjalët si liri, demokraci apo vëllazëri zbrazen nga kuptimi i tyre. Sepse, në realitet, "për sa

kohë që sistemi ynë socio-ekonomik do të prodhojë sërish një viktimë dhe do të ketë edhe vetëm një person të skartuar, nuk mund të ketë festë të vëllazërisë universale”.[84] Një shoqëri njerëzore dhe vëllazërore është në gjendje të punojë për të siguruar në një mënyrë të efektshme dhe të qëndrueshme që të gjithë të shoqërohen përgjatë rrugës së jetës së tyre, jo vetëm për të siguruar nevojat themelore, por në mënyrë që ata të japin më të mirën, edhe nëse performanca e tyre nuk do të jetë ndër më të mirat, edhe nëse do të ecin ngadalë, edhe nëse efektshmëria e tyre nuk do të jetë e rëndësishme.

111. Personi njerëzor, me të drejtat e tij të patjetërsueshme, është natyrshëm i hapur ndaj lidhjeve. Në vetë rrënjën e tij jeton thirrja për ta kapërcyer veten në takimin me të tjerët. Për këtë arsye, “është e nevojshme që t’i kushtohet vëmendje për të mos rënë në disa dykuptimësi që mund të vijnë nga një keqkuptim i konceptit të të drejtave të njeriut dhe nga abuzimi i tyre paradoksal. Në fakt, sot ka një prirje drejt një kërkimi gjithnjë e më të gjerë të të drejtave individuale - jam i tunduar që të them individualistike -, që

fsheh një konceptim të personit njerëzor të shkëputur nga çdo kontekst shoqëror dhe antropologjik, pothuajse si një "*monade*" (*monás*), gjithnjë e më shumë i pandjeshëm […] Nëse e drejta e secilit person nuk rregullohet në mënyrë harmonike me të mirën më të madhe, përfundon duke u konceptuar pa kufizime dhe për këtë arsye bëhet burim konfliktesh dhe dhune".[85]

Të nxitësh të mirën morale

112. Nuk mund të mos themi se dëshira dhe kërkimi i të mirës së të tjerëve dhe i krejt njerëzimit nënkupton gjithashtu punën për një pjekje të personave dhe të shoqërive në vlerat e ndryshme morale, që çojnë në zhvillimin tërësor njerëzor. Në Besëlidhjen e Re përmendet një fryt i Shpirtit Shenjt (krh. Gal 5,22) i përcaktuar me fjalën greke *agathosyne*. Kjo fjalë tregon lidhjen me të mirën, me kërkimin e të mirës. Edhe më shumë, do të thotë të sigurosh atë që vlen më shumë, më të mirën për të tjerët: pjekurinë e tyre, rritjen e tyre në një jetë të shëndetshme, ushtrimin e vlerave dhe jo vetëm mirëqenien materiale. Ekziston një shprehje e ngjashme latine: *bene-volentia*,

domethënë qëndrimi për t'ia dashur të mirën tjetrit. Është një dëshirë e fortë për të mirën, një prirje drejt gjithçkaje që është e mirë dhe e shkëlqyeshme, e cila na shtyn ta mbushim jetën e të tjerëve me gjëra të bukura, sublime, ndërtuese.

113. Në këtë linjë, me dhimbje theksoj se "tashmë tepër gjatë kemi qenë në degradim moral, duke vënë në lojë etikën, mirësinë, fenë, ndershmërinë dhe ka ardhur momenti ta pranojmë se kjo sipërfaqësi e hareshme nuk na ka hyrë në punë. Ky shkatërrim i çdo themeli të jetës shoqërore arrin të na vërë njërin kundër tjetrit për të mbrojtur interesat tona, shkakton lindjen e formave të reja të dhunës e të mizorisë dhe pengon zhvillimin e një kulture të re të kujdesit për mjedisin".[86] Le të kthehemi për të nxitur të mirën, për veten tonë dhe për mbarë njerëzimin, kështu do të ecim së bashku drejt një rritjeje të mirëfilltë dhe tërësore. Çdo shoqëri ka nevojë që të sigurojë përçimin e vlerave, pasi nëse kjo nuk ndodh, përçohet egoizmi, dhuna, korrupsioni në format e tij të larmishme, indiferenca dhe, në fund, një jetë e mbyllur ndaj çdo transhendence dhe fsheshur pas interesave individuale.

Vlera e solidaritetit

114. Dëshiroj të vë në dukje solidaritetin, i cili "si virtyt moral dhe qëndrim social, fryt i kthimit personal, kërkon një angazhim prej anës së shumë subjekteve, që kanë përgjegjësi të karakterit edukativ dhe formativ. Mendimi im i parë shkon te familjet, të thirrura për një mision parësor edukativ prej të cilit nuk mund të heqin dorë. Ato përbëjnë vendin e parë ku jetohen dhe përçohen vlerat e dashurisë dhe të vëllazërisë, të bashkëjetesës dhe të bashkëndarjes, të vëmendjes dhe të përkujdesjes ndaj tjetrit. Ato janë edhe vende të privilegjuara për përçimin e fesë, duke filluar prej atyre gjesteve të para dhe të thjeshta të devocionit që nënat u mësojnë fëmijëve të tyre. Për sa u përket edukatorëve dhe formatorëve që, në shkollë apo qendra të ndryshme ku mblidhen fëmijët dhe të rinjtë, kanë detyrën angazhuese për t'i edukuar fëmijët dhe të rinjtë, janë të thirrur që të jenë të vetëdijshëm që përgjegjësia e tyre ka të bëjë me përmasat morale, shpirtërore dhe shoqërore të personit. Vlerat e lirisë, të respektit të ndërsjellë dhe të solidaritetit mund të përçohen qysh në moshë të njomë. [...] Edhe operatorët kulturorë dhe të mjeteve të

komunikimit shoqëror kanë përgjegjësi në fushën e edukimit dhe të formimit, sidomos në shoqëritë bashkëkohore, ku mundësia për t'i përdorur mjetet e informimit dhe të komunikimit është gjithnjë e më e përhapur".[87]

115. Në këto momente, në të cilat gjithçka duket se po tretet dhe po humbet konsistencë, na bën mirë t'i drejtohemi qëndrueshmërisë[88] që rrjedh nga fakti se e dimë se jemi përgjegjës për brishtësinë e të tjerëve, duke kërkuar një fat të përbashkët. Solidariteti shprehet konkretisht në shërbim, që mund të marrë forma shumë të ndryshme në mënyrën e marrjes përsipër të të tjerëve. Shërbimi është "kryesisht, të kujdesesh për brishtësinë. Të shërbesh do të thotë të kujdesesh për ata që janë të brishtë në familjet tona, në shoqërinë tonë, në popullin tonë". Në këtë angazhim, secili është i aftë që "të lënë mënjanë nevojat, pritshmëritë dhe dëshirat e veta të gjithëpushtetshmërisë përpara vështrimit konkret të më të brishtëve. […] Shërbimi shikon gjithmonë fytyrën e vëllait, prek mishin e tij, ndjen afërsinë e tij dhe, në disa raste, derisa "vuan" edhe ai vetë për këtë gjë, dhe kërkon ngritjen e vëllait.

Për këtë arsye, shërbimi nuk është kurrë ideologjik, meqë nuk u shërben ideve, por personave”.[89]

116. Të fundmit në përgjithësi “praktikojnë atë solidaritet shumë të veçantë që ekziston midis atyre që vuajnë, mes të varfërve, dhe që qytetërimi ynë duket se e ka harruar, ose të paktën që ka një dëshirë të madhe për ta harruar. Solidariteti është një fjalë që nuk pëlqehet gjithmonë; do të thosha se disa herë e kemi shndërruar atë në një fjalë të keqe, nuk mund të thuhet; por është një fjalë që shpreh shumë më tepër sesa disa veprime sporadike bujarie. Do të thotë të mendosh dhe të veprosh në terma bashkësie, përparësie të jetës së të gjithëve mbi përvetësimin e të mirave nga ana e disave. Do të thotë edhe të luftosh kundër shkaqeve strukturore të varfërisë, të pabarazisë, të mungesës së punës, të tokës dhe të shtëpisë, të mohimit të të drejtave sociale dhe të punës. Do të thotë t’u bësh ballë efekteve shkatërruese të Perandorisë së parasë [...]. Solidariteti, i kuptuar në domethënien e tij më të thellë, është një mënyrë për të bërë histori dhe është pikërisht kjo ajo që bëjnë lëvizjet popullore”.[90]

117. Kur flasim për kujdesin që duhet të kemi për shtëpinë e përbashkët që është planeti, i drejtohemi atij minimumi të vetëdijes universale dhe shqetësimit për kujdesin e ndërsjellë që mund të mbetet ende te njerëzit. Në fakt, nëse dikujt i tepron uji dhe e ruan atë duke menduar për njerëzimin, kjo ndodh sepse ka arritur një nivel moral që e lejon atë të shkojë përtej vetvetes dhe grupit të vet të përkatësisë. Kjo është një gjë mrekullisht njerëzore! Po ky qëndrim kërkohet për njohjen e të drejtave të çdo qenieje njerëzore, edhe nëse ka lindur përtej kufijve tanë.

Të ri-propozosh funksionin shoqëror të pronësisë

118. Bota ekziston për të gjithë, sepse të gjithë ne qeniet njerëzore kemi lindur në këtë tokë me të njëjtin dinjitet. Dallimet në ngjyrë, besim fetar, aftësi, vendlindje, vendbanim dhe shumë të tjera nuk mund të vihen përpara apo të përdoren për të justifikuar privilegjet e disave në dëm të të drejtave të të gjithëve. Për pasojë, si bashkësi duhet të sigurojmë që çdo person të jetojë me dinjitet dhe të ketë mundësi të përshtatshme

për zhvillimin e vet tërësor.

119. Në shekujt e parë të fesë së krishterë, persona të ditur zhvilluan një sens universal në reflektimet e tyre mbi adresimin e përbashkët të të mirave të krijuara.[91] Kjo i shtynte njerëzit që të mendonin se nëse dikush nuk ka atë që duhet për të jetuar me dinjitet, kjo është për shkak se një tjetër po e përvetëson atë. Shën Gjon Gojarti e përmbledh atë duke thënë se "të mos u japësh të varfërve pjesën e të mirave vetjake do të thotë të vjedhësh të varfrit, do të thotë t'i privosh nga vetë jeta e tyre; ajo që ne zotërojmë nuk është e jona, por e tyrja".[92] Si dhe këto fjalë të Shën Gregorit të Madh: "Kur u shpërndajmë ndonjë gjë të varfërve, nuk u japim sendet tona, por u kthejmë atyre atë që u takon atyre".[93]

120. Edhe një herë i bëj të miat dhe ua propozoj të gjithëve disa fjalë të Shën Gjon Palit II, forca e të cilit mbase nuk është kuptuar: "Zoti ia dha tokën krejt gjinisë njerëzore, në mënyrë që ajo t'i mbajë të gjithë anëtarët e saj, pa përjashtuar ose privilegjuar askënd".[94] Në këtë linjë kujtoj se "tradita e krishterë nuk e ka njohur kurrë si absolute

apo të paprekshme të drejtën e pronës private, dhe ka vënë në pah funksionin shoqëror të çfarëdo forme të pronësisë private”. [95] Parimi i përdorimit të përbashkët të të mirave të krijuara për të gjithë është “parimi i parë i të gjithë rendit etiko-shoqëror”, [96] është një e drejtë natyrore, zanafillore dhe përparësore.[97] Të gjitha të drejtat e tjera mbi të mirat e nevojshme për realizimin tërësor të personave, përfshirë atë të pronës private dhe çfarëdo tjetër, “nuk duhet ta pengojnë, por, përkundrazi, ta lehtësojnë realizimin e saj”, siç pohonte Shën Pali VI.[98] E drejta e pronës private mund të konsiderohet vetëm si një e drejtë natyrore dytësore dhe që rrjedh nga parimi i adresimit universal të të mirave të krijuara dhe kjo ka pasoja shumë konkrete, që duhet të pasqyrohen në funksionimin e shoqërisë. Por, shpesh ndodh që të drejtat dytësore të vendosen mbi ato përparësore dhe zanafillore, duke i privuar ato nga rëndësia e tyre praktike.

Të drejta pa kufij

121. Prandaj askush nuk mund të mbetet i përjashtuar, pavarësisht se ku ka lindur, aq më pak për shkak të privilegjeve që të tjerët

kanë për faktin se kanë lindur në vende me mundësi më të mëdha. Kufijtë e shteteve nuk mund të pengojnë që kjo të ndodhë. Ashtu siç është e papranueshme që një person të ketë më pak të drejta për shkak se është grua, është po aq e papranueshme që vendi i lindjes ose i vendbanimit të përcaktojë më pak mundësi për një jetë dhe zhvillim dinjitoz.

122. Zhvillimi nuk duhet të orientohet drejt grumbullimit në rritje të disave, por duhet të sigurojë "të drejtat njerëzore, personale dhe shoqërore, ekonomike dhe politike, përfshirë edhe të drejtat e kombeve dhe të popujve".[99] E drejta e disave për lirinë e sipërmarrjes ose të tregut nuk mund të qëndrojë mbi të drejtat e popujve dhe të dinjitetit të të varfërve; madje as mbi respektin për mjedisin, pasi "kush zotëron një pjesë të tij e ka vetëm për ta administruar në dobi të të gjithëve".[100]

123. Aktiviteti i sipërmarrësve efektivisht "është një thirrje fisnike e orientuar për të prodhuar pasuri dhe për ta përmirësuar botën për të gjithë".[101] Zoti na promovon, pret që t'i zhvillojmë aftësitë që na ka dhënë neve, si

dhe e ka mbushur universin me potencialitet. Në planet e tij çdo person është i thirrur që të promovojë zhvillimin e vet[102] dhe kjo përfshin zbatimin e aftësive ekonomike dhe teknologjike për t'i rritur të mirat dhe për ta shtuar pasurinë. Megjithatë, në çdo rast, këto aftësi të sipërmarrësve, të cilat janë një dhuratë nga Zoti, duhet të orientohen kah përparimi i njerëzve të tjerë dhe kapërcimi i mjerimit, veçanërisht përmes krijimit të mundësive të larmishme të punësimit. Gjithmonë, bashkë me të drejtën e pronës private, ekziston e drejta prioritare dhe paraprake e nënrenditjes së çdo prone private ndaj adresimit universal të të mirave të tokës dhe, për këtë arsye, e drejta e të gjithëve për përdorimin e tyre.[103]

Të drejtat e popujve

124. Siguria e adresimit të përbashkët të të mirave të tokës kërkon sot që ai të zbatohet gjithashtu për vendet, territoret e tyre dhe burimet e tyre. Nëse e shikojmë jo vetëm nga legjitimiteti i pronës private dhe i të drejtave të qytetarëve të një kombi të caktuar, por edhe duke u nisur nga parimi i parë i adresimit të përbashkët të të mirave,

atëherë mund të themi se çdo vend i përket edhe të huajit, ashtu si të mirat e një territori nuk duhet t'i mohohet një personi në nevojë që vjen nga një vend tjetër. Në fakt, siç kanë mësuar Ipeshkvijtë e Shteteve të Bashkuara, ka të drejta themelore të cilat "i paraprijnë çdo shoqërie, sepse ato rrjedhin nga dinjiteti dhënë çdo personi meqë është krijuar nga Zoti".[104]

125. Kjo gjithashtu presupozon një mënyrë tjetër për t'i kuptuar marrëdhëniet dhe ndërshkëmbimet midis vendeve. Nëse çdo person ka një dinjitet të patjetërsueshëm, nëse çdo qenie njerëzore është vëllai apo motra ime dhe nëse bota me të vërtetë u përket të gjithëve, nuk ka rëndësi nëse dikush ka lindur këtu apo nëse jeton jashtë kufijve të vendit të vet. Edhe Kombi im është bashkëpërgjegjës për zhvillimin e tij, edhe pse këtë përgjegjësi e përmbush në mënyra të ndryshme: duke e mirëpritur atë me bujari kur ai ka një nevojë të domosdoshme, duke e promovuar atë në tokën e tij, duke mos përdorur apo duke mos varfëruar me burime natyrore vende të tëra duke favorizuar kështu sisteme të korruptuara, që parandalojnë zhvillimin e denjë të popujve. Kjo, që vlen

për kombet, vlen edhe për rajonet e ndryshme të çdo vendi, midis të cilave shpesh ndodhin pabarazi të rënda. Por paaftësia për ta njohur dinjitetin e barabartë njerëzor ndonjëherë bën që rajonet më të zhvilluara të disa vendeve të aspirojnë të lirohen nga "pesha" e rajoneve më të varfra për të rritur më tej nivelin e tyre të konsumit.

126. Po flasim për një rrjet të ri në marrëdhëniet ndërkombëtare, sepse nuk ka asnjë mënyrë për t'i zgjidhur problemet e rënda të botës duke arsyetuar vetëm në lidhje me ndihmën e ndërsjellë midis individëve ose grupeve të vogla. Kujtojmë se "padrejtësia nuk godet vetëm individët, por edhe Vende të tëra dhe na detyron të mendojmë për një etikë të marrëdhënieve ndërkombëtare".[105] Drejtësia kërkon njohjen dhe respektimin jo vetëm të të drejtave individuale, por edhe të të drejtave sociale dhe të të drejtave të popujve.[106] Ajo që po themi nënkupton që të sigurohet "e drejta themelore e popujve për të jetuar dhe për të përparuar",[107] e cila ndonjëherë pengohet rëndë nga presioni që vjen nga borxhi i jashtëm. Pagesa e borxhit në shumë raste jo vetëm që nuk favorizon zhvillimin, por e kufizon dhe e kushtëzon

fort atë. Që të ruhet parimi që çdo borxh i kontraktuar në mënyrë të ligjshme duhet të paguhet, mënyra për ta përmbushur këtë detyrim, që shumë vende të varfra kanë ndaj vendeve të pasura, nuk duhet të çojë në kompromentimin e ekzistencës dhe të rritjes së tyre.

127. Padyshim, bëhet fjalë për një logjikë tjetër. Nëse nuk përpiqemi që të futemi në këtë logjikë, fjalët e mia do të tingëllojnë si fantazi. Por nëse e pranojmë parimin e madh të të drejtave që lindin nga fakti i thjeshtë i zotërimit të dinjitetit të patjetërsueshëm njerëzor, është e mundur që ta pranojmë sfidën për të ëndërruar dhe për të menduar për një tjetër njerëzim. Është e mundur që të dëshirojmë një planet që u siguron tokë, shtëpi dhe punë të gjithëve. Kjo është rruga e vërtetë drejt paqes, dhe jo strategjia e pamend dhe dritëshkurtër e mbjelljes së frikës dhe e mosbesimit ndaj kërcënimeve të jashtme. Kjo pasi paqja e vërtetë dhe e qëndrueshme është e mundur vetëm "duke filluar nga një etikë globale solidariteti dhe bashkëpunimi në shërbim të një të ardhmeje të formuar nga ndërvarësia dhe bashkëpërgjegjësia e krejt familjes njerëzore".[108]

KAPITULLI I KATËRT

NJË ZEMËR E HAPUR NDAJ BOTËS MBARË

128. Pohimi se si qenie njerëzore jemi të gjithë vëllezër dhe motra, nëse nuk është vetëm një abstragim, por mishërohet dhe bëhet konkret, na paraqet një sërë sfidash që na lëvizin prej vendit, që na detyrojnë të marrim perspektiva të reja dhe që të japim përgjigje të reja.

Kufizimi i kufijve

129. Kur i afërmi është një person migrues, shtohen sfida komplekse.[109] Sigurisht, ideale do të ishte shmangia e migrimit të panevojshëm dhe për këtë qëllim rruga është që të krijohet në vendet e origjinës mundësia konkrete për të jetuar dhe për t'u rritur me dinjitet, në mënyrë që atje të gjenden kushtet për zhvillimin tërësor

vetjak. Por, për sa kohë që nuk ka përparim serioz në këtë drejtim, është detyra jonë që të respektojmë të drejtën e çdo qenieje njerëzore për të gjetur një vend ku ai jo vetëm të plotësojë nevojat e tij parësore dhe ato të familjes së tij, por edhe që të realizohet plotësisht si person. Përpjekjet tona ndaj migrantëve që vijnë mund të përmblidhen në katër folje: mikpres, mbroj, promovoj dhe integroj. Në fakt, "nuk bëhet fjalë për të krijuar nga lart programe të asistencës, por për të bërë një udhëtim së bashku përmes këtyre katër veprimeve, që të ndërtojmë qytete dhe vende të cilat, duke ruajtur identitetin e tyre përkatës kulturor dhe fetar, të jenë të hapura ndaj dallimeve dhe të dinë t'i vlerësojnë ato në shenjën e vëllazërisë njerëzore".[110]

130. Kjo nënkupton disa përgjigje të domosdoshme, veçanërisht ndaj atyre që ikin nga kriza të rënda humanitare. Për shembull: shtimi dhe thjeshtimi i dhënies së vizave; miratimi i programeve përkrahëse private dhe bashkësiore; hapja e korridoreve humanitare për refugjatët më të rrezikuar; ofrimi i një strehimi të përshtatshëm dhe të denjë; garantimi i sigurisë personale

dhe i aksesit në shërbimet bazë; sigurimi i një asistence të përshtatshme konsullore, i të drejtës për të pasur gjithnjë me vete dokumentet e identitetit, një akses të paanshëm drejtësie, mundësia për të hapur llogari bankare dhe garancia e asaj që është e nevojshme për të jetuar; dhënia atyre e lirisë së lëvizjes dhe e mundësisë për të punuar; mbrojtja e të miturve dhe sigurimi që të kenë akses të rregullt në edukim; parashikimi i programeve të kujdestarisë së përkohshme ose të mikpritjes; garantimi i lirisë fetare; promovimi i përfshirjes së tyre shoqërore; favorizimi i bashkimit familjar dhe përgatitja e bashkësive lokale për proceset e integrimit.[111]

131. Për ata që kanë ardhur prej disa kohësh dhe janë përfshirë në strukturën shoqërore, është e rëndësishme që të zbatohet koncepti i "shtetësisë", i cili "bazohet në barazinë e të drejtave dhe të detyrave nën hijen e të cilave të gjithë gëzojnë drejtësi. Për këtë arsye, është e nevojshme që të angazhohemi për të vendosur në shoqëritë tona konceptin e *qytetarisë së plotë* dhe të heqim dorë nga përdorimi diskriminues i termit *pakica*, i cili mbart me vete farat e të

ndjerit të izoluar dhe ato të inferioritetit; ai përgatit terrenin për armiqësi dhe përçarje, si dhe heq arritjet dhe të drejtat fetare e civile të disa qytetarëve duke i diskriminuar ata”.[112]

132. Përtej veprimeve të ndryshme të domosdoshme, Shtetet nuk mund të zhvillojnë për hesap të tyre zgjidhje të përshtatshme “pasi pasojat e zgjedhjeve të secilit bien në mënyrë të pashmangshme mbi të gjithë Bashkësinë ndërkombëtare”. Prandaj “përgjigjet mund të jenë fryt vetëm i një pune të përbashkët”,[113] duke krijuar një legjislacion global (*governance*) për migracionin. Në çdo rast, është e nevojshme që “të krijohen projekte afatmesme dhe afatgjata që shkojnë përtej përgjigjes emergjente. Nga njëra anë, ata duhet të ndihmojnë në mënyrë të efektshme integrimin e migrantëve në vendet pritëse dhe, në të njëjtën kohë, të favorizojnë zhvillimin e vendeve të origjinës me politika solidariteti, pa i dhënë ndihmat me kusht përhapjen e strategjive dhe të praktikave ideologjikisht të huaja apo në kundërshtim me kulturat e popujve të cilave u jepen”.[114]

133. Ardhja e njerëzve të ndryshëm, të cilët vijnë nga një kontekst tjetër jetësor dhe kulturor, shndërrohet në një dhuratë, sepse "ato të migrantëve janë edhe histori takimi mes personave e kulturave: për bashkësitë dhe shoqëritë ku arrijnë janë një mundësi pasurimi e zhvillimi të tërësishëm njerëzor për të gjithë".[115] Prandaj, "u kërkoj veçanërisht të rinjve që të mos bien në rrjetat e atyre që duan t'i vënë kundër të rinjve të tjerë, që arrijnë në vendet e tyre, duke i përshkruar ata si subjekte të rrezikshme dhe si të mos kishin të njëjtin dinjitet të pacenueshëm sikurse çdo qenie tjetër njerëzore".[116]

134. Nga ana tjetër, kur e mirëpret përzemërsisht personin e ndryshëm, e lejon atë që të vazhdojnë të jenë vetvetja, ndërsa i jep mundësinë për një zhvillim të ri. Kulturat e ndryshme, të cilat kanë prodhuar pasurinë e tyre gjatë shekujve, duhet të ruhen në mënyrë që bota të mos varfërohet. Dhe kjo pa lënë pas dore stimulimin e tyre, me qëllim që diçka e re të dalë prej tyre kur ato takohen me realitete të tjera. Nuk duhet të injorohet rreziku i rënies viktimë të një

skleroze kulturore. Prandaj "kemi nevojë të komunikojmë, të zbulojmë pasuritë e secilit, të vlerësojmë atë që na bashkon dhe t'i shikojmë ndryshimet si një mundësi rritjeje në respektimin e të gjithëve. Është i domosdoshëm një dialog i durueshëm dhe i besueshëm, në mënyrë që personat, familjet dhe bashkësitë të përçojnë vlerat e kulturës së tyre dhe të mirëpresin të mirën që vjen nga përvojat e të tjerëve".[117]

135. Po rimarr disa shembuj që kam përmendur kohë më parë: kultura e latinëve është "një tharm vlerash dhe mundësish që mund t'i bëjë fort mirë Shteteve të Bashkuara […]. Një imigrim i fortë në fund gjithmonë shënon dhe shndërron kulturën e një vendi.[…] Në Argjentinë, emigracioni i fortë italian ka shënuar kulturën e shoqërisë dhe në stilin kulturor të Buenos Aires-it vihet re shumë prania e rreth dyqind mijë hebrenjve. Emigrantët, nëse ndihmohen që të integrohen, janë një bekim, një pasuri dhe një dhuratë e re që e fton një shoqëri të rritet".[118]

136. Duke zgjeruar vështrimin, me Imamin e Madh Ahmed Al-Tayyeb-in kemi

kujtuar se “marrëdhënia midis Perëndimit dhe Lindjes është një domosdoshmëri e padiskutueshme e ndërsjellë, e cila nuk mund të zëvendësohet apo edhe të neglizhohet, në mënyrë që të dy ta pasurojnë njëri-tjetrin me qytetërimet e tyre, përmes shkëmbimit dhe dialogut të kulturave. Perëndimi, në qytetërimin e Lindjes, mund të gjente ilaçin për shërimin e disa sëmundjeve të veta shpirtërore dhe fetare, shkaktuar nga mbizotërimi i materializmit. Dhe Lindja, në qytetërimin e Perëndimit, mund të gjente shumë elemente që mund ta ndihmonin të shpëtonte nga dobësia, ndarja, konflikti dhe rënia shkencore, teknike e kulturore. Është e rëndësishme që t’i kushtohet vëmendje ndryshimeve fetare, kulturore dhe historike të cilat janë një përbërës thelbësor në formimin e personalitetit, të kulturës dhe të qytetërimit lindor; dhe është e rëndësishme që të konsolidohen të drejtat e përgjithshme dhe të përbashkëta të njeriut, për të ndihmuar sigurimin e një jete dinjitoze për të gjithë njerëzit në Lindje dhe në Perëndim, duke shmangur përdorimin e politikës së standardeve të dyfishta”.[119]

Ndërshkëmbimi i frytshëm

137. Ndihma e ndërsjellë ndërmjet vendeve në fund të fundit është për të mirën e të gjithëve. Një vend që përparon në bazë të substratit të tij origjinal kulturor është një thesar për gjithë njerëzimin. Kemi nevojë për të rritur vetëdijen se sot ose shpëtojmë të gjithë ose askush nuk shpëton. Varfëria, degradimi, vuajtjet në një zonë të tokës janë një terren i heshtur i shumimit të problemeve që në fund të fundit do të prekin krejt planetin. Nëse na shqetëson zhdukja e disa specieve, duhet të na mundojë ideja se kudo ka persona dhe popuj që nuk e zhvillojnë potencialin dhe bukurinë e tyre për shkak të varfërisë apo kufizimeve të tjera strukturore. Dhe kjo gjë na varfëron të gjithëve.

138. Nëse kjo ka qenë gjithmonë e sigurt, sot është më shumë se kurrë për shkak të realitetit të një bote kaq të ndërlidhur nga globalizimi. Kemi nevojë që një rend botëror juridik, politik dhe ekonomik që "do ta shtonte dhe do ta orientonte bashkëpunimin ndërkombëtar drejt zhvillimit solidar të të gjithë popujve".[120] Kjo në fund do të jetë në dobi të krejt planetit, sepse "ndihma për

zhvillimin e vendeve të varfra" nënkupton "krijimin e pasurisë për të gjithë".[121] Nga këndvështrimi i zhvillimit tërësor, kjo supozon që t'u jepet "edhe Kombeve më të varfra një zë efikas në vendimet e përbashkëta" [122] dhe që të bëhen përpjekje për të mbështetur "format e bashkëveprimit, të afta për të nxitur hyrjen në tregun ndërkombëtar, të Vendeve të shënuara nga varfëria dhe nënzhvillimi".[123]

Falasshmëri që mikpret

139. Sidoqoftë, nuk do të doja ta zvogëloja këtë qasje në ndonjë formë utilitarizmi. Ekziston falasshmëria. Është aftësia për të bërë disa gjëra thjesht për faktin sepse ato janë të mira në vetvete, pa shpresuar që të marrim ndonjë rezultat, pa pritur menjëherë diçka në këmbim. Kjo bën të mundur që ta mirëpresim të huajin, edhe nëse për momentin nuk na sjell një përfitim të prekshëm. E megjithatë ka vende që pretendojnë të mirëpresin vetëm shkencëtarët dhe investitorët.

140. Kush nuk e jeton falasshmërinë vëllazërore e bën ekzistencën e vet një tregti

të thekshme, gjithmonë duke matur atë që jep dhe atë që merr në këmbim. Përkundrazi, Hyji jep falas, deri në pikën sa ndihmon edhe ata që nuk janë besimtarë dhe "bën të lindë dielli i tij mbi të këqij e mbi të mirë" (Mt 5,45). Kjo është arsyeja pse Jezusi porosit: "Ndërsa ti, kur të bësh lëmoshë, të mos dijë e majta çfarë bën e djathta, që lëmosha jote të jetë e fshehtë" (Mt 6,3-4). Ne e morëm jetën falas, nuk paguam gjë për të. Prandaj, të gjithë mund të japim pa pritur diçka, të bëjmë mirë pa pritur të njëjtën gjë nga personi që ndihmojmë. Është kjo ajo që Jezusi u thoshte nxënësve të vet: "Falas morët, falas edhe jepni" (Mt 10,8).

141. Cilësia e vërtetë e vendeve të ndryshme të botës matet nga kjo aftësi për të menduar jo vetëm si një vend, por edhe si një familje njerëzore, dhe kjo tregohet veçanërisht në periudha kritike. Nacionalizmat e mbyllur në fund të fundit e shfaqin këtë paaftësi falasshmërie, bindjen e gabuar se ata mund të zhvillohen falë shkatërrimit të të tjerëve dhe se duke u mbyllur para të tjerëve ata do të mbrohen më shumë. Emigranti shihet si një uzurpues që nuk ofron asgjë. Kështu, dikush në mënyrë

naive fillon të mendojë se të varfrit janë të rrezikshëm ose të padobishëm dhe se të fuqishmit janë dashamirës bujarë. Vetëm një kulturë shoqërore dhe politike që përfshin mikpritjen falas mund të ketë një të ardhme.

Vendore dhe e gjithëmbarshme

142. Duhet të kujtohet se "edhe midis globalizimit dhe lokalizimit ekziston një tension. Duhet t'i kushtojmë vëmendje përmasës globale për të mos rënë në kurthin e meskinitetit dhe të banalitetit të përditshëm. Por duhet të shikojmë edhe përmasën lokale, në mënyrë që të ecim me këmbë në tokë. Së bashku, të dyja na ndihmojnë që të mos biem pre e njërit prej këtyre dy ekstremeve. Në njërin ekstrem, qytetarët bien pre e një universi abstrakt e të globalizuar, [...] kurse në ekstremin tjetër, ata kthehen në një muze folkloristik, eremitësh lokalë, të dënuar me përsëritjen e të njëjtave gjëra, pa qenë në gjendje që të sfidohen nga risia apo të vlerësojnë bukurinë që Zoti vendos përtej kufijve të tyre".[124] Duhet të shikojmë globalen, e cila na shpëton nga meskiniteti shtëpiak. Kur shtëpia nuk është më familje, por është gardh, qeli, globalja na shpëton,

sepse është si shkaku përfundimtar që na tërheq drejt plotësisë. Në të njëjtën kohë, është e nevojshme që ta pranojmë përzemërsisht përmasën lokale, sepse zotëron diçka që globalja nuk e ka: të qenit tharm, të pasurojë, t'u japë fill mekanizmave të subsidiaritetit. Prandaj, vëllazëria universale dhe miqësia shoqërore brenda çdo shoqërie janë dy pole të pandashme dhe bashkëekzistuese. Ndarja e tyre çon në shtrembërim dhe në një polarizim të dëmshëm.

Shija vendore

143. Zgjidhja nuk është një hapje që heq dorë nga thesari i saj. Siç nuk ka dialog me tjetrin pa një identitet personal, ashtu nuk ka hapje midis popujve përveçse duke u nisur nga dashuria për tokën, për njerëzit, për tiparet e tyre kulturore. Nuk takohem me tjetrin nëse nuk kam një substrat ku ndihem i fortë dhe i rrënjosur, sepse mbi atë bazë mund ta mirëpres dhuratën e tjetrit dhe t'i ofroj diçka autentike. Është e mundur që ta mikpres atë që është ndryshe dhe ta njoh kontributin e tij origjinal vetëm nëse jam fort i lidhur me popullin tim dhe me kulturën e tij. Secili e do dhe kujdeset me një përgjegjësi

të veçantë për tokën dhe shqetësohet për vendin e vet, ashtu si secili duhet ta dojë dhe të kujdeset për shtëpinë e vet në mënyrë që ajo të mos shembet, meqë këtë gjë nuk do ta bëjnë fqinjët. Edhe e mira e botës kërkon që gjithsecili ta mbrojë dhe ta dojë tokën e vet. E njëjta gjë, pasojat e shkatërrimit së një vendi do të prekin të gjithë planetin. Kjo bazohet në kuptimin pozitiv të së drejtës së pronës: ruaj dhe kultivoj diçka që kam në pronësi, në mënyrë që të jetë një kontribut për të mirën e të gjithëve.

144. Po ashtu, ky është një parakusht për shkëmbime të shëndetshme dhe pasuruese. Përvoja e të jetuarit në një vend dhe në një kulturë të caktuar është baza që na bën të aftë të kapim aspekte të realitetit, që ata të cilët nuk e kanë një përvojë të tillë nuk janë në gjendje t'i kapin fort lehtë. Universalja nuk duhet të jetë sundimi homogjen, uniform dhe i standardizuar i një forme të vetme mbizotëruese kulturore, e cila në fund do t'i humbasë ngjyrat e shumëfaqësit dhe do të jetë e neveritshme. Është tundimi që del nga tregimi i lashtë mbi Kullën e Babelit: ndërtimi i një kulle që të arrinte deri në qiell nuk shprehte njësinë midis popujve

të ndryshëm të aftë për të komunikuar sipas larmisë së tyre. Përkundrazi, ishte një përpjekje e rrejshme, lindur nga krenaria dhe ambicja njerëzore, për të krijuar një njësi ndryshe nga ajo që dëshironte Hyji në planin e tij provanor për kombet (krh. Zan 11,1-9).

145. Ekziston një hapje e rreme ndaj universales, e cila buron nga sipërfaqësia e zbrazët e atyre që nuk janë të aftë të depërtojnë plotësisht në atdheun e tyre, ose e atyre që mbartin një inat të pazgjidhur ndaj popullit të tyre. Në çdo rast, "na duhet vazhdimisht që ta zgjerojmë horizontin dhe të shohim të mirën më të madhe që do të na sjellë dobi të gjithëve. Por kjo duhet bërë pa u shmangur dhe pa u çrrënjosur. Duhet t'i lëshojmë thellë rrënjët tona në tokën pjellore dhe në historinë e vendlindjes sonë, që është dhurata e Zotit. Mund të punojmë edhe në një shkallë të ulët, si në vendin ku jetojmë, por këtë gjë duhet ta bëjmë me një perspektivë të gjerë. [...] Sfera globale nuk ndrydh dhe njëanshmëria e izoluar nuk sterilizon"[125], është shumëfaqëshi, ku, ndërsa secili respektohet në vlerën e vet, "e tëra është më e madhe se një pjesë e veçantë, por është gjithashtu më e madhe se shuma e

pjesëve të saj”.[126]

Horizonti i gjithëmbarshëm

146. Ekzistojnë narcizizma lokaliste që nuk shprehin një dashuri të shëndetshme për popullin e vet dhe për kulturën e tij. Fshehin një frymë të mbyllur e cila, për shkak të një pasigurie dhe një frike të caktuar nga të tjerët, preferon të krijojë mure mbrojtëse për të ruajtur veten. Por nuk është e mundur që të jemi lokalistë në mënyrë të shëndetshme pa një hapje të sinqertë dhe të përzemërt ndaj universales, pa e lënë veten që të interpelohemi nga ajo që po ndodh diku tjetër, pa e lënë veten që të pasurohemi nga kulturat e tjera dhe pa u solidarizuar me dramat e popujve të tjerë. Ky lokalizëm mbyllet në mënyrë obsesive mes pak ideve, zakoneve dhe sigurive, i paaftë për të provuar admirim përballë mundësive dhe bukurive të shumta që bota mbarë ofron dhe pa një solidaritet autentik e bujar. Kështu, jeta lokale nuk është më me të vërtetë pranuese, nuk e lë më veten që të plotësohet nga tjetri; prandaj, kufizohet në mundësitë e veta të zhvillimit, bëhet statike dhe sëmuret. Sepse, në realitet, çdo kulturë e shëndetshme është nga natyra e

hapur dhe mikpritëse, kështu që "një kulturë pa vlera universale nuk është një kulturë e vërtetë".[127]

147. Një person, sa më të ngushtë që ta ketë mendjen dhe zemrën, aq më pak do të jetë në gjendje që ta interpretojë realitetin e afërt në të cilin ndodhet. Pa marrëdhënie dhe ballafaqim me atë që është i ndryshëm, është e vështirë që të kemi një njohuri të qartë dhe të plotë të vetvetes dhe të tokës sonë, pasi kulturat e tjera nuk janë armiq nga të cilët njeriu duhet të mbrohet, por pasqyrime të ndryshme të pasurisë së pashtershme të jetës njerëzore. Duke parë vetveten nga këndvështrimi i tjetrit, i atij që është i ndryshëm, secili mund t'i njohë më mirë veçoritë e vetes dhe të kulturës së vet: pasuritë, mundësitë dhe kufizimet. Përvoja që zhvillohet në një vend duhet të zhvillohet "në kontrast" dhe "në harmoni" me përvojat e të tjerëve që jetojnë në kontekste të tjera kulturore.[128]

148. Në realitet, një hapje e shëndetshme kurrë nuk bie ndesh me identitetin. Në fakt, duke u pasuruar me elemente me prejardhje të ndryshme, një kulturë e gjallë nuk bën

një kopje apo një përsëritje të thjeshtë, por përkundrazi i integron risitë sipas mënyrave të veta. Kjo shkakton lindjen e një sinteze të re, prej të cilës përfitojnë të gjithë, pasi edhe kultura prej të cilës burojnë këto kontribute ushqehet nga ana tjetër. Prandaj i kam nxitur këto popujt që t'i ruajnë rrënjët dhe kulturat e tyre stërgjyshore, por kam dashur të sqaroj se nuk ishte "qëllimi im që të propozoja një indigjenizëm krejtësisht të mbyllur, ahistorik, statik, që i ikën çdo forme hibridizimi", prej momentit që "identiteti vetjak kulturor thellohet dhe pasurohet në dialog me realitete të ndryshme dhe mënyra autentike për ta ruajtur atë nuk është një izolim që varfëron".[129] Bota rritet dhe mbushet me bukuri të re falë sintezave të njëpasnjëshme që prodhohen midis kulturave të hapura, larg çdo diktimi kulturor.

149. Për të stimuluar një marrëdhënie të shëndetshme midis dashurisë për atdheun dhe pjesëmarrjes së përzemërt për mbarë njerëzimin, vlen të kujtohet se shoqëria botërore nuk është rezultat i shumës së vendeve të ndryshme, përkundrazi është vetë bashkësia që ekziston midis tyre, është përfshirja e ndërsjellë, respekt i mëparshëm

ndaj lindjes së çdo grupi të veçantë. Në këtë ndërthurje të bashkësisë universale integrohet çdo grup njerëzor dhe aty ai gjen bukurinë e vet. Prandaj, çdo person që lind në një kontekst të caktuar e di se i përket një familjeje më të madhe, pa të cilën nuk është e mundur që të ketë një kuptim të plotë të vetvetes.

150. Kjo qasje, në fund të fundit, kërkon që me gëzim të pranojmë se asnjë popull, asnjë kulturë apo person nuk mund të arrijë gjithçka vetë. Të tjerët janë domosdoshmërisht të nevojshëm për ndërtimin e një jete të plotë. Vetëdija për kufizimin ose anësinë, larg nga të qenit një kërcënim, bëhet çelësi që na bën të ëndërrojmë dhe të zhvillojmë një projekt të përbashkët. Sepse "njeriu është qenia e kufizuar që nuk ka kufi".[130]

Nga rajoni i tyre

151. Ndërshkëmbimi rajonal, duke u nisur prej të cilit vendet më të dobëta i hapen mbarë botës, bën të mundur që universaliteti të mos i zhdukë veçantitë. Një hapje e përshtatshme dhe autentike ndaj botës presupozon aftësinë për t'iu hapur të

afërmit, në një familje kombesh. Integrimi kulturor, ekonomik dhe politik me popujt përreth duhet të shoqërohet nga një proces edukativ që promovon vlerën e dashurisë për të afërmin, ushtrimi i parë i domosdoshëm për arritjen e një integrimi të shëndetshëm universal.

152. Në disa lagje popullore ende jetohet fryma e "lagjes", ku secili e ndien spontanisht detyrën që ta shoqërojë dhe ta ndihmojë fqinjin. Në këto vende që i ruajnë këto vlera bashkësiore, jetohen marrëdhënie fqinjësie me tipare falasshmërie, solidariteti dhe ndërsjellshmërie, duke filluar nga sensi i një "ne" lagjeje.[131] Do të ishte e dëshirueshme që kjo të përjetohej edhe midis vendeve fqinje, me aftësinë për të krijuar një afërsi të përzemërt midis popujve të tyre. Por vizionet individualistike pasqyrohen në marrëdhëniet midis vendeve. Rreziku i të jetuarit duke u mbrojtur nga njëri-tjetri, duke i parë të tjerët si konkurrentë apo si armiq të rrezikshëm, pasqyrohet në marrëdhëniet me popujt e rajonit. Ndoshta jemi edukuar me këtë frikë dhe këtë mosbesim.

153. Ka vende të fuqishme dhe ndërmarrje të mëdha që përfitojnë nga ky izolim dhe preferojnë që të merren me secilin vend veç e veç. Përkundrazi, për vendet e vogla apo të varfra hapet mundësia për të arritur marrëveshje rajonale me fqinjët e tyre, të cilat u mundësojnë atyre që të negociojnë si një e tërë dhe të shmangin kthimin në segmente margjinale dhe të varura nga fuqitë e mëdha. Sot, asnjë shtet komb i izoluar nuk është në gjendje që të sigurojë të mirën e përbashkët të popullsisë së vet.

KAPITULLI I PESTË

POLITIKA MË E MIRË

154. Për ta bërë të mundur zhvillimin e një bashkësie botërore, të aftë për të realizuar vëllazërimin duke filluar nga popujt dhe kombet që e jetojnë miqësinë shoqërore, është e nevojshme politika më e mirë, vënë në shërbim të së mirës së vërtetë të përbashkët. Për fat të keq, përkundrazi, politika sot shpesh merr forma që pengojnë ecjen drejt një tjetër bote.

Populizmat dhe liberalizmat

155. Përbuzja për të dobëtit mund të fshihet në forma populiste, të cilat i përdorin në mënyrë demagogjike për qëllimet e tyre, ose në forma liberale në shërbim të interesave ekonomike të të fuqishmëve. Në të dy rastet është e vështirë të mendosh për një botë të hapur ku ka vend për të gjithë, që

përfshin më të dobëtit dhe respekton kulturat e ndryshme.

Popullore apo populiste

156. Vitet e fundit, shprehja "populizëm" ose "populist" ka pushtuar mediat dhe fjalorin në përgjithësi. Kështu ajo humbet vlerën që mund të ketë dhe bëhet njëri nga polaritetet e shoqërisë së ndarë. Kjo ka arritur deri atje sa të pretendojë t'i klasifikojë të gjithë njerëzit, grupet, shoqëritë dhe qeveritë mbi bazën e një ndarje binare: "populiste" ose "jo-populiste". Sot nuk është më e mundur që dikush të shprehet për ndonjë çështje pa u përpjekur që të klasifikohet në njërin prej këtyre dy poleve, ose për ta diskredituar atë padrejtësisht ose për ta lartësuar në mënyrë të tepruar.

157. Pretendimi për ta vendosur populizmin si çelës për leximin e realitetit shoqëror përmban një pikë tjetër të dobët: faktin se ai injoron legjitimitetin e nocionit popull. Përpjekja për ta zhdukur këtë kategori nga fjalori mund të çojë në eleminimin e vetë fjalës "demokraci" ("qeverisja e popullit"). Sidoqoftë, për të pohuar se shoqëria është më

shumë sesa shuma e thjeshtë e individëve, është i domosdoshëm termi "popull". Realiteti është se ka fenomene shoqërore që strukturojnë shumicën, ka mega-prirje dhe aspirata bashkësiore; po ashtu, mund të mendohet për objektiva të përbashkëta, përtej ndryshimeve, për të zbatuar së bashku një projekt të bashkëndarë; në fund, është shumë e vështirë që të projektosh diçka të madhe në planin afatgjatë nëse nuk arrihet të bëhet një ëndërr kolektive. E gjithë kjo gjen shprehje në emrin "popull" dhe në mbiemrin "popullor". Nëse nuk do t'i përfshinte ato - së bashku me një kritikë të fortë të demagogjisë - do të hiqej dorë nga një aspekt themelor i realitetit shoqëror.

158. Në fakt ekziston një keqkuptim. "Populli nuk është një kategori logjike, as nuk është një kategori mistike, nëse e marrim në kuptimin që gjithçka që bën populli është e mirë, ose në kuptimin që populli është një kategori e engjëllizuar. Por jo! Populli është një kategori mitike [...] Kur shpjegon se çfarë është një popull, përdor kategori logjike, sepse duhet ta shpjegosh atë: nevojiten, sigurisht. Por nuk e shpjegosh kështu ndjenjën e përkatësisë ndaj popullit.

Fjala popull ka diçka më shumë që nuk mund të shpjegohet në mënyrë logjike. Të jesh pjesë e popullit do të thotë të jesh pjesë e një identiteti të përbashkët përbërë nga lidhje shoqërore dhe kulturore. Dhe kjo nuk është diçka automatike, përkundrazi: është një proces i ngadaltë, i vështirë ... drejt një projekti të përbashkët”.[132]

159. Ka udhëheqës popullor të aftë për ta interpretuar ndjenjën e një populli, dinamikën e tij kulturore dhe prirjet e mëdha të një shoqërie. Shërbimi që ofrojnë, duke bashkuar dhe duke udhëhequr, mund të jetë baza për një projekt të qëndrueshëm shndërrimi dhe rritjeje, që nënkupton edhe aftësinë për t’ua lënë vendin të tjerëve në kërkimin e të mirës së përbashkët. Por ai degjeneron në një populizëm të pashëndetshëm kur kthehet në aftësinë e dikujt për të marrë konsensusin me qëllim që ta shfrytëzojë politikisht kulturën e popullit, nën çfarëdo shenje ideologjike, në shërbim të një projekti personal dhe të qëndrimit të vet në pushtet. Herë të tjera synon të grumbullojë popullaritet duke nxitur prirjet më të ulta dhe egoiste të disa sektorëve të popullsisë. Kjo përkeqësohet kur arrihet, në

forma të trasha ose të holla, një nënshtrim i institucioneve dhe i ligjshmërisë.

160. Grupet e mbyllura populiste shtrembërojnë fjalën "popull", pasi në realitet ajo për të cilën ata flasin nuk është një popull i vërtetë. Në fakt, kategoria e "popullit" është e hapur. Një popull i gjallë, dinamik me një të ardhme është ai që mbetet vazhdimisht i hapur për sinteza të reja duke përfshirë atë që është e ndryshme. Nuk e bën këtë duke mohuar vetveten, por përkundrazi me gatishmërinë për t'u vënë në lëvizje dhe për ta pyetur veten, për t'u zgjeruar, për t'u pasuruar nga të tjerët dhe në këtë mënyrë mund të zhvillohet.

161. Një shprehje tjetër e tjetërsuar e një autoriteti popullor është kërkimi i interesit të menjëhershëm. U përgjigjet nevojave popullore për të siguruar vota ose mbështetje, por pa përparuar në një angazhim të mundimshëm dhe të vazhdueshëm që u ofron personave burimet për zhvillimin e tyre, për t'i bërë ballë jetës me përpjekjet dhe krijimtarinë e tyre. Në këtë kuptim kam pohuar me qartësi se "nuk jam duke sugjeruar një populizëm të papërgjegjshëm".[133] Nga njëra anë,

kapërcimi i pabarazisë kërkon zhvillimin e ekonomisë, duke bërë që të sjellin fryte potencialitetet e çdo rajoni dhe duke siguruar kështu një barazi të qëndrueshme.[134]] Nga ana tjetër, "projektet e asistencës shoqërore të cilat plotësojnë disa nga nevojat më të ngutshme duhet të shihen thjesht si reagime të përkohshme".[135]

162. Tema e madhe është puna. Ajo që është me të vërtetë popullore - sepse promovon të mirën e popullit - është që t'u sigurojë të gjithëve mundësinë që të mbijnë farat e mbjella nga Hyji në secilin prej nesh, aftësitë e tij, nisma e tij, forca e tij. Kjo është ndihma më e mirë për një të varfër, udha më e mirë për një ekzistencë dinjitoze. Prandaj, këmbëngul në faktin se "ndihma e të varfërve me para duhet të jetë gjithmonë një zgjidhje e përkohshme për të përballuar disa emergjenca. Objektivi i vërtetë duhet të jetë gjithmonë ai që t'u lejohet atyre një jetë e denjë nëpërmjet punës".[136] Edhe pse i ndryshojnë sistemet e prodhimit, politika nuk mund të heqë dorë nga objektivi për të arritur që organizimi i një shoqërie t'i sigurojë çdo personi një mënyrë për të kontribuar me aftësitë dhe angazhimin e

tij. Në fakt, "nuk ka varfëri më të keqe se ajo që të privon prej punës dhe dinjitetit të punës".[137] Në një shoqëri me të vërtetë të përparuar, puna është një përmasë e jetës shoqërore prej të cilës nuk mund të hiqet dorë, sepse jo vetëm që është një mënyrë për të fituar bukën, por edhe një mjet për rritjen personale, për krijimin e marrëdhënieve të shëndetshme, për shprehjen e vetvetes, për bashkëndarjen e dhuratave, për t'u ndier bashkëpërgjegjës për përmirësimin e botës dhe, në fund, për të jetuar si popull.

Vlerat dhe kufijtë e vizioneve liberale

163. Kategoria e popullit, në të cilën është i brendshëm një vlerësim pozitiv i lidhjeve bashkësiore dhe kulturore, vazhdimisht hidhet poshtë nga pikëpamjet liberale individualiste, në të cilat shoqëria konsiderohet si një shumë e thjeshtë e interesave që bashkëjetojnë me njëra-tjetrën. Flasin për respektimin e lirive, por pa rrënjën e një narrative të përbashkët. Në disa kontekste, është e shpeshtë akuza e populizmit ndaj të gjithë atyre që mbrojnë të drejtat e më të dobëtve në shoqëri. Për këto vizione, kategoria e popullit është një

mitizim i diçkaje që në realitet nuk ekziston. Sidoqoftë, këtu krijohet një polarizim i panevojshëm, pasi as ai i popullit dhe as i të afërmit nuk janë kategori thjesht mitike ose romantike, të tilla sa të përjashtojnë ose të përçmojnë organizimin shoqëror, shkencën dhe institucionet e shoqërisë civile.[138]

164. Dashuria-bamirësi i bashkon të dyja përmasat - atë mitike dhe atë institucionale - meqë nënkupton një ecje të efektshme shndërrimi të historisë që kërkon trupëzimin e gjithçkaje: institucionet, të drejtën, teknikën, përvojës, kontributet profesionale, analizën shkencore, procedurat administrative, etj. Sepse "në fakt nuk ka jetë private nëse nuk mbrohet nga një rend publik; një shtëpi e ngrohtë nuk ka intimitet nëse nuk është nën mbrojtjen e ligjshmërisë, të një gjendjeje qetësie të bazuar në ligj e në forcë dhe me kushtin e një minimumi mirëqenieje të siguruar nga bashkëndarja e punës, shkëmbimet tregtare, drejtësia sociale dhe qytetaria politike".[139]

165. Dashuria-bamirësi e vërtetë është e aftë që ta përfshijë gjithë këtë në përkushtimin e saj dhe nëse duhet të shprehet në takimin

person me person, është gjithashtu në gjendje të arrijë një vëlla dhe një motër të largët, madje edhe të shpërfillur, përmes burimeve të ndryshme që institucionet e një shoqërie të organizuar, të lirë dhe krijuese janë të afta të krijojnë. Në këtë rast specifik, edhe samaritani i mirë ka pasur nevojë për një han, me qëllim që të bënte atë që ai i vetëm në atë moment nuk ishte në gjendje të bënte. Dashuria për të afërmin është realiste dhe nuk shkapërderdh asgjë që është e nevojshme për një shndërrim të historisë së orientuar për të mirën e të fundmëve. Nga ana tjetër, ndonjëherë ka ideologji të majta apo doktrina shoqërore të kombinuara me zakone individualiste dhe procedura jo të efektshme që arrijnë vetëm pak vetë. Ndërkohë, shumica e të braktisurve mbetet në mëshirën e vullnetit të mirë të mundshëm të disave. Kjo tregon se është e nevojshme që të nxitet jo vetëm një përshpirtëri vëllazërie, por në të njëjtën kohë një organizim botëror më i efektshëm, në mënyrë që të ndihmojë në zgjidhjen e problemeve të ngutshme të të braktisurve që vuajnë dhe vdesin në vendet e varfra. Kjo nga ana tjetër nënkupton se nuk ka një rrugëdalje të vetme të mundshme, një metodologji të vetme të pranueshme,

një recetë ekonomike që mund të zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë, dhe presupozon që edhe shkenca më rigoroze të propozojë rrugëtime të ndryshme.

166. E gjithë kjo mund të ketë pak qëndrueshmëri, nëse humbasim aftësinë për të njohur nevojën për një ndryshim në zemrat, zakonet dhe stilet e jetës së njeriut. Kjo është ajo që ndodh kur propaganda politike, media dhe krijuesit e opinionit publik këmbëngulin në nxitjen e një kulture individualiste dhe naive përballë interesave ekonomikë pa rregulla dhe për organizimin e shoqërive në shërbim të atyre që tashmë kanë tepër fuqi. Prandaj, kritika ime ndaj paradigmës teknokratike nuk do të thotë se vetëm duke u përpjekur që të kontrollojmë teprimet e saj mund të jemi të sigurt, sepse rreziku më i madh nuk qëndron në gjërat, në realitetet materiale, në organizatat, por në mënyrën se si njerëzit i përdorin ato. Çështja është dobësia njerëzore, prirja e vazhdueshme njerëzore për egoizëm, e cila është pjesë e asaj që tradita e krishterë e quan "lakmi": prirja e qenies njerëzore për t'u mbyllur në imanencën e unit të tij, të grupit të tij, të interesave të tyre meskine.

Kjo lakmi nuk është një e metë e epokës sonë. Ka ekzistuar që kur njeriu ka qenë njeri dhe thjesht shndërrohet, merr forma të ndryshme ndër shekuj, duke përdorur mjetet që momenti historik i vë në dispozicion. Por është e mundur ta mbizotërojë atë me ndihmën e Hyjit.

167. Angazhimi edukativ, zhvillimi i zakoneve solidare, aftësia për të menduar për jetën njerëzore në mënyrë më tërësore dhe thellësia shpirtërore janë realitete të nevojshme për t'i dhënë cilësi marrëdhënieve njerëzore, në mënyrë të tillë që të jetë vetë shoqëria që reagon ndaj padrejtësive, devijimeve, abuzimeve të fuqive ekonomike, teknologjike, politike dhe mediatike të saj. Ka vizione liberale që e shpërfillin këtë faktor të dobësisë njerëzore dhe imagjinojnë një botë që i përgjigjet një rendi të caktuar, të aftë për t'i siguruar të ardhmen dhe zgjidhjen e të gjitha problemeve.

168. Tregu i vetëm nuk zgjidh gjithçka, edhe nganjëherë duan që ne ta besojmë këtë dogmë besimi neoliberal. Bëhet fjalë për një mendim të varfër, përsëritës, që propozon gjithmonë të njëjtat receta përballë çfarëdo

sfide që paraqitet. Neoliberalizmi riprodhon vetveten ashtu siç është, duke përdorur teorinë magjike të "tejmbushjes" ose "rrjedhjes" - pa e përmendur atë - si mënyra e vetme për t'i zgjidhur problemet sociale. Nuk e kuptojmë se tejmbushja e pretenduar nuk e zgjidh pabarazinë, e cila është burim i formave të reja të dhunës që kërcënojnë strukturën shoqërore. Nga njëra anë është e domosdoshme një politikë ekonomike aktive, "që favorizon larmizimin prodhues dhe krijimtarinë sipërmarrëse",[140] në mënyrë që të jetë e mundur të rriten vendet e punës në vend që të zvogëlohen ato. Spekulimi financiar me fitimin e lehtë të parave si qëllim themelor vazhdon të bëjë kërdinë. Nga ana tjetër, "pa format e brendshme të solidaritetit dhe të besimit të ndërsjellë, tregu nuk mund ta kryejë plotësisht funksionin e vet ekonomik. E sot është pikërisht ky besim që mungon dhe humbja e besimit është një humbje e madhe".[141] Fundi i historisë nuk ka qenë i tillë dhe recetat dogmatike të teorisë mbizotëruese ekonomike kanë treguar se nuk janë të pagabueshme. Brishtësia e sistemeve botërore përballë pandemisë ka vënë në dukje se jo gjithçka mund të zgjidhet me lirinë e tregut dhe se, përveç

rehabilitimit të një politike të shëndetshme që nuk i nënshtrohet diktateve të financës, "duhet ta vendosim sërish në qendër dinjitetin njerëzor dhe në atë shtyllë duhet të ndërtohen strukturat alternative sociale për të cilat kemi nevojë".[142]

169. Në disa vizione të mbyllura dhe monokromatike ekonomistike, duket se nuk kanë vend, për shembull, lëvizjet popullore që mbledhin të papunë, punëtorë të përkohshëm dhe informalë dhe shumë të tjerë që nuk futen lehtë në kanalet e paracaktuara. Në realitet, ato i japin jetë formave të ndryshme të ekonomisë popullore dhe të prodhimit bashkësior. Është e nevojshme që të mendohet për pjesëmarrjen shoqërore, politike dhe ekonomike në mënyra të tilla "që t'i përfshijnë lëvizjet popullore dhe të gjallërojnë strukturat e qeverisjes lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare me atë përrua energjie morale që lind nga përfshirja e të përjashtuarve në ndërtimin e një fati të përbashkët"; në të njëjtën kohë, është mirë që të sigurohet "që këto lëvizje, këto përvoja solidariteti që rriten nga poshtë, nga nëntoka e planetit, të bashkohen, të jenë më të koordinuara, të takohen".[143] Por, e gjithë

kjo, pa tradhtuar stilin e tyre karakteristik, sepse ata janë "mbjellës ndryshimi, nxitës të një procesi ku miliona veprime të vogla dhe të mëdha konvergojnë në mënyrë krijuese, si në një poezi".[144] Në këtë kuptim janë "poetë shoqërorë", të cilët punojnë, propozojnë, promovojnë dhe lirojnë në mënyrën e tyre. Me ta, do të jetë i mundur një zhvillim tërësor njerëzor, i cili kërkon kapërcimin e asaj ideje "të politikave sociale të konceptuara si një politikë *ndaj* të varfërve, por kurrë *me* të varfrit, kurrë *e* të varfërve dhe shumë më pak të përfshirë në një projekt që i bashkon popujt".[145] Edhe pse janë të bezdisshëm, edhe pse disa "mendimtarë" nuk dinë si t'i klasifikojnë, duhet pasur guxim që të pranojmë se pa to "demokracia atrofizohet, bëhet një nominalizëm, një formalitet, humbet përfaqësueshmërinë, çmishërohet, sepse lë popullin jashtë në luftën e tij të përditshme për dinjitet, në ndërtimin e fatit të tij".[146]

Pushteti ndërkombëtar

170. Ia lejoj vetes që të përsëris se "kriza financiare e viteve 2007-'08 ishte rasti për të zhvilluar një ekonomi të re më të kujdesshme

ndaj parimeve etike, për një planifikim të ri të veprimtarisë financiare spekulative dhe të pasurisë virtuale. Por nuk pati një reagim që do të bënte të rimendoheshin kriteret e vjetra që vazhdojnë ta drejtojnë botën”.[147] Madje, duket se strategjitë efektive të zhvilluara më vonë në botë janë orientuar drejt një individualizmi më të madh, një integrimi më të vogël, një lirie më të madhe për të pushtetshmit e vërtetë, të cilët gjithmonë gjejnë një mënyrë për të dalë të padëmtuar.

171. Do të doja të insistoja mbi faktin se “t’i japësh secilit gjënë e vet, sipas përkufizimit klasik të drejtësisë, do të thotë që asnjë individ ose grup njerëzor nuk mund të konsiderohet i gjithëpushtetshëm, i autorizuar për të shkelur dinjitetin dhe të drejtat e individëve ose të grupeve shoqërore. Shpërndarja *de facto* e pushtetit - politik, ekonomik, ushtarak, teknologjik dhe kështu me radhë - midis një shumice subjektesh dhe krijimi i një sistemi juridik për rregullimin e pretendimeve dhe të interesave, sjell kufizimin e pushtetit. Sot, megjithatë, panorama botërore na paraqet shumë të drejta të rreme, dhe - në të njëjtën kohë - sektorë të mëdhenj pa mbrojtje, viktima të

një ushtrimi të keq të pushtetit”.[148]

172. Shekulli XXI sheh “një humbje pushteti të Shteteve kombëtare, sidomos sepse përmasa ekonomiko-financiare, me karakteristika transkombëtare, priret të sundojë mbi politikën. Në këtë kontekst, bëhet i domosdoshëm zhvillimi i institucioneve ndërkombëtare më të forta dhe të organizuara në mënyrë të efektshme, me autoritete të caktuara në mënyrë të paanshme nëpërmjet marrëveshjeve mes qeverive kombëtare dhe të pajisura me pushtetin për të sanksionuar”.[149] Kur flitet për mundësinë e një forme të autoritetit botëror të rregulluar nga e drejta,[150] jo domosdoshmërisht duhet të mendojmë për një autoritet personal. Sidoqoftë, së paku duhet të parashikojë krijimin e organizatave më të efektshme botërore, të pajisura me autoritet për të siguruar të mirën e përbashkët botërore, çrrënjosjen e urisë dhe të mjerimit, si dhe mbrojtjen e sigurt të të drejtave themelore të njeriut.

173. Në këtë këndvështrim, kujtoj se është e nevojshme një reformë “qoftë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara qoftë e arkitekturës ekonomike e financiare

ndërkombëtare, me qëllim që të mund t'i jepet konkretësi reale konceptit të familjes së Kombeve".[151] Pa dyshim, kjo presupozon kufizime të caktuara juridike, për të shmangur që bëhet fjalë për një autoritet të përfshirë vetëm nga disa vende dhe, në të njëjtën kohë, për të parandaluar diktime kulturore ose zvogëlimin e lirive thelbësore të kombeve më të dobëta për shkak të dallimeve ideologjike. Në fakt, "Bashkësia ndërkombëtare është një bashkësi juridike e bazuar në sovranitetin e çdo Shteti anëtar, pa lidhje nënvarësie që t'i mohojë apo t'i kufizojë atij pavarësinë".[152] Por "detyra e Kombeve të Bashkuara, duke filluar nga postulatet e Preambulës dhe nenet e para të Kartës së saj Kushtetuese, mund të shihet si zhvillimi dhe promovimi i sovranitetit të së drejtës, duke ditur se drejtësia është një kusht i domosdoshme për të realizuar idealin e vëllazërisë universale.[...] Duhet të sigurohet sundimi i padiskutueshëm i të drejtës dhe kërkesa e palodhur për negociata, i zyrave të mira dhe i arbitrazhit, siç propozohet nga *Karta e Kombeve të Bashkuara*, normë e vërtetë themelore juridike".[153] Duhet të shmangim që kjo Organizatë të delegjitimohet, sepse problemet dhe të metat

e saj mund të adresohen dhe të zgjidhen bashkërisht.

174. Duhet guxim dhe bujari për të vendosur lirisht disa objektiva të përbashkëta dhe për të siguruar përmbushjen e disa normave thelbësore në të gjithë botën. Që kjo të jetë vërtet e dobishme, duhet mbështetur "kërkesa që të mbahen angazhimet e nënshkruara ("*pacta sunt servanda*")",[154] në mënyrë që të shmanget "tundimi për t'iu drejtuar ligjit të forcës, sesa forcës së ligjit".[155] Kjo kërkon forcimin e mjeteve "normative për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve [...] në mënyrë që të përforcohet rëndësia dhe detyrueshmëria e tyre".[156] Midis këtyre instrumenteve normativë, duhet të favorizohen marrëveshjet shumëpalëshe midis shteteve, me qëllim që të garantojnë më mirë marrëveshjet dypalëshe në lidhje me kujdesin ndaj të mirës të përbashkët universale dhe për mbrojtjen e shteteve më të dobëta.

175. Falë Zotit, shumë grumbullime dhe organizata të shoqërisë civile ndihmojnë për të kompensuar dobësitë e Bashkësisë ndërkombëtare, mungesën e saj të koordinimit

në situata komplekse, mungesën e saj të vëmendjes ndaj të drejtave themelore të njeriut dhe ndaj situatave shumë kritike të disa grupeve. Kështu, parimi i subsidiaritetit merr një shprehje konkrete, i cili garanton pjesëmarrjen dhe veprimin e bashkësive dhe të organizatave të një niveli më të ulët, të cilat integrojnë në një mënyrë përplotësuese veprimin e shtetit. Shumë herë ata bëjnë përpjekje të lavdërueshme duke menduar për të mirën e përbashkët dhe disa nga anëtarët e tyre shkojnë aq larg sa kryejnë gjeste vërtet heroike, të cilat tregojnë se për sa bukuri është ende i aftë njerëzimi ynë.

Një bamirësi shoqërore dhe politike

176. Për shumë vetë, politika sot është një fjalë e keqe dhe nuk mund të shpërfillet që pas këtij fakti ka shpesh gabime, korrupsion, paefektshmëri të disa politikanëve. Kësaj i shtohen strategjitë që synojnë ta dobësojnë atë, ta zëvendësojnë atë me ekonominë ose ta dominojnë me ndonjë ideologji. E megjithatë, a mund të funksionojë bota pa politikën? A mund të gjejë një mënyrë të efektshme drejt vëllazërisë universale dhe paqes shoqërore pa një politikë të mirë?[157]

Politika që duhet

177. Po ia lejoj vetes që të përsëris se "Politika nuk duhet t'i nënshtrohet ekonomisë dhe kjo nuk duhet t'u nënshtrohet diktateve dhe paradigmës efiçientiste të teknokracisë".[158] Edhe pse duhet të refuzohet keqpërdorimi i pushtetit, korrupsioni, mosrespektimi i ligjit dhe paefektshmëria, "nuk mund të justifikohet një ekonomi pa politikë, që do të ishte e paaftë të përvetësojë një tjetër logjikë në gjendje të drejtojë aspektet e ndryshme të krizës aktuale".[159] Përkundrazi, "kemi nevojë për një politikë që mendon me një vizion të gjerë, dhe që çon përpara një kriter të ri integral, duke përfshirë në një dialog ndërdisiplinor".[160] Po mendoj që "duhet t'i jepet më shumë hapësirë një politike të shëndoshë, të aftë për të reformuar institucionet, për t'i koordinuar dhe pajisur ato me praktika të mira, që lejojnë të kapërcehen shtytjet dhe inercitë e mbrapshta".[161] Kjo nuk mund t'i kërkohet ekonomisë dhe as nuk mund të pranohet që ajo të marrë fuqinë reale të shtetit.

178. Përballë kaq shumë forma politikash meskine që synojnë interesin e menjëhershëm,

kujtoj se “madhështia politike dëftohet kur, në momentet e vështira, veprohet në bazë të parimeve të mëdha dhe duke menduar për të mirën e përbashkët afatgjatë. Pushteti politik e ka shumë të vështirë ta pranojë këtë detyrë në një projekt Kombi”[162] dhe, edhe më shumë, në një projekt të përbashkët për njerëzimin e tanishëm dhe të ardhshëm. Të mendosh për ata që do të vijnë nuk u shërben qëllimeve elektorale, por është ajo që kërkon një drejtësi autentike, sepse, ashtu siç kanë mësuar Ipeshkvijtë e Portugalisë, toka “është një hua që merr çdo brez, të cilën pasta jai duhet t’ia kalojë brezit tjetër”.[163]

179. Shoqëria botërore ka mangësi serioze strukturore të cilat nuk zgjidhen thjesht me rregullime të çastit ose zgjidhje të shpejta rastësore. Ka gjëra që duhet të ndryshohen përmes ndryshimit të bazës dhe shndërrimeve të mëdha. Vetëm një politikë e shëndoshë mund të jetë në krye, duke përfshirë sektorët më të ndryshëm dhe njohuritë më të larmishme. Në këtë mënyrë, një ekonomi e integruar në një projekt politik, shoqëror, kulturor dhe popullor që synon të mirën e përbashkët mund t’ua hapë rrugën “shanseve të ndryshme, që nuk kërkojnë të

ndalet krijimtaria njerëzore dhe ëndrra e saj për përparim, por që të drejtohet kjo energji në mënyrë të re”.[164]

Dashuria politike

180. Njohja e çdo qenieje njerëzore si vëlla apo motër dhe kërkimi i një miqësie shoqërore që t’i përfshijë të gjithë nuk janë thjesht utopi. Kërkojnë vendimin dhe aftësinë për të gjetur rrugëtime të efektshme që sigurojnë mundësinë e tyre reale. Çfarëdo angazhimi në këtë drejtim bëhet një ushtrim i lartë i dashurisë-bamirësi. Sepse një individ mund të ndihmojë një person në nevojë, por kur bashkohet me të tjerët për t’u dhënë jetë proceseve shoqërore të vëllazërisë dhe të drejtësisë për të gjithë, hyn në “fushën e bamirësisë më të gjerë, të bamirësisë politike”.[165] Bëhet fjalë për përparimin drejt një rendi shoqëror dhe politik, shpirti i të cilit duhet të jetë bamirësia shoqërore.[166] Edhe një herë ju ftoj që ta rivlerësoni politikën, e cila “mbetet thirrja më e lartë dhe njëra nga format më të çmuara të dashurisë-bamirësi, sepse kërkon të mirën e përbashkët”.[167]

181. Të gjitha angazhimet që burojnë

nga Doktrina Shoqërore e Kishës "janë nxjerrë prej dashurisë që, sipas mësimit të Jezusit, është përmbledhja e krejt Ligjit (krh. *Mt* 22,36-40)".[168] Kjo kërkon të njohim se "dashuria, plot me gjeste të vogla kujdesi të ndërsjellë, është edhe civile e politike, dhe dëftohet në të gjitha veprimet që përpiqen të ndërtojnë një botë më të mirë".[169] Për këtë arsye, dashuria shprehet jo vetëm në marrëdhëniet intime dhe të afërta, por edhe në "makro-marrëdhëniet: marrëdhëniet shoqërore, ekonomike, politike".[170]

182. Kjo dashuri-bamirësi politike presupozon se ka zhvilluar një sens shoqëror që tejkalon çdo mentalitet individualist: "Dashuria shoqërore na bën ta duam të mirën e përbashkët dhe na bën ta kërkojmë efektivisht të mirën e të gjithë personave, të konsideruar jo vetëm individualisht, por edhe në përmasën shoqërore që i bashkon".[171] Gjithkush është plotësisht person kur i përket një populli dhe në të njëjtën kohë nuk ka popull të vërtetë pa respekt për fytyrën e secilit person. Popull dhe person janë terma korrelativë. Sidoqoftë, sot pretendohet që personat të reduktohen në individë, lehtësisht të dominuar nga fuqi që synojnë interesa të

paligjshme. Politika e mirë kërkon rrugë ndërtimi bashkësish në nivele të ndryshme të jetës shoqërore, në mënyrë që të riekuilibrojë dhe të riorientojë globalizimin për të shmangur efektet e tij shpërbërëse.

Dashuri e efektshme

183. Duke u nisur nga "dashuria shoqërore"[172] është e mundur që të shkohet drejt një qytetërimi të dashurisë, për të cilin të gjithë mund të ndihemi të thirrur. Dashuria-bamirësi, me dinamizmin e saj universal, mund të ndërtojë një botë të re,[173] sepse nuk është një ndjenjë sterile, por mënyra më e mirë për të arritur rrugë të efektshme zhvillimi për të gjithë. Dashuria shoqërore është një "forcë e aftë të nxisë rrugë të reja për të përballuar problemet e botës së sotme e për të përtërirë thellësisht nga brenda struktura, organizata shoqërore, rende juridike".[174]

184. Dashuria-bamirësi është në zemër të çdo jete të shëndetshme dhe të hapur shoqërore. Megjithatë, sot "deklarohet lehtë parëndësia e saj për t'i interpretuar dhe drejtuar përgjegjësitë morale".[175] Është

shumë më tepër sesa një sentimentalizëm subjektiv, nëse ajo shoqërohet me një angazhim ndaj të vërtetës, në mënyrë që të mos jetë lehtësisht "pre e emocioneve dhe e opinioneve të rastësishme të subjekteve".[176] Marrëdhënia e saj me të vërtetën favorizon te dashuria-bamirësi universalizmin e saj dhe kështu e ruan atë nga kufizimi vetëm brenda "një fushe të ngushtë dhe private marrëdhëniesh".[177] Përndryshe, "do të përjashtohet prej planeve dhe prej proceseve të ndërtimit të një zhvillimi njerëzor me përmasa universale, në dialogun mes dijeve dhe veprueshmërive".[178] Pa të vërtetën, emocioni zbrazet nga përmbajtja marrëdhënore dhe shoqërore. Prandaj, hapja ndaj të vërtetës e mbron dashurinë-bamirësi nga një besim i rremë, "që e privon prej frymëmarrjes njerëzore dhe universale".[179]

185. Dashuria-bamirësi ka nevojë për dritën e të vërtetës që ne vazhdimisht kërkojmë dhe "kjo dritë është ajo e arsyes dhe e fesë",[180] pa relativizma. Kjo gjithashtu nënkupton zhvillimin e shkencave dhe kontributin e tyre të pazëvendësueshëm me qëllim gjetjen e rrugëve konkrete dhe më të sigurta për të arritur rezultatet e dëshiruara.

Në fakt, kur bëhet fjalë për të mirën e të tjerëve, nuk mjaftojnë qëllimet e mira, por bëhet fjalë për të arritur në mënyrë të efektshme atë për të cilën ata dhe kombet e tyre kanë nevojë për t'u realizuar.

Aktiviteti i dashurisë politike

186. Ekziston e ashtuquajtura dashuri "*spontane*", veprimet e të cilën lindin drejtpërdrejt nga virtyti i dashurisë-bamirësi dhe u drejtohen personave dhe popujve. Pastaj ekziston një dashuri "*e diktuar*", aktet e të cilës na shtyjnë që të krijojmë institucione më të shëndetshme, rende më të drejta, struktura më solidare.[181] Nga kjo rrjedh që është "një akt dashurie po aq i domosdoshëm edhe angazhimi që ka për qëllim ta organizojë e ta strukturojë shoqërinë në mënyrë që i afërmi të mos gjendet në mjerim".[182] Është dashuri-bamirësi të qëndrosh afër një personi që vuan dhe është gjithashtu dashuri-bamirësi gjithçka që bën dikush, edhe pa pasur kontakt të drejtpërdrejtë me atë person, për të ndryshuar kushtet shoqërore që atij i shkaktojnë vuajtje. Nëse dikush ndihmon një të moshuar për të kaluar një lumë - dhe kjo është dashuri-bamirësi e

mrekullueshme - politikani ndërton për të një urë, edhe kjo është dashuri-bamirësi. Nëse dikush ndihmon tjetrin duke i dhënë për të ngrënë, politikani krijon një punë për të dhe ushtron një formë shumë të lartë bamirësie që fisnikëron veprimin e tij politik.

Sacrificat e dashurisë

187. Kjo dashuri-bamirësi, zemra e shpirtit të politikës, është gjithmonë një dashuri preferenciale për të fundmit, e cila qëndron pas çdo veprimi të ndërmarrë në favor të tyre.[183] Vetëm me një vështrim horizonti i të cilës të shndërrohet nga dashuria-bamirësi, që e shtyn atë të dallojë dinjitetin e tjetrit, të varfrit njihen dhe vlerësohen në dinjitetin e tyre të pamasë, respektohen në stilin dhe kulturën e tyre, dhe për këtë arsye integrohen me të vërtetë në shoqëri. Ky vështrim është thelbi i shpirtit autentik të politikës. Duke nisur prej aty, shtigjet që hapen janë të ndryshme nga ato të një pragmatizmi të pashpirt. Për shembull, "nuk mund të trajtohet skandali i varfërisë duke promovuar strategji kontrolli që vetëm i sigurojnë dhe i shndërrojnë të varfrit në qenie të zbutura dhe të padëmshme. Sa

trishtuese është të shohësh që, prapa veprave të supozuara altruiste, tjetri reduktohet që të bëhet pasiv”.[184] Ajo që nevojitet është që të ketë kanale të ndryshme shprehjeje dhe pjesëmarrjeje shoqërore. Edukimi është në shërbim të kësaj ecjeje, në mënyrë që çdo qenie njerëzore të bëhet arkitekti i fatit të tij. Këtu parimi i *subsidiaritetit*, i pandashëm nga parimi i *solidaritetit*, tregon vlerën e tij.

188. Prej këtu lind nevoja urgjente për të gjetur një zgjidhje për gjithçka që sulmon të drejtat themelore të njeriut. Politikanët janë të thirrur që të kujdesen për “brishtësinë, brishtësinë e popujve dhe të personave. Të kujdesesh për brishtësinë do të thotë forcë dhe butësi, do të thotë luftë dhe frytshmëri në mes të një modeli funksionalist dhe privatist që të çon në mënyrë të pashmangshme në “kulturën e skarcos”.[…] Do të thotë të marrësh përgjegjësinë për të tashmen në situatën e saj më mënjanuese dhe shqetësuese dhe të jesh në gjendje ta veshësh atë me dinjitet”.[185] Në këtë mënyrë, sigurisht që zhvillohet një aktivitet intensiv, sepse “gjithçka duhet të bëhet për të mbrojtur gjendjen dhe dinjitetin e personit njerëzor”.[186] Politikani është një realizues, është një ndërtues me objektiva

të mëdha, me një vështrim të gjerë, realistik dhe pragmatik, edhe përtej vendit të tij. Shqetësimet kryesore të një politikani nuk do të duhej të ishin ato të shkaktuara nga vënia nën hetim, por nga fakti se nuk ka gjetur një zgjidhje efektive për "fenomenin e përjashtimit shoqëror dhe ekonomik, me pasojat e tij të trishtueshme të trafikimit të qenieve njerëzore, të tregtisë të organeve dhe të indeve njerëzore, të shfrytëzimit seksual të fëmijëve, të punës skllavëruese, përfshirë prostitucionin, trafikimin e drogës dhe të armëve, të terrorizmit dhe të krimit të organizuar ndërkombëtar. I tillë është rendi i madhësisë së këtyre situatave dhe numri i jetëve të pafajshme të përfshira, sa duhet të shmangim çdo tundim për të rënë në një nominalizëm deklamues me një efekt qetësues të ndërgjegjeve. Duhet të kujdesemi që institucionet tona të jenë me të vërtetë të efektshme në luftën kundër të gjitha këtyre fatkeqësive".[187] Kjo gjë bëhet duke shfrytëzuar në mënyrë inteligjente burimet e mëdha të zhvillimit teknologjik.

189. Jemi ende larg një globalizimi të të drejtave më thelbësore të njeriut. Për këtë arsye, politika botërore nuk mund të mos

vendosë midis objektivave të saj kryesorë dhe të patjetërsueshëm atë të eliminimit efektiv të urisë. Në fakt, "kur spekulimi financiar ndikon në çmimin e ushqimeve duke i trajtuar atë si një mall çfarëdo, miliona persona vuajnë dhe vdesin urie. Nga ana tjetër, tonelata me ushqime hidhen poshtë. Ky përbën një skandal të vërtetë. Uria është kriminale, të ushqyerit është një e drejtë e patjetërsueshme".[188] Shumë herë, ndërsa zhytemi në diskutime semantike apo ideologjike, lejojmë ende që të ketë vëllezër dhe motra që vdesin urie dhe etje, pa çati mbi kokë apo pa pasur mundësi që të mjekohen. Së bashku me këto nevoja themelore të paplotësuara, trafikimi i qenieve njerëzore është një tjetër turp për njerëzimin që politika ndërkombëtare nuk duhet të vazhdojë ta tolerojë, përtej fjalimeve dhe qëllimeve të mira. Është minimumi i domosdoshëm.

Dashuria që integron dhe mbledh

190. Dashuria-bamirësi politike shprehet gjithashtu në hapjen ndaj të gjithëve. Sidomos ai që ka përgjegjësinë për të qeverisur, është i thirrur që të heqë dorë nga ajo që e pengon takimin dhe kërkon puqjen të paktën në

disa tema. Di të dëgjojë këndvështrimin e tjetrit, duke lejuar që secili të ketë hapësirën e vet. Me heqjen dorë dhe me durim një qeveritar mund të favorizojë krijimin e atij shumëfaqëshi të bukur ku të gjithë gjejnë një vend. Në këtë fushë nuk funksionojnë bisedimet e tipit ekonomik. Është diçka më shumë, është një shkëmbim ofertash në favor të së mirës së përbashkët. Duket një utopi naive, por nuk mund të heqim dorë nga ky objektiv shumë i lartë.

191. Ndërsa shohim se çdo lloj intolerance fondamentaliste dëmton marrëdhëniet midis personave, grupeve dhe popujve, le të angazhohemi për të jetuar dhe për t'u mësuar të tjerëve vlerën e respektit, dashurinë e aftë për të pranuar çdo ndryshim, përparësinë e dinjitetit të çdo qenie njerëzore ndaj çdo ideje, ndjenje, praktike dhe madje edhe mëkati të tij. Ndërsa në shoqërinë aktuale fanatizmat, logjikat e mbyllura dhe fragmentimi shoqëror e kulturor përhapen në shoqërinë e sotme, një politikan i mirë hedh hapin e parë me qëllim që të gjithë të dëgjohen. Është e vërtetë që ndryshimet krijojnë konflikte, por uniformiteti krijon asfiksi dhe bën që të gëlltitemi kulturalisht.

Të bëjmë të mundur që të mos jetojmë të mbyllur në një fragment realiteti.

192. Në këtë kontekst, dëshiroj të kujtoj se, së bashku me të Madhin Imam Ahmad Al-Tayyeb-in u kemi kërkuar "arkitektëve të politikës ndërkombëtare dhe të ekonomisë botërore që të angazhohen seriozisht për të përhapur kulturën e tolerancës, të bashkëjetesës dhe të paqes; për të ndërhyrë sa më shpejt që të jetë e mundur për ndalimin e derdhjes së gjakut të pafajshëm".[189] Dhe kur një politikë e caktuar mbjell urrejtje dhe frikë ndaj kombeve të tjera në emër të së mirës së vendit të vet, duhet të shqetësohemi, të reagojmë në kohë dhe menjëherë të ndryshojmë drejtim.

Më shumë pjellori, sesa rezultate

193. Ndërsa kryen këtë veprimtari të palodhshme, çdo politikan vazhdon të jetë një qenie njerëzore. Është i thirrur që ta jetojë dashurinë në marrëdhëniet e tij të përditshme ndërpersonale. Është një person dhe ka nevojë të kuptojë se "bota moderne, me përsosmërinë e vet teknike, priret ta racionalizojë gjithnjë e më shumë

plotësimin e dëshirave njerëzore, të klasifikuara dhe të ndara midis shërbimeve të ndryshme. Gjithnjë e më pak një person thirret me emrin e vet, gjithnjë e më pak do të trajtohet si person kjo qenie unike në botë, që ka zemrën e vet, vuajtjet e veta, problemet e veta, gëzimet dhe familjen e vet. Do të njihen vetëm sëmundjet e tij për t'i shëruar, mungesa e parave për t'ia siguruar ato, nevoja e tij për një shtëpi për t'i dhënë strehim, dëshira e tij për argëtim dhe zbavitje për t'i organizuar ato". Sidoqoftë, "ta duash më të parëndësishmin e qenieve njerëzore si vëlla, sikur në botë të mos kishte asnjë tjetër përveç tij, nuk është humbje kohe".[190]

194. Edhe në politikë ka vend për të dashur me butësi. "Çfarë është butësia? Është dashuria që bëhet e afërt dhe konkrete. Është një lëvizje që fillon nga zemra dhe arrin te sytë, veshët, duart.[…] Butësia është rruga që kanë ndjekur burrat dhe gratë më të guximshme dhe më të forta".[191] Në mes të veprimtarisë politike, "më të vegjlit, më të dobëtit, më të varfrit duhet të na zbusin: kanë "të drejtën" që të na rrëmbejnë shpirtin dhe zemrën. Po, ata janë vëllezërit tanë dhe si të tillë duhet t'i duam dhe t'i trajtojmë".[192]

195. Kjo na ndihmon që të pranojmë se jo gjithmonë bëhet fjalë për të arritur rezultate të mëdha, që nganjëherë nuk janë të mundshme. Në veprimtarinë politike duhet të mbahet mend se "pavarësisht nga pamja e jashtme, çdo njeri është jashtëzakonisht i shenjtë dhe meriton dashurinë. Si pasojë, nëse mund ta ndihmoj së paku një person që të ketë një jetë më të mirë, kjo e shfajëson dhurimin e jetës sime. Është diçka e mrekullueshme që të jesh popull besnik i Hyjit. Do ta arrijmë plotësinë kur t'i shembim muret dhe zemrat të na mbushen me fytyra e emra!".[193] Objektivat e mëdha të ëndërruara në strategji arrihen pjesërisht. Përtej kësaj, ata që duan dhe kanë reshtur së kuptuari politikën si një kërkim pushteti, "mund të jemi të sigurt se asnjë nga aktet tona të dashurisë apo aktet tona të shqetësimit të sinqertë për të tjerët nuk do të humbasë. Asnjë akt i vetëm dashurie ndaj Hyjit nuk do të humbasë, asnjë përpjekje bujare nuk është e kotë dhe nuk shkon kot asnjë çast durimi i përjetuar me dhimbje. E gjitha kjo qarkullon përmes botës, si një forcë jetësore".[194]

196. Nga ana tjetër, është një fisnikëri e madhe të jesh në gjendje të fillosh procese,

frytet e të cilave do të korren nga të tjerët, me shpresën e vendosur në forcën e fshehtë të së mirës që mbillet. Politika e mirë bashkon dashurinë me shpresën, me besimin në rezervat e të mirës që janë në zemrat e njerëzve, pavarësisht gjithçkaje. Prandaj, "jeta autentike politike, që themelohet mbi të drejtën e mbi një dialog të drejtë mes subjekteve, ripërtërihet me bindjen se çdo grua, çdo burrë e çdo brez përmbajnë në vetvete një premtim që mund të lëshojë energji të reja marrëdhënore, intelektuale, kulturore dhe shpirtërore".[195]

197. Parë në këtë mënyrë, politika është më fisnike sesa dukja, marketing-u apo format e ndryshme të *maquillage*-it mediatik. E gjithë kjo nuk mbjell asgjë përveç përçarjes, armiqësisë dhe një skepticizmi të zymtë të paaftë për t'iu apeluar një projekti të përbashkët. Duke menduar për të ardhmen, në disa momente të caktuara pyetjet duhet të jenë: "Për çfarë qëllimi? Ku synoj vërtet?". Sepse, pas disa vitesh, duke reflektuar për të kaluarën, pyetja nuk do të jetë: "Sa më kanë miratuar, sa më kanë votuar, sa kanë pasur një imazh pozitiv për mua?". Pyetjet, mbase të dhimbshme, do të jenë: "Me sa dashuri

e kam bërë punën time? Në çfarë i kam ndihmuar popujt që të përparojnë? Çfarë gjurme kam lënë në jetën e shoqërisë? Çfarë lidhjesh reale kam krijuar? Çfarë forcash pozitive kam liruar? Sa paqe shoqërore kam mbjellë? Çfarë kam prodhuar në vendin që më ishte besuar?”.

KAPITULLI I GJASHTË

DIALOGU DHE MIQËSIA SHOQËRORE

198. T'i afrohemi njëri-tjetrit, të shprehemi te njëri-tjetri, ta dëgjojmë njëri-tjetrin, ta shohim njëri-tjetrin, ta njohim njëri-tjetrin, të përpiqemi ta kuptojmë njëri-tjetrin, të kërkojmë pika takimi, e gjithë kjo përmblidhet në foljen "dialogoj". Për ta takuar dhe për ta ndihmuar njëri-tjetrin duhet të dialogojmë. Nuk ka nevojë që të themi se për çfarë na shërben dialogu. Na mjafton të mendojmë se çfarë do të ishte bota pa dialogun e durueshëm të kaq shumë njerëzve bujarë, që i kanë mbajtur të bashkuara familjet dhe bashkësinë. Dialogu këmbëngulës dhe i guximshëm nuk përbën lajm si përleshjet dhe konfliktet, e megjithatë pa u ndier e ndihmon botën për të jetuar më mirë, shumë më tepër sesa ne mendojmë.

Dialogu shoqëror drejt një kulture të re

199. Disa përpiqen që t'i ikin realitetit duke u strehuar në botë private, kurse disa të tjerë përballen me këtë realitet me një dhunë shkatërruese, por "midis indiferencës egoistike dhe protestës së dhunshme ekziston një mundësi që është gjithmonë e mundur: dialogu. Dialogu midis brezave, dialogu në popull, sepse të gjithë jemi popull, aftësia për të dhënë dhe për të marrë, duke mbetur të hapur ndaj të vërtetës. Një vend rritet kur pasuritë e tij të ndryshme kulturore dialogojnë në mënyrë ndërtuese: kultura popullore dhe ajo universitare, kultura rinore dhe ajo artistike, kultura teknologjike dhe ajo ekonomike, kultura familjare dhe ajo mediatike".[196]

200. Dialogu shpesh ngatërrohet me diçka shumë të ndryshme: një shkëmbim i etur i opinioneve në rrjetet sociale, shumë herë i orientuar nga një informacion mediatik jo gjithmonë i besueshëm. Janë thjesht monologje që ecin paralelisht, ndoshta duke iu imponuar vëmendjes së të tjerëve për shkak të toneve të tyre të larta dhe agresive.

Por monologjet nuk angazhojnë askënd, deri në atë pikë sa përmbajtjet e tyre jo rrallëherë janë oportuniste dhe kontradiktore.

201. Përhapja jehuese e fakteve dhe e referencave në media, në realitet shpesh mbyll mundësitë e dialogut, sepse lejon që të gjithë, me justifikimin e gabimeve të të tjerëve, të mbajnë të paprekura dhe pa ngjyrime idetë, interesat dhe zgjedhjet e veta. Mbizotëron zakoni i diskreditimit të shpejtë të kundërshtarit, duke i atribuar atij epitete poshtëruese, në vend që të bëhet një dialog i hapur dhe i respektueshëm, në të cilin kërkohet të arrihet një sintezë që shkon përtej. Më e keqja është se kjo gjuhë, e zakonshme në kontekstin mediatik të një fushate politike, është përgjithësuar kaq shumë sa të gjithë e përdorin atë çdo ditë. Debati shumë herë manipulohet nga interesa të caktuara që kanë një fuqi më të madhe dhe në mënyrë të pandershme përpiqen të përkulin opinionin publik në favor të tyre. Nuk po i referohem vetëm qeverisë aktuale, sepse kjo fuqi manipuluese mund të jetë ekonomike, politike, mediatike, fetare ose e çfarëdo lloji. Ndonjëherë justifikohet apo shfajësohet kur dinamika e saj përkon me

interesat vetjake ekonomike ose ideologjike, por herët a vonë kthehet kundër po këtyre interesave.

202. Mungesa e dialogut bën që askush, në sektorë të veçantë, të mos shqetësohet për të mirën e përbashkët, por të shqetësohet më tepër që të marrë avantazhet që ofron pushteti, ose, në rastin më të mirë, të diktojë mënyrën e vet të të menduarit. Kështu bisedimet kthehen thjesht në negociata, në mënyrë që secili të përvetësojë të gjitha fuqinë dhe avantazhet më të mëdha të mundshme, pa një kërkim të përbashkët që krijon të mirën e përbashkët. Heronjtë e të ardhmes do të jenë ata që do të jenë në gjendje ta thyejnë këtë logjikë jo të shëndetshme dhe do të vendosin të mbështesin me respekt një fjalë që është e mbushur me të vërtetën, përtej interesave personale. Dhashtë Zoti që këta heronj në mënyrë të heshtur të jenë duke dalë në dritë në zemrën e shoqërisë sonë.

Të ndërtojmë së bashku

203. Dialogu shoqëror autentik presupozon aftësinë për të respektuar këndvështrimin e tjetrit, duke pranuar

mundësinë që ai mund të përmbajë bindje ose interesa të ligjshme. Duke filluar nga identiteti i tij, tjetri ka diçka për të dhënë dhe është e dëshirueshme që të thellojë dhe të ekspozojë pozicionin e tij në mënyrë që debati publik të jetë edhe më i plotë. Kur një person ose grup është koherent me atë që mendon, u përmbahet fort vlerave dhe bindjeve të veta, si dhe zhvillon një mendim të vetin, në një mënyrë apo në një tjetër kjo gjë do t'i sjellë dobi shoqërisë. Por kjo gjë ndodh vetëm në masën në të cilën ky zhvillim bëhet në dialog dhe në hapje ndaj të tjerëve. Në fakt, "në një shpirt të vërtetë dialogu ushqehet aftësia për të kuptuar domethënien e asaj që thotë dhe bën tjetri, edhe pse ai nuk arrin ta paraqesë atë si bindje të vetën. Kështu bëhemi të sinqertë, nuk fshehim atë që besojmë, nuk reshtim së dialoguari, së kërkuari pika takimi dhe mbi të gjitha nuk reshtim së punuari dhe së angazhuari së bashku".[197] Diskutimi publik, nëse u jep vërtet hapësirë të gjithëve dhe as nuk manipulon e as nuk e fsheh informacionin, është një stimul i vazhdueshëm që mundëson arritjen e të vërtetës në mënyrë më të përshtatshme, ose të paktën në shprehjen e saj në mënyrë më të qartë. Parandalon që sektorët e ndryshëm

të marrin një pozicion, të rehatshëm dhe të vetëmjaftueshëm, në mënyrën e tyre të të parit të gjërave dhe në interesat e tyre të kufizuara. Mendojmë se "ndryshimet janë krijuese, krijojnë tension dhe përparimi i njerëzimit qëndron pikërisht në zgjidhjen e një tensioni".[198]

204. Sot ekziston bindja se, përveç zhvillimeve të specializuara shkencore, është i nevojshëm komunikimi midis disiplinave, pasi realiteti është një, megjithëse mund të trajtohet nga këndvështrime dhe me metodologji të ndryshme. Rreziku që përparimi shkencor të konsiderohet si qasja e vetme e mundshme për të kuptuar një aspekt të jetës, të shoqërisë dhe të botës nuk duhet të neglizhohet. Në vend të kësaj, një studiues që përparon me frytshmëri në analizën e tij dhe është gjithashtu i gatshëm që të njohë përmasa të tjera të realitetit që ai hulumton, falë punës së shkencave dhe të dijeve të tjera i hapet njohjes së realitetit në mënyrë më tërësore dhe të plotë.

205. Në këtë botë të globalizuar "mediat mund të na ndihmojnë që të ndihemi më afër njëri-tjetrit; që të na bëjnë të perceptojmë

një ndjenjë të ripërtërirë njësie të familjes njerëzore që na shtyn drejt solidaritetit dhe angazhimit serioz për një jetë më dinjitoze. […] Mund të na ndihmojnë në këtë, veçanërisht sot, kur rrjetet e komunikimit njerëzor kanë arritur zhvillime të padëgjuara. Në veçanti, interneti mund të ofrojë mundësi më të mëdha për takim dhe solidaritet midis të gjithëve, dhe kjo është një gjë e mirë, është një dhuratë nga Zoti".[199] Sidoqoftë, është e nevojshme që format aktuale të komunikimit të na orientojnë efektivisht drejt takimit bujar, kërkimit të sinqertë të së vërtetës së plotë, shërbimit, afërsisë me më të fundmit, angazhimit për të ndërtuar të mirën e përbashkët. Në të njëjtën kohë, siç kanë treguar Ipeshkvijtë e Australisë, "nuk mund ta pranojmë një botë dixhitale të projektuar për të shfrytëzuar dobësinë tonë dhe për të nxjerrë më të keqen prej njerëzve".[200]

Themeli i konsensusit

206. Relativizmi nuk është zgjidhja. Nën velin e një tolerance të supozuar, ai përfundon duke favorizuar faktin se vlerat morale interpretohen nga të fuqishmit sipas bindjeve të momentit. Në fund të fundit,

“nëse nuk ka të vërteta objektive dhe as parime të përcaktuara, përveç plotësimit të aspiratave personale dhe të nevojave të momentit […] nuk mund të mendojmë se do të mjaftojnë programet politike apo forca e ligjit […] kur është kultura ajo që prishet dhe nuk njihet më asnjë e vërtetë objektive apo parim universalisht i vlefshëm, ligjet do të kuptohen vetëm si diktime arbitrare dhe pengesa që duhen shmangur”.[201]

207. A është e mundur që t’i kushtojmë vëmendje të vërtetës, të kërkojmë të vërtetën që i përgjigjet realitetit tonë më të thellë? Çfarë është ligji pa bindjen, arritur përmes një ecjeje të gjatë reflektimi dhe urtie, që çdo qenie njerëzore është e shenjtë dhe e paprekshme? Me qëllim që një shoqëri të ketë një të ardhme, duhet të ketë zhvilluar një respekt të përzemërt për të vërtetën e dinjitetit njerëzor, të cilit i nënshtrohemi. Atëherë nuk do ta vrasim dikënd jo thjesht për të shmangur përbuzjen shoqërore dhe peshën e ligjit, por për bindje. Është një e vërtetë e domosdoshme, që e njohim me arsye dhe e pranojmë me ndërgjegje. Një shoqëri është fisnike dhe e respektuar, edhe sepse kultivon kërkimin e të vërtetës dhe

lidhjen e saj me të vërtetat themelore.

208. Është e nevojshme që të praktikohet demaskimi i modaliteteve të ndryshme të manipulimit, të shtrembërimit dhe të fshehjes së të vërtetës në sferat publike dhe private. Ajo që ne e quajmë "e vërteta" nuk është vetëm komunikimi i fakteve nga gazetaria. Para së gjithash është kërkimi i bazave më të forta që qëndrojnë në themel të zgjedhjeve dhe të ligjeve tona. Kjo nënkupton pranimin se inteligjenca njerëzore mund të tejkalojë interesat e momentit dhe të kuptojë disa të vërteta që nuk ndryshojnë, të cilat ishin të vërteta përpara nesh dhe do të jenë gjithmonë. Duke hulumtuar natyrën njerëzore, arsyeja zbulon vlera që janë universale, sepse rrjedhin prej saj.

209. Ndryshe, a nuk mund të ndodhë ndoshta që të drejtat themelore të njeriut, sot të konsiderohen të pakapërcyeshme dhe të mohohen nga pushtetarët, pasi kanë marrë "pëlqimin" e një popullsie të përgjumur dhe të frikësuar? As thjesht një konsensus midis popujve të ndryshëm, po aq i manipulueshëm, nuk do të ishte i mjaftueshëm. Kemi prova të bollshme për

gjithë të mirën që jemi në gjendje të bëjmë, megjithatë, në të njëjtën kohë, duhet të pranojmë aftësinë për shkatërrim që kemi brenda vetes sonë. A nuk është individualizmi indiferent dhe i pamëshirshëm, në të cilin kemi rënë, rezultat i përtacisë në kërkimin e vlerave më të larta, të cilat tejkalojnë nevojat momentale? Relativizmit i shtohet rreziku që të pushtetshmit ose më të aftit të jenë në gjendje të imponojnë një të vërtetë të supozuar. Megjithatë, "përballë normave morale që ndalojnë të keqen e brendshme, nuk ka privilegje ose përjashtime për askënd. Të jesh zot i botës ose "mjerani" i fundit në faqen e dheut nuk përbën asnjë ndryshim: përballë kërkesave morale jemi të gjithë absolutisht të barabartë".[202]

210. Ajo që na ndodh sot, duke na tërhequr drejt një logjike perverse dhe boshe, është se ekziston një asimilim i etikës dhe i politikës nga fizika. Nuk ekziston e mira dhe e keqja në vetvete, por vetëm një llogaritje e avantazheve dhe e disavantazheve. Zhvendosja e arsyes morale ka si pasojë që ligji nuk mund t'i referohet një konceptimi themelor drejtësie, por më tepër bëhet pasqyrë e ideve sunduese. Ka zënë fill

një degjenerim: një "rrafshim që shkon gjithnjë e më poshtë" përmes një konsensusi sipërfaqësor dhe kompromentues. Si rrjedhojë, triumfon logjika e forcës.

Konsensusi dhe e vërteta

211. Në një shoqëri pluraliste, dialogu është mënyra më e përshtatshme për të njohur atë që gjithmonë duhet të afirmohet dhe të respektohet, dhe që shkon përtej konsensusit të rastit. Po flasim për një dialog që duhet pasuruar dhe ndriçuar nga arsyeja, nga argumente racionale, nga një larmi perspektivash, nga kontribute njohurish dhe këndvështrimesh të ndryshme dhe që nuk përjashton bindjen se është e mundur të arrihen disa të vërteta themelore, të cilat duhet dhe do të duhej gjithmonë që të mbështeteshin. Pranimi se ekzistojnë disa vlera të përhershme, edhe pse jo gjithmonë është e lehtë që t'i njohësh, i jep fortësi dhe qëndrueshmëri një etike shoqërore. Edhe kur i kemi njohur dhe i kemi marrë përsipër falë dialogut dhe konsensusit, shohim se këto vlera themelore tejkalojnë çdo konsensus, i njohim si vlera që i tejkalojnë kontekstet tona dhe kurrë nuk mund të diskutohen.

Mund të rritet kuptimi ynë mbi domethënien dhe rëndësinë e tyre - dhe në këtë kuptim konsensusi është një realitet dinamik - por në vetvete ato vlerësohen si të qëndrueshme për domethënien e tyre të brendshme.

212. Nëse një gjë e caktuar mbetet gjithnjë e përshtatshme për funksionimin e duhur të shoqërisë, a nuk ndodh sepse pas saj ekziston një e vërtetë e përhershme, të cilën inteligjenca mund ta kuptojë? Në vetë realitetin e qenies njerëzore dhe të shoqërisë, në natyrën e tyre të thellë, ekzistojnë një varg strukturash bazë që mbështesin zhvillimin dhe mbijetesën e tyre. Prej aty rrjedhin nevoja të caktuara që mund të zbulohen falë dialogut, edhe pse ato nuk janë krijuar në kuptimin e ngushtë prej konsensusit. Fakti që disa norma janë të domosdoshme për vetë jetën shoqërore është një tregues i jashtëm se si ato janë diçka thelbësisht e mirë. Si pasojë, nuk është e nevojshme që të vësh interesin shoqëror dhe konsensusin kundër realitetit të një të vërtete objektive. Këto të trija mund të bashkohen në mënyrë harmonike kur, përmes dialogut, personat kanë guximin që t'i shkojnë deri në fund një çështjeje.

213. Nëse dinjiteti i të tjerëve duhet të respektohet në çdo situatë, kjo është për shkak se ne nuk e shpikim apo nuk e supozojmë këtë dinjitet, por sepse në të ka vërtet një vlerë më të lartë se gjërat materiale dhe rrethanat, që kërkon të trajtohen në një mënyrë tjetër. Që çdo qenie njerëzore zotëron një dinjitet të patjetërsueshëm është një e vërtetë që i përgjigjet natyrës njerëzore përtej çdo ndryshimi kulturor. Prandaj qenia njerëzore zotëron të njëjtin dinjitet të padhunueshëm në çdo epokë historike dhe askush nuk mund të ndihet i autorizuar nga rrethanat që ta mohojë këtë bindje apo të mos veprojë si rrjedhojë. Inteligjenca mund ta shqyrtojë realitetin e gjërave, përmes reflektimit, përvojës dhe dialogut, për të njohur në këtë realitet që e tejkalon bazën e disa kërkesave të përgjithshme morale.

214. Për agnostikët, ky themel mund të duket i mjaftueshëm për t'u dhënë një vlefshmëri universale të patundshme dhe të qëndrueshme parimeve etike themelore dhe të panegociueshme, në mënyrë që të parandalojë katastrofa të reja. Për besimtarët, natyra njerëzore, burim parimesh etike, është krijuar nga Hyji, i cili, në fund të fundit, u jep

një themel të shëndoshë këtyre parimeve.[203] Kjo nuk krijon një obsesion etik dhe as nuk i hap rrugën diktimit të asnjë sistemi moral, pasi këto parime themelore dhe universalisht të vlefshme mund të çojnë në krijimin e rregulloreve të ndryshme praktike. Prandaj gjithmonë mbetet një hapësirë për dialogun.

Një kulturë e re

215. "Jeta është arti i takimit, edhe pse në jetë ka shumë konflikte".[204] Shumë herë i kam ftuar njerëzit që të zhvillojnë një kulturë takimi, e cila shkon përtej dialektikave që vënë njërin kundër tjetrit. Është një sil jete që priret të formojë atë shumëfaqësh që ka shumë faqe, shumë brinjë, por të gjitha përbëjnë një njësi të pasur me nuanca, sepse "e tëra është më e madhe se një pjesë".[205] Shumëfaqëshi përfaqëson një shoqëri në të cilën ndryshimet bashkëjetojnë duke u integruar, duke u pasuruar dhe duke ndriçuar njëri-tjetrin, edhe pse kjo përfshin diskutime dhe mosbesim. Në fakt, nga të gjithë mund të mësojmë diçka, askush nuk është i padobishëm, askush nuk është i tepërt. Kjo nënkupton përfshirjen e periferive. Ata që jetojnë në to kanë një këndvështrim tjetër,

shohin aspekte të realitetit që nuk njihen nga qendrat e pushtetit ku merren vendimet më përcaktuese.

Takimi bërë kulturë

216. Fjala "kulturë" tregon diçka që ka depërtuar te populli, te bindjet e tij më të thella dhe në stilin e tij të jetës. Nëse flasim për një "kulturë" në popull, kjo është më shumë sesa një ide apo një abstragim. Përfshin dëshirat, entuziazmin dhe në fund një stil jete që karakterizon atë grup njerëzish. Prandaj, të flasësh për "kulturën e takimit" do të thotë se si popull kemi pasion dëshirën për t'u takuar, kërkimin e pikave të takimit, ndërtimin e urave, planifikimin e diçkaje që i përfshin të gjithë. Kjo është bërë një aspiratë dhe një stil jete. Subjekti i kësaj kulture është populli, jo një sektor i shoqërisë që synon ta mbajë pjesën tjetër të qetë me mjete profesionale dhe mediatike.

217. Paqja shoqërore arrihet me punë, është diçka artizanale. Do të ishte më e lehtë që të përmbaheshin liritë dhe ndryshimet me pak dinakëri dhe burime. Por kjo paqe do të ishte sipërfaqësore dhe e brishtë, jo fryt i një

kulture takimi që e mbështet atë. Integrimi i realiteteve të ndryshme është shumë më i vështirë dhe i ngadaltë, por është garancia e një paqeje reale dhe të qëndrueshme. Kjo nuk arrihet duke mbledhur së bashku të pastrit, pasi "edhe njerëzit që mund të kritikohen për gabimet e tyre kanë diçka për të ofruar që nuk duhet nënvleftësuar".[206] Dhe as nuk konsiston në një paqe që lind duke ua mbyllur gojën kërkesave shoqërore ose duke i shmangur ata që bëjnë shumë zhurmë, sepse nuk është "një konsensus në letër apo arritje e një paqeje kalimtare për një pakicë të kënaqur".[207] Ajo që ka rëndësi është të fillohen *procese* takimi, procese që mund të ndërtojnë një popull të aftë për të bashkuar dallimet. T'i armatosim fëmijët tanë me armët e dialogut! T'u mësojmë atyre luftën e mirë të takimit!

Shija për ta rinjohur tjetrin

218. Kjo gjë kërkon aftësinë e zakonshme për t'ia njohur tjetrit të drejtën për të qenë vetvetja dhe për të qenë i ndryshëm. Duke u nisur nga kjo njohje që është bërë kulturë, bëhet e mundur që të arrihet një pakt shoqëror. Pa këtë njohje, zhvillohen

mënyra të ndryshme që çojnë në humbjen e çdo domethënieje që ka tjetri, në bërjen e tij i parëndësishëm dhe në mosnjohjen e asnjë vlere që ai ka në shoqëri. Pas refuzimit të disa formave të dukshme të dhunës, shpesh fshihet një tjetër dhunë më e hollë: ajo e atyre që përçmojnë atë që është ndryshe, veçanërisht kur kërkesat e këtyre dëmtojnë në njëfarë mënyre interesat e tyre.

219. Kur një pjesë e shoqërisë pretendon të shijojë gjithçka që ofron bota, sikur të varfrit të mos ekzistonin, kjo në një moment të caktuar ka pasojat e saj. Injorimi i ekzistencës dhe i të drejtave të të tjerëve herët a vonë shkakton një formë dhune, shpesh të papritur. Ëndrrat e lirisë, të barazisë dhe të vëllazërisë mund të qëndrojnë në nivelin e formaliteteve, sepse nuk janë efektivisht për të gjithë. Prandaj, nuk bëhet fjalë vetëm për kërkimin e një takimi midis atyre që mbajnë forma të ndryshme të pushtetit ekonomik, politik ose akademik. Një takim real shoqëror vë në një dialog të vërtetë format e mëdha kulturore që përfaqësojnë shumicën e popullsisë. Shpesh propozimet e mira nuk bëhen nga sektorët më të varfëruar, sepse paraqiten me një veshje kulturore që

nuk është e tyre dhe me të cilën nuk mund të ndihen të identifikuar. Si pasojë, një pakt shoqëror realistik dhe përfshirës duhet të jetë gjithashtu një "pakt kulturor", i cili respekton dhe supozon botëkuptime, kultura dhe stile të ndryshme jete që bashkëekzistojnë në shoqëri.

220. Për shembull, popujt vendali nuk janë kundër përparimit, edhe pse kanë një ide të ndryshme për përparimin, shumë herë më humaniste se ajo e kulturës moderne të popujve të zhvilluar. Nuk është një kulturë e orientuar për avantazhin e atyre që janë në pushtet, të atyre që kanë nevojë të krijojnë një lloj parajse në tokë. Intoleranca dhe përbuzja ndaj kulturave popullore autoktone është një formë e vërtetë dhune, tipike e "etiçistëve" pa mirësi që jetojnë duke gjykuar të tjerët. Por asnjë ndryshim autentik, i thellë dhe i qëndrueshëm nuk është i mundur nëse nuk bëhet duke filluar nga kulturat e ndryshme, kryesisht të të varfërve. Një pakt kulturor presupozon që të hiqet dorë për të kuptuar identitetin e një vendi në mënyrë monolite dhe kërkon që ndryshueshmëria të respektohet duke i ofruar asaj mënyra promovimi dhe integrimi shoqëror.

221. Ky pakt kërkon gjithashtu që të pranohet mundësia e heqjes dorë nga diçka për të mirën e përbashkët. Askush nuk mund ta zotërojë krejt të vërtetën, as të kënaqë tërësinë e dëshirave të veta, sepse ky pretendim do të çonte në dëshirën për ta shkatërruar tjetrin duke mohuar të drejtat e tij. Kërkimi i një tolerance të rreme duhet t'i hapë rrugë realizmit dialogues, të atyre që besojnë se duhet t'u qëndrojnë besnikë parimeve të tyre, duke pranuar gjithashtu se edhe tjetri ka të drejtë të përpiqet të jetë besnik ndaj parimeve të veta. Është njohja e vërtetë e tjetrit, të cilën vetëm dashuria e bën të mundur dhe që do të thotë ta vësh veten në vendin e tjetrit për të zbuluar atë që është autentike, ose të paktën e kuptueshme, midis motivimeve dhe interesave të tij.

Rifitimi i mirësjelljes

222. Individualizmi konsumist shkakton shumë abuzime. Të tjerët bëhen thjesht pengesa për qetësinë e këndshme vetjake. Kështu përfundojnë t'i trajtojnë si bezdisje dhe agresiviteti rritet. Kjo theksohet dhe arrin në nivele acaruese në kohë krize, në situata katastrofike, në momente të vështira,

kur shfaqet shpirti i "të shpëtojë kush të mundet". Sidoqoftë, është ende e mundur që të bëhet zgjedhja për të ushtruar mirësinë. Ka njerëz që e bëjnë atë dhe bëhen yje në mes të errësirës.

223. Shën Pali përmendte një fryt të Shpirtit Shenjt me fjalën greke *chrestotes* (Gal 5,22), i cili shpreh një gjendje shpirtërore jo të ashpër, të palatuar, të fortë, por të mirë, të ëmbël, e cila mbështet dhe ngushëllon. Personi që e zotëron këtë cilësi i ndihmon të tjerët në mënyrë që ekzistenca e tyre të jetë më e durueshme, veçanërisht kur mbajnë peshën e problemeve, të urgjencave dhe të anktheve të tyre. Është një mënyrë për t'i trajtuar të tjerët që shfaqet në forma të ndryshme: si mirësi në sjellje, kujdes për të mos lënduar me fjalë ose gjeste, përpjekje për të lehtësuar peshën e të tjerëve. Përfshin "fjalë nxitjeje, që ngushëllojnë, japin force dhe shtytje", në vend të fjalëve "që poshtërojnë, trishtojnë, acarojnë dhe përbuzin".[208]

224. Mirësjellja është një lirim nga mizoria që ndonjëherë depërton në marrëdhëniet njerëzore, nga ankthi që nuk na lejon të mendojmë për të tjerët, nga urgjenca

e shpërqendruar që shpërfill faktin se edhe të tjerët kanë të drejtë të jenë të lumtur. Sot rrallëherë gjendet kohë dhe energji për t'u ndalur me qëllim që t'i trajtojmë mirë të tjerët, që t'u themi "me leje", "më fal", "faleminderit". Megjithatë, herë pas here shfaqet mrekullia e një personi të mirë, i cili lë mënjanë shqetësimet dhe urgjencat e veta për të kushtuar vëmendje, për të dhënë një buzëqeshje, për të thënë një fjalë nxitëse, për të krijuar një hapësirë dëgjimi në mes të kaq shumë shpërfilljeje. Kjo përpjekje, e jetuar çdo ditë, është e aftë që të krijojë atë bashkëjetesë të shëndetshme që kapërcen keqkuptimet dhe parandalon konfliktet. Praktika e mirësjelljes nuk është një detaj dytësor dhe as një qëndrim sipërfaqësor ose borgjez. Meqenëse presupozon vlerësim dhe respekt, kur bëhet kulturë në një shoqëri shndërron thellësisht stilin e jetës, marrëdhëniet shoqërore, mënyrën e diskutimit dhe të ballafaqimit të ideve. Lehtëson kërkimin e konsensusit dhe hap rrugë ku acarimi i shkatërron të gjitha urat.

KAPITULLI I SHTATË

RRUGËTIME PËR NJË TAKIM TË RI

225. Në shumë vende të botës ka nevojë për rrugëtime paqeje, që çojnë në shërimin e plagëve, ka nevoja për artizanë të paqes të gatshëm për të nisur procese shërimi dhe takimi të ripërtërirë me zgjuarsi dhe guxim.

T'ia fillosh nga e vërteta

226. Takim i ri nuk do të thotë kthim një minutë përpara konflikteve. Me kalimin e kohës të gjithë kemi ndryshuar. Dhimbja dhe kundërshtimet na kanë shndërruar. Për më tepër, nuk ka më hapësirë për diplomaci boshe, për shtirje, fjalime të dyfishta, fshehje, sjellje të mira që fshehin realitetin. Ata që janë ndeshur ashpër me njëri-tjetrin duhet të flasin duke nisur nga e vërteta, e qartë dhe lakuriqe. Kanë nevojë që të mësojnë të ushtrojnë një kujtesë pendese, e cila të jetë

e aftë për ta marrë përsipër të kaluarën dhe për ta liruar të ardhmen nga pakënaqësitë, konfuzionet dhe projeksionet e tyre. Vetëm nga e vërteta historike e fakteve mund të lindë përpjekja këmbëngulëse dhe e qëndrueshme për ta kuptuar njëri-tjetrin dhe për të provuar një sintezë të re për të mirën e të gjithëve. Realiteti është se "procesi i paqes është një angazhim që zgjat në kohë. Është një punë e durueshme në kërkim të së vërtetës dhe të drejtësisë, që nderon kujtimin e viktimave dhe që na hap, hap pas hapi, ndaj një shprese të përbashkët, që është më e fortë sesa hakmarrja".[209] Siç kanë pohuar Ipeshkvijtë e Kongos për një konflikt të përsëritur, "marrëveshjet e paqes në letër nuk do të jenë kurrë të mjaftueshme. Është e nevojshme që të shkohet më tej, duke përfshirë nevojën për të vërtetën në lidhje me zanafillën e kësaj krize të përsëritur. Populli ka të drejtë të dijë se çfarë ka ndodhur".[210]

227. Në fakt, "e vërteta është një shoqëruese e pandashme e drejtësisë dhe e mëshirës. Të trija së bashku janë thelbësore për ndërtimin e paqes dhe, nga ana tjetër, secila prej tyre parandalon që dy të tjerat të ndryshohen.[…] E vërteta nuk duhet të

çojë në hakmarrje, por në pajtim dhe falje. E vërteta ka të bëjë me faktin që t'u tregojmë familjeve të pikëlluara se çfarë u ka ndodhur të afërmve të tyre të zhdukur. E vërteta është të rrëfejmë se çfarë ka ndodhur me të miturit e rekrutuar nga dhunuesit. E vërteta ka të bëjë me njohjen e dhimbjes së grave që janë viktima të dhunës dhe të abuzimit.[...] Çdo dhunë e kryer ndaj një qenieje njerëzore është një plagë në mishin e njerëzimit; çdo vdekje e dhunshme na "zvogëlon" si njerëz. [...] Dhuna lind dhunë, urrejtja lind më shumë urrejtje dhe vdekja sjell një tjetër vdekje. Duhet ta thyejmë këtë zinxhir që duket i pashmangshëm".[211]

Arkitektura dhe artizanati i paqes

228. Rrugëtimi drejt paqes nuk kërkon homogjenizimin e shoqërisë, por me sigur na jep mundësinë që të punojmë së bashku. Mund të bashkojë shumë vetë në ndjekjen e kërkimeve të përbashkëta ku të gjithë përfitojnë. Përballë një qëllimi të përbashkët të bashkëndarë, mund të ofrohen propozime teknike dhe përvoja të ndryshme, si dhe të punohet për të mirën e përbashkët. Është e nevojshme që të përpiqemi t'i identifikojmë

mirë problemet që kalon një shoqëri në mënyrë që të pranojmë se ka mënyra të ndryshme për t'i parë vështirësitë dhe për t'i zgjidhur ato. Ecja drejt një bashkëjetese më të mirë kërkon gjithmonë njohjen e mundësisë që tjetri të sjellë një perspektivë legjitime - të paktën pjesërisht - diçka që mund të rivlerësohet, edhe kur personi mund të ketë gabuar ose ka vepruar keq. Në fakt, "tjetri kurrë nuk mund të përkufizohet vetëm për atë që ka thënë apo që ka bërë, por ai duhet të konsiderohet për premtimin që mbart në vetvete",[212] premtim që lë ndezur gjithmonë një dritë shprese.

229. Siç kanë mësuar Ipeshkvijtë e Afrikës së Jugut, pajtimi i vërtetë arrihet në mënyrë proaktive, "duke formuar një shoqëri të re të bazuar në shërbimin ndaj të tjerëve, sesa në dëshirën për t'i sunduar ata; një shoqëri të bazuar në bashkëndarjen e asaj që kemi me të tjerët, sesa në luftën egoiste të secilit për t'u pasuruar sa më shumë; një shoqëri në të cilën vlera e të qëndruarit së bashku si qenie njerëzore është sigurisht më e rëndësishme sesa çdo grup i vogël, qoftë familja, kombi, etnia apo kultura".[213] Ipeshkvijtë e Koresë së Jugut kanë treguar

se një paqe autentike "mund të arrihet vetëm kur luftojmë për drejtësi përmes dialogut, duke ndjekur pajtimin dhe zhvillimin e ndërsjellë".[214]

230. Angazhimi i mundimshëm për të kapërcyer atë që na ndan pa humbur identitetin e secilit presupozon që të mbetet e gjallë te të gjithë një ndjenjë themelore përkatësie. Në fakt, "shoqëria jonë fiton kur çdo person, çdo grup shoqëror, ndihet vërtet si në shtëpinë e tij. Në një familje, prindërit, gjyshërit dhe fëmijët janë të shtëpisë; askush nuk përjashtohet. Nëse dikush ka një vështirësi, qoftë edhe të madhe, edhe kur "ai e ka kërkuar vetë atë", të tjerët i vijnë në ndihmë, e mbështesin atë; dhimbja e tij u përket të gjithëve.[...] Në familje, të gjithë kontribuojnë për projektin e përbashkët, të gjithë punojnë për të mirën e përbashkët, por pa asgjësuar individin; përkundrazi, ata e mbështesin atë, ata e promovojnë atë. Grinden, por ka diçka që nuk lëviz: lidhja familjare. Grindjet familjare më vonë bëhen pajtime. Gëzimet dhe hidhërimet e secilit bëhen të të gjithëve. Kjo do të thotë të jesh familje! Sikur të arrinim që ta shihnim kundërshtarin politik ose fqinjin me të njëjtët

sy me të cilët i shohim fëmijët, gratë, burrat, baballarët dhe nënat. Sa bukur do të ishte! A e duam shoqërinë tonë apo mbetet diçka e largët, diçka anonime, që nuk na përfshin, nuk na prek, nuk na angazhon?”.[215]

231. Shumë herë ekziston një nevojë e madhe për të negociuar dhe për të zhvilluar kështu rrugëtime konkrete paqeje. Sidoqoftë, proceset konkrete të një paqeje të qëndrueshme janë mbi të gjitha shndërrimet artizanale bërë nga popujt, ku çdo person mund të jetë një tharm i efektshëm me stilin e tij të jetës së përditshme. Shndërrimet e mëdha nuk bëhen në tavolinë. Prandaj, “secili luan një rol themelor, në një projekt të vetëm krijues, për të shkruar një faqe të re të historisë, një faqe plot shpresë, plot paqe, plot pajtim”.[216] Ekziston një “arkitekturë” e paqes, ku ndërhyjnë institucionet e ndryshme të shoqërisë, sipas kompetencës së vet, por ekziston edhe një “artizanat” i paqes që na përfshin të gjithëve. Duke u nisur nga procese të ndryshme paqeje që po zhvillohen në vende të ndryshme të botës, “kemi mësuar se këto mënyra paqëtimi, të

përparësisë së arsyes ndaj hakmarrjes dhe të një harmonie delikate midis politikës e ligjit, nuk mund t'i shmangin rrugëtimet e njerëzve. Nuk mjafton hartimi i kornizave normative dhe i marrëveshjeve institucionale midis grupeve politike ose ekonomike vullnetitmirë.[...] Po ashtu, është gjithmonë e çmuar përfshirja në proceset tona të paqes e përvojës së sektorëve që, në shumë raste, janë bërë të padukshëm, me qëllim që të jenë bashkësitë ato që ngjyrosin proceset e kujtesës kolektive".[217]

232. Nuk ka pikë përfundimtare në ndërtimin e paqes sociale të një vendi, përkundrazi bëhet fjalë për "një detyrë që nuk jep pushim dhe që kërkon angazhimin e të gjithëve. Punë që na kërkon të mos dorëzohemi në përpjekjen për ta ndërtuar njësinë e kombit dhe, pavarësisht pengesave, ndryshimeve dhe qasjeve të ndryshme se si të arrihet bashkëjetesa paqësore, të vazhdojmë në luftën për të nxitur kulturën e takimit, e cila kërkon që të vendoset në qendër të të gjitha veprimeve politike, shoqërore dhe ekonomike personi njerëzor, dinjiteti i tij më i lartë dhe respekti për të mirën e përbashkët. Kjo përpjekje na bëftë që t'i ikim çdo tundimi

për hakmarrje dhe kërkimi të interesave të veçanta dhe afatshkurtra”.[218] Demonstratat e dhunshme publike, nga të dy palët, nuk ndihmojnë në gjetjen e rrugëdaljeve. Mbi të gjitha sepse, siç kanë vërejtur mirë Ipeshkvijtë e Kolumbisë, kur inkurajohen “mobilizime qytetarësh, origjina dhe objektivat e tyre nuk janë gjithmonë të qarta, ekzistojnë disa forma manipulimi politik dhe ndeshen disa përvetësime në favor të interesave të veçanta”.[219]

Sidomos me të më fundit

233. Promovimi i miqësisë shoqërore nënkupton jo vetëm afrimin midis grupeve të largëta shoqërore për shkak të një periudhe historike konflikti, por edhe kërkimin e një takimi të ripërtërirë me sektorët më të varfëruar dhe më të cenueshëm. Paqja “nuk është vetëm mungesa e luftës, por angazhimi i palodhur - veçanërisht i atyre që kanë një detyrë me përgjegjësi më të madhe - për ta njohur, për ta garantuar dhe për ta rindërtuar konkretisht dinjitetin, shpesh të harruar ose të shpërfillur, të vëllezërve tanë, në mënyrë që të ndihen protagonistë të fatit të kombit të tyre”.[220]

234. Shpesh më të fundmit e shoqërisë janë fyer me përgjithësime të padrejta. Nëse ndonjëherë më të varfrit dhe më të skartuarit reagojnë me qëndrime që duken antisociale, është e rëndësishme që të kuptohet se në shumë raste këto reagime varen nga një histori përbuzjeje dhe mungese përfshirjeje shoqërore. Siç kanë mësuar Ipeshkvijtë e Amerikës Latine, "vetëm afërsia që na bën miq na mundëson t'i çmojmë thellësisht vlerat e të varfërve të sotëm, dëshirat e tyre të ligjshme dhe mënyrën e tyre specifike të të jetuarit të fesë. Zgjedhja për të varfrit duhet të na çojë te miqësia me të varfrit".[221]

235. Ata që pretendojnë të sjellin paqe në një shoqëri nuk duhet të harrojnë se pabarazia dhe mungesa e zhvillimit tërësor njerëzor nuk mundësojnë krijimin e paqes. Në fakt, "pa mundësi të barabarta format e ndryshme të agresionit dhe të konfliktit do të gjejnë një terren pjellor për rritje dhe do të shpërthejnë patjetër. Kur një shoqëri, qoftë ajo lokale, kombëtare apo globale është e gatshme që të lërë një pjesë të vetes në periferi, asnjë program politik ose përpjekje e forcave të rendit apo të sigurimit të shtetit nuk mund të garantojë qetësinë në mënyrë të

pakufizuar”.[222] Nëse bëhet fjalë për të filluar nga e para, gjithmonë do të fillohet nga të fundmit.

Vlera dhe domethënia e faljes

236. Disa preferojnë të mos flasin për pajtim, sepse besojnë se konflikti, dhuna dhe thyerjet janë pjesë e funksionimit normal të një shoqërie. Në fakt, në çdo grup njerëzor ka lufta për pushtet pak a shumë të mprehta midis sektorëve të ndryshëm. Të tjerë argumentojnë se pranimi i faljes është i barabartë me heqjen dorë nga hapësira jote, që të tjerët ta mbizotërojnë situatën. Prandaj, besojnë se është më mirë të mbash një lojë pushtetesh, që mundëson ruajtjen e një ekuilibri forcash midis grupeve të ndryshme. Të tjerë besojnë se pajtimi është një gjë për të dobëtit, të cilët nuk janë të aftë për një dialog të thellë dhe prandaj zgjedhin t’u ikin problemeve duke fshehur padrejtësitë: të paaftë për t’u përballur me problemet, ata preferojnë një paqe sipërfaqësore.

Konflikti i pashmangshëm

237. Falja dhe pajtimi janë tema me

rëndësi të madhe në krishterizëm dhe, në mënyra të ndryshme, në besimet e tjera fetare. Rreziku qëndron në moskuptimin e duhur të bindjeve të besimtarëve dhe paraqitjen e tyre në mënyrë të tillë që ato ushqejnë fatalizmin, inercinë apo padrejtësinë, ose, nga ana tjetër, intolerancën dhe dhunën.

238. Jezu Krishti kurrë nuk ka bërë thirrje për dhunë apo intolerancë. Haptazi dënonte përdorimin e forcës për t'iu diktuar të tjerëve: "Ju e dini se sunduesit zotërojnë mbi popujt e vet dhe princat e tyre i mbajnë nën pushtet. Porse, ndërmjet jush nuk duhet të jetë ashtu" (Mt 20,25-26). Nga ana tjetër, Ungjilli kërkon që të falim "shtatëdhjetë herë shtatë herë" (Mt 18,22) dhe jep shembullin e shërbëtorit të pamëshirshëm, i cili u fal, por nga ana tjetër nuk ishte në gjendje t'i falte të tjerët (krh. Mt 18,23-35).

239. Nëse lexojmë tekste të tjera të Besëlidhjes së Re, mund të vërejmë se në fakt bashkësitë e para, të zhytura në një botë pagane plot korrupsion dhe devijime, jetonin një ndjenjë durimi, tolerance, mirëkuptimi. Disa tekste janë shumë të qarta në lidhje me këtë: na ftojnë që t'i qortojmë

kundërshtarët tanë me ëmbëlsi (krh. 2Tim 2,25). Na porosisin që "të mos fyejnë askënd, t'u shmangen grindjeve, të lëshojnë pe, të tregojnë butësi të vazhdueshme kundrejt të gjithë njerëzve. Sepse edhe ne dikur ishim të pamendë" (Tit 3,2-3). Libri i Veprave të Apostujve pohon se nxënësit, të përndjekur nga disa autoritete, "gëzuan favorin e të gjithë popullit" (krh. Vap 2,47; 4,21.33; 5,13).

240. Sidoqoftë, kur reflektojmë mbi faljen, paqen dhe harmoninë shoqërore, hasim në një shprehje të Krishtit që na befason: "Mos mendoni se erdha të sjell paqen mbi tokë. Nuk erdha të sjell paqen, po shpatën. Sepse erdha të ndaj djalin prej të atit, vajzën prej s'ëmës, të renë prej vjehrrës, Njeriu do t'i ketë armiq familjarët e vet" (Mt 10,34-36). Është e rëndësishme që këtë shprehje ta vendosim në kontekstin e kapitullit ku edhe ndodhet. Është e qartë se aty bëhet fjalë për besnikërinë ndaj zgjedhjes së bërë, pa turp, edhe pse një gjë e tillë mund të shkaktojë kundërshti, madje edhe nëse të dashurit tanë e kundërshtojnë këtë zgjedhje. Prandaj, fjalë të tilla nuk na ftojnë që të kërkojmë konflikte, por thjesht të durojnë konfliktin e pashmangshëm, me qëllim që respekti

njerëzor të mos çojë në pabesnikëri, në respektim të një paqeje të supozuar familjare ose shoqërore. Shën Gjon Pali II ka pohuar se Kisha "nuk ka ndërmend që të dënojë çdo dhe çfarëdolloj forme konflikti shoqëror: Kisha e di mirë se në histori lindin në mënyrë të pashmangshme konflikte interesash midis grupeve të ndryshme shoqërore dhe përpara tyre të krishterët shpesh duhet të marrin një qëndrim me vendosmëri dhe koherencë".[223]

Luftërat legjitime dhe falja

241. Nuk bëhet fjalë që të propozohet një falje duke hequr dorë nga të drejtat tona përpara një të pushtetshmi të korruptuar, një krimineli ose dikujt që degradon dinjitetin tonë. Jemi të thirrur që t'i duam të gjithë, pa përjashtim, por të duam një shtypës nuk do të thotë ta lejojmë atë që të vazhdojë të jetë i tillë; dhe as që t'i lëmë të kuptojë se ajo që bën është e pranueshme. Përkundrazi, mënyra e mirë për ta dashur atë është të përpiqemi në mënyra të ndryshme për ta bërë atë të ndalojë shtypjen e tij, është t'i heqim atë pushtet që nuk di ta përdorë dhe që e deformon atë si qenie njerëzore. Të falësh nuk do të thotë t'i lejosh të tjerët që të vazhdojnë të shkelin

dinjitetin tonë dhe atë të të tjerëve, apo të lejojmë që një kriminel të vazhdojë të kryejë krime. Kush vuan prej padrejtësisë duhet t'i mbrojë me forcë të drejtat e veta dhe të familjes së vet, pikërisht sepse duhet të ruajë dinjitetin që i është dhënë, dinjitet ky që Zoti e do. Nëse një kriminel më ka dëmtuar mua ose njërin prej familjarëve të mi, asgjë nuk më ndalon që të kërkoj drejtësi dhe të angazhohem që ai person - ose kushdo tjetër - të mos më dëmtojë përsëri ose të bëjë të njëjtën gjë me të tjerët. Më takon mua që ta bëj këtë gjë dhe falja jo vetëm që nuk e anullon këtë domosdoshmëri, por e kërkon atë.

242. E rëndësishme është që këtë gjë të mos e bëjmë për të ushqyer një inat që lëndon shpirtin e personit dhe shpirtin e popullit tone apo prej nevojës së pashëndetshme për ta shkatërruar tjetrin, duke i dhënë fill një serie hakmarrjesh. Askush nuk e arrin paqen e brendshme dhe as nuk pajtohet me jetën në këtë mënyrë. E vërteta është se "asnjë familje, asnjë grup fqinjësh, asnjë etni dhe aq më pak një vend nuk ka të ardhme, nëse motori që i bashkon, i mbledh dhe i mbulon dallimet është hakmarrja dhe urrejtja. Nuk

mund të biem dakord dhe të bashkohemi për t'u hakmarrë, për t'i bërë të njëjtën gjë atij që ka qenë i dhunshëm ndaj nesh, për të planifikuar raste shpagimi nën forma në dukje ligjore".[224] Kështu nuk fitojmë asgjë dhe me kalimin e kohës humbasim gjithçka.

243. Sigurisht, "nuk është i lehtë kapërcimi i trashëgimisë së hidhur të padrejtësive, të armiqësive dhe të mosbesimit që lë pas konflikti. Kjo gjë mund të arrihet vetëm duke e kapërcyer të keqen me të mirë (krh. Rom 12,21) dhe duke kultivuar ato virtyte që promovojnë pajtimin, solidaritetin dhe paqen".[225] Në këtë mënyrë, "ai që e lë të rritet brenda vetes së vet, mirësia i jep atij një ndërgjegje të qetë, një gëzim të thellë edhe në mes të vështirësive dhe keqkuptimeve. Edhe përpara shkeljeve të pësuara, mirësia nuk është dobësi, por forcë e vërtetë, e aftë që të heqë dorë nga hakmarrja".[226] Duhet të pranojmë se në jetën tonë "gjykimi i rreptë që kam në zemrën time kundër vëllait apo motrës sime, ajo plagë e pamjekuar, ajo e keqe e pafalur, ai inat i fshehtë që do të më bëjë vetëm keq, është një copë lufte që mbart përbrenda, është një vatër zjarri në zemër, që duhet shuar, me qëllim që të mos ndizet zjarr".[227]

Tejkalimi i vërtetë

244. Kur konfliktet nuk zgjidhen, por fshihen ose varrosen në të kaluarën, ekzistojnë heshtje që mund të nënkuptojnë bërjen bashkëpunëtor në gabime dhe mëkate të rënda. Kurse pajtimi i vërtetë nuk i ikën konfliktit, por arrihet *në* konflikt, duke e kapërcyer atë përmes dialogut dhe negociatave transparente, të sinqerta dhe të durueshme. Lufta midis sektorëve të ndryshëm, "kur qëndron larg veprimeve të armiqësisë dhe të urrejtjes së ndërsjellë, pak nga pak shndërrohet në një diskutim të ndershëm, bazuar në kërkimin e drejtësisë".[228]

245. Shumë herë kam propozuar "pranimin e një parimi të domosdoshëm për ndërtimin e miqësisë shoqërore: që është postulati se uniteti është më i madh se konflikti [...] Kjo s'do të thotë të synosh sinkretizmin, apo përvetësimin e njërit ose tjetrit, por një zgjidhje që ndodh në një plan më të lartë dhe e ruan atë që është e vlefshme dhe e dobishme në të dyja anët".[229] E dimë mirë se "sa herë që, si individë dhe bashkësi, mësojmë të synojmë më lart se vetja jonë dhe se interesat tona të veçanta, mirëkuptimi dhe

angazhimi i ndërsjellë shndërrohen [...] në një fushë ku konfliktet, tensionet dhe ata që në të kaluarën do të ishin konsideruar të kundërt, mund të arrijnë një njësi shumëformëshe që krijon jetë të re”.[230]

KUJTESA

246. Nga ata që kanë vuajtur shumë në mënyrë të padrejtë dhe mizore, nuk duhet të kërkohet një lloj “faljeje shoqërore”. Pajtimi është një çështje personale dhe askush nuk mund t’ia imponojë atë tërësisë së një shoqërie, edhe kur ajo ka detyrë që ta promovojë atë. Në sferën rreptësisht personale, me një vendim të lirë dhe bujar, dikush mund të heqë dorë nga kërkesa për ndëshkim (krh. Mt 5,44-46), megjithëse shoqëria dhe drejtësia e saj në mënyrë legjitime priren prej saj. Sidoqoftë, nuk është e mundur të dekretohet një “pajtim i përgjithshëm”, duke pretenduar që të mbyllen plagët me dekret apo të mbulohen padrejtësitë me një mantel harrese. Kush mund t’ia japë vetes të drejtën për të falur në emër të të tjerëve? Është prekëse kur sheh aftësinë për falje të disa personave që kanë ditur të shkojnë përtej dëmit të pësuar, por

është gjithashtu njerëzore t'i kuptojmë ata që nuk mund ta bëjnë këtë gjë. Në çdo rast, ajo që nuk duhet të propozohet kurrë është harrimi.

247. *Shoah*-u nuk duhet të harrohet. Është "simboli se ku mund të arrijë ligësia e njeriut kur, i nxitur nga ideologji të rreme, harron dinjitetin themelor të çdo personi, i cili meriton respekt absolut pavarësisht popullit të cilit i përket dhe fesë që dëshmon".[231] Duke e kujtuar atë, nuk mund të mos përsëris këtë lutje: "Kujtohu për ne në mëshirën tënde. Na jep hirin që të turpërohemi për atë që, si njerëz, kemi qenë në gjendje të bëjmë, që të turpërohemi për këtë idhujtari maksimale, që kemi përçmuar dhe shkatërruar mishin tonë, atë që ti ke bërë nga balta, atë që ti gjallërove me frymën tënde të jetës. Kurrë më, o Zot, kurrë më!".[232]

248. Nuk duhet të harrohen bombat atomike të Hiroshimës dhe të Nagasakit. Edhe një herë "kujtoj këtu të gjitha viktimat dhe përkulem para forcës dhe dinjitetit të atyre që, pasi u kanë mbijetuar atyre momenteve të para, kanë duruar në trupat e tyre për shumë vite vuajtjet më të mëdha dhe,

në mendjet e tyre, farat e vdekjes që kanë vazhduar të konsumojnë energjinë e tyre jetësore. […] Nuk mund të lejojmë që brezat e tanishëm dhe të ardhshëm ta humbasin kujtimin e asaj që ka ndodhur, atë kujtim që është garanci dhe stimul për të ndërtuar një të ardhme më të drejtë dhe vëllazërore”.[233] Dhe as nuk duhet të harrojmë përndjekjet, trafikimin e skllevërve dhe masakrat etnike që kanë ndodhur dhe po ndodhin në vende të ndryshme, si dhe shumë fakte të tjera historike që na bëjnë të kemi turp se jemi njerëz. Ato duhet të kujtohen gjithmonë, çdo herë, pa u lodhur dhe pa u anestetizuar.

249. Sot është e lehtë që të biem nën tundimin për ta kthyer faqen, duke thënë se ka kaluar një kohë e gjatë dhe se duhet të shohim përpara. Jo, për hir të Zotit! Pa kujtesë kurrë nuk ecet përpara, nuk mund të rritemi pa një kujtesë të plotë dhe të ndritshme. Kemi nevojë që ta ruajmë “flakën e ndërgjegjes kolektive, duke u dëshmuar brezave pasardhës tmerrin e asaj që ka ndodhur”, që “të rizgjojë dhe të ruajë në këtë mënyrë kujtesën e viktimave, me qëllim që ndërgjegjja njerëzore të bëhet gjithnjë e më e fortë përpara çdo vullnese sundimi dhe

shkatërrimi”.[234] Kanë nevojë vetë viktimat - persona, grupe shoqërore ose kombe - për të mos iu nënshtruar logjikës që çon në justifikimin e raprezaljeve dhe të çdo dhune në emër të së keqes së madhe të pësuar. Për këtë arsye, nuk po i referohem vetëm kujtimit të tmerreve, por edhe kujtimit të atyre që, në mes të një konteksti të helmuar dhe të korruptuar, kanë qenë të aftë të rimarrin dinjitetin e tyre dhe me gjeste të vogla apo të mëdha kanë zgjedhur solidaritetin, faljen, vëllazërim. Na bën mirë ta kujtojmë të mirën.

Falje pa harresë

250. Falja nuk nënkupton harrimin. Kur ka diçka që në asnjë mënyrë nuk mund të mohohet, të relativizohet apo të fshihet, ne mund të falim gjithsesi. Kur ka diçka që nuk duhet të tolerohet, të justifikohet apo të shfajësohet, ne mund të falim gjithsesi. Kur ka diçka që për asnjë arsye nuk duhet t’ia lejojmë vetes që ta harrojmë, ne mund të falim gjithsesi. Falja e lirë dhe e sinqertë është një madhështi që pasqyron pafundësinë e faljes hyjnore. Nëse falja është falas, atëherë mund të falen edhe ata që e kanë të vështirë të pendohen dhe nuk janë në gjendje

të kërkojnë falje.

251. Ata që falin me të vërtetë nuk harrojnë, por heqin dorë nga të qenit të mbizotëruar nga po ajo forcë shkatërruese që i ka dëmtuar ata. Thyejnë rrethin vicioz, ndalojnë përparimin e forcave të shkatërrimit. Vendosin që të mos vazhdojnë të fusin në shoqëri energjinë e hakmarrjes, e cila herët a vonë përfundon duke rënë edhe një herë mbi vetë ata. Në fakt, hakmarrja nuk e shuan kurrë vërtet pakënaqësinë e viktimave. Ka krime aq të tmerrshme dhe mizore, aq sa t'i bësh të vuajnë ata që i kryejnë ato është e padobishme për të ndier se krimi është shlyer; nuk do të mjaftonte as vrasja e kriminelit dhe nuk mund të gjenden as tortura të krahasueshme me atë që viktima mund të ketë pësuar. Hakmarrja nuk zgjidh asgjë.

252. Nuk po flasim as për mosndëshkim. Por drejtësia kërkohet në mënyrë të përshtatshme vetëm për dashuri ndaj vetë drejtësisë, për respekt ndaj viktimave, për të parandaluar krime të reja dhe për të mbrojtur të mirën e përbashkët, jo si një shfrim i pretenduar i zemërimit të dikujt.

Falja është pikërisht ajo që na mundëson të kërkojmë drejtësi pa rënë në rrethin vicioz të hakmarrjes ose të padrejtësisë së harrimit.

253. Kur ka pasur padrejtësi nga të dyja palët, duhet të pranohet me çiltërsi se mund të mos jenë njëlloj të rënda apo mund të mos jenë të krahasueshme. Dhuna e ushtruar nga strukturat dhe pushteti i shtetit nuk është në të njëjtin nivel me dhunën e grupeve të veçanta. Në çdo rast, nuk mund të pritet që të përmenden vuajtjet e padrejta vetëm të njërës palë. Siç kanë mësuar Ipeshkvijtë e Kroacisë, "ne i detyrohemi të njëjtin respekt çdo viktime të pafajshme. Nuk mund të ketë dallime etnike, konfesionale, kombëtare apo politike".[235]

254. I lutem Zotit "që t'i përgatisë zemrat tona për takimin me vëllezërit përtej faktin që kemi ide, gjuhë, kulturë dhe besim fetar të ndryshëm; që ta lyejë krejt qenien tonë me vajin e mëshirës së tij, që shëron plagët e gabimeve, të keqkuptimeve, të mosmarrëveshjeve; hirin për të na dërguar me përvujtëri dhe butësi në shtigjet angazhuese, por të frytshme, të kërkimit të paqes".[236]

255. Ekzistojnë dy situata ekstreme që mund të paraqiten si zgjidhje në rrethana veçanërisht dramatike, pa menduar se janë përgjigje të rreme, që nuk i zgjidhin problemet që pretendojnë t'i tejkalojnë dhe që në fund vetëm shtojnë faktorë të rinj shkatërrimi në strukturën e shoqërisë kombëtare dhe botërore. Bëhet fjalë për luftën dhe dënimin me vdekje.

Padrejtësia e luftës

256. "Gënjeshtra është në zemrën e atyre që mendojnë të keqen, kurse gëzojnë ata që këshillojnë paqen" (Fu 12,20). Sidoqoftë, ka nga ata që e kërkojnë zgjidhjen te lufta, e cila shpesh ushqehet "prej degjenerimit të marrëdhënieve, prej ambicjeve hegjemonike, prej shpërdorimit të pushtetit, prej frikës ndaj tjetrit dhe prej të ndryshmes, që shihet si pengesë".[237] Lufta nuk është një fantazmë e të kaluarës, por është bërë një kërcënim i vazhdueshëm. Bota po ndesh gjithnjë e më shumë vështirësi në rrugën e ngadaltë të paqes, që kishte ndërmarrë dhe që po fillonte të jepte fryte.

257. Meqenëse janë duke u krijuar përsëri kushtet për shumimin e luftërave, kujtoj se "lufta është mohimi i të gjitha të drejtave dhe një sulm dramatik ndaj mjedisit. Nëse duam një zhvillim të mirëfilltë njerëzor tërësor për të gjithë, duhet të vazhdojmë pa u lodhur në angazhimin për ta shmangur luftën midis kombeve dhe popujve. Për këtë qëllim, duhet të sigurohet sundimi i padiskutueshëm i të drejtës dhe kërkimi i palodhshëm i negociatave, i shërbimeve të mira dhe i arbitrazhit, siç propozohet nga *Karta e Kombeve të Bashkuara*, një normë e vërtetë themelore juridike".[238] Dua të theksoj se 75 vitet e Kombeve të Bashkuara dhe përvoja e 20 viteve të para të këtij mijëvjeçari tregojnë se zbatimi i plotë i standardeve ndërkombëtare është me të vërtetë i efektshëm dhe se mosrespektimi i tyre është i dëmshëm. *Karta e Kombeve të Bashkuara*, respektuar dhe zbatuar me transparencë dhe sinqeritet, është një pikë referimi e detyrueshme drejtësie dhe një mjet paqeje. Por kjo kërkon që të mos maskohen qëllimet e paligjshme dhe të mos vendosen interesat e veçanta të një vendi ose grupi mbi të mirën e përbashkët botërore. Nëse norma konsiderohet një mjet për t'u

përdorur kur është i favorshëm dhe për t'u shmangur kur nuk është i tillë, shpërthejnë forca të pakontrollueshme që i dëmtojnë rëndë shoqëritë, më të dobëtit, vëllazërinë, mjedisin dhe trashëgiminë kulturore, me humbje të pariparueshme për bashkësinë globale.

258. Kjo është mënyra se si dikush lehtësisht zgjedh luftën duke paraqitur të gjitha llojet e justifikimeve në dukje humanitare, mbrojtëse ose parandaluese, duke përdorur gjithashtu manipulimin e informacionit. Faktikisht, në dekadat e fundit të gjitha luftërat kanë pretenduar se kanë një "justifikim". *Katekizmi i Kishës Katolike* flet për mundësinë e një *mbrojtjeje* të ligjshme përmes forcës ushtarake, me premisën e demonstrimit se ekzistojnë disa "kushte rigoroze të legjitimitetit moral". [239] Sidoqoftë, bihet lehtë në një interpretim shumë të gjerë të kësaj të drejte të mundshme. Kështu justifikohen padrejtësisht sulmet "parandaluese" ose veprimet luftarake që me lehtësi çojnë në "të këqija dhe çrregullime më serioze, sesa e keqja që duhet eliminuar". [240] Puna është se, duke filluar prej zhvillimit të armëve bërthamore, kimike e biologjike

dhe të mundësive të stërmëdha dhe në rritje të ofruara nga teknologjitë e reja, i është dhënë luftës një fuqi e pakontrollueshme shkatërruese, që godet shumë civilë të pafajshëm. Në të vërtetë, "kurrë njerëzimi nuk ka pasur kaq pushtet mbi vetveten dhe asgjë nuk garanton se ai do ta përdorë mirë këtë pushtet".[241] Prandaj, nuk mund ta mendojmë më luftën si një zgjidhje, meqë rreziqet sipas gjasave do të jenë gjithnjë e më të mëdha sesa dobishmëria hipotetike që i atribuohet asaj. Përpara këtij realiteti, sot është shumë e vështirë që të mbështeten kriteret racionale të pjekura në shekuj të tjerë për të folur për një "luftë të drejtë" të mundshme. Jo më luftë![242]

259. Është e rëndësishme që të shtojmë se, me zhvillimin e globalizimit, ajo që mund të duket si një zgjidhje e menjëhershme ose praktike për një rajon të caktuar, krijon një zinxhir faktorësh të dhunshëm shumë herë të nëndheshëm, që përfundojnë duke ndikuar në të gjithë planetin dhe duke i hapur rrugë luftërave të reja dhe më të këqija në të ardhmen. Në botën tonë tashmë nuk ka vetëm "copa" lufte në një vend apo në një tjetër, por ne po përjetojmë një "luftë botërore në

copa”, sepse fatet e vendeve janë të lidhura fort me njëra-tjetrën në skenarin botëror.

260. Siç thoshte Shën Gjoni XXIII, “prandaj është gati e pamundur të mendojmë se në epokën atomike lufta mund të përdoret si mjet drejtësie”.[243] Ai e pohoi këtë gjë në një periudhë tensioni të fortë ndërkombëtar dhe kështu i dha zë dëshirës së zjarrtë për paqe, që po përhapej gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë. Forcoi bindjen se arsyet e paqes janë më të forta se çdo llogaritje e interesave të veçanta dhe e çdo besimi që ishte vënë në përdorimin e armëve. Por nuk u shfrytëzuan plotësisht rastet e ofruara prej përfundimit të Luftës së Ftohtë, për shkak të mungesës së një vizioni të së ardhmes dhe të një vetëdijeje të përbashkët për fatin tonë të përbashkët. Në vend të kësaj ndodhi nënshtrimi ndaj kërkimit të interesave të veçanta pa marrë përsipër të mirën e përgjithshme universale. Kështu iu hap përsëri rruga fantazmës mashtruese të luftës.

261. Çdo luftë e lë botën më keq sesa e ka gjetur atë. Lufta është një dështim i politikës dhe i njerëzimit, një dorëzim i turpshëm, një mundje përballë forcave të së keqes. Të mos

ndalemi në diskutime teorike, por të biem në kontakt me plagët, të prekim mishin e atyre që dëmtohen. Ta kthejmë shikimin tonë kah civilët e shumtë të masakruar si "efekte anësore". T'i pyesim viktimat. T'u kushtojmë vëmendje refugjatëve, atyre që kanë pësuar rrezatim atomik apo sulme kimike, grave që kanë humbur fëmijët e tyre, fëmijëve që janë gjymtuar ose privuar nga fëmijëria e tyre. Ta marrim parasysh të vërtetën e këtyre viktimave të dhunës, ta shohim realitetin me sytë e tyre dhe t'i dëgjojmë historitë e tyre me zemër të hapur. Kështu mund ta njohim humnerën e të keqes në zemër të luftës dhe nuk do të na shqetësojë fakti që të na trajtojnë si naivë, sepse kemi zgjedhur paqen.

262. As normat nuk do të jenë të mjaftueshme, nëse mendohet se zgjidhja e problemeve aktuale ka të bëjë me shkëshillimin e të tjerëve përmes frikës, duke i kërcënuar ata me përdorimin e armëve bërthamore, kimike ose biologjike. Në fakt, "nëse merren parasysh kërcënimet kryesore për paqen dhe sigurinë me përmasat e tyre të shumëfishta në këtë botë shumëpolare të shekullit XXI, të tilla si p.sh., terrorizmi, konfliktet asimetrike, siguria informatike,

problematikat mjedisore, varfëria, jo pak dyshime lindin rreth papërshtatshmërisë së frikësimit bërthamor për t'iu përgjigjur në mënyrë të efektshme këtyre sfidave. Shqetësime të tilla marrin akoma më shumë rëndësi kur kemi parasysh pasojat katastrofike humanitare dhe mjedisore, që rrjedhin nga çdo përdorim i mjeteve bërthamore me efekte shkatërruese pa kriter dhe të pakontrollueshme në kohë dhe hapësirë.[…] Gjithashtu duhet ta pyesim veten se sa i qëndrueshëm është një ekuilibër i bazuar te frika, kur ai priret ta shtojë frikën dhe t'i minojë marrëdhëniet e besimit midis popujve. Paqja dhe stabiliteti ndërkombëtar nuk mund të bazohen te një ndjenjë e rreme sigurie, te kërcënimi i një shkatërrimi të ndërsjellë ose asgjësimi total, mbi ruajtjen e thjeshtë të një ekuilibri të fuqive.[...] Në këtë kontekst, objektivi përfundimtar i eleminimit total të armëve bërthamore bëhet njëkohësisht një sfidë dhe një imperativ moral dhe humanitar.[…] Ndërvarësia dhe globalizimi në rritje do të thonë se çfarëdo përgjigjeje t'i japim kërcënimit të armëve bërthamore duhet të jetë kolektive dhe e bashkërenduar, bazuar në besimin e ndërsjellë. Kjo e fundit mund të ndërtohet

vetëm përmes një dialogu që sinqerisht është i orientuar drejt të mirës së përbashkët dhe jo drejt mbrojtjes së interesave të fshehura apo të veçanta”.[244] Dhe me paratë që përdoren në armë dhe shpenzime të tjera ushtarake krijojmë një Fond botëror[245] për të eleminuar më në fund urinë dhe për zhvillimin e vendeve më të varfra, në mënyrë që banorët e tyre të mos përdorin zgjidhje të dhunshme ose mashtruese dhe të mos jenë të detyruar që të largohen nga vendet e tyre për të kërkuar një jetë më dinjitoze.

Dënimi me vdekje

263. Ekziston një mënyrë tjetër për ta eliminuar tjetrin, jo për vendet, por për personat. Është dënimi me vdekje. Shën Gjon Pali II ka deklaruar në mënyrë të qartë dhe të vendosur se është i papërshtatshëm në planin moral dhe nuk është më i nevojshëm në planin penal.[246] Nuk është e mundur që të mendohet tërheqja nga ky pozicion. Sot pohojmë qartë se “dënimi me vdekje është i papranueshëm” [247] dhe Kisha merr përsipër me vendosmëri të propozojë që ai të shfuqizohet në mbarë botën.[248]

264. Në Besëlidhjen e Re, ndërsa u kërkohet individëve të mos bëjnë drejtësi vetë (krh. Rom 12,17.19), ndihet nevoja që autoritetet të vendosin ndëshkime për ata që bëjnë keq (krh. Rom 13,4; 1Pjt 2,14). Në fakt, "jeta e përbashkët, e strukturuar rreth bashkësive të organizuara, ka nevojë për rregulla bashkëjetese, shkelja e lirë e të cilave kërkon një përgjigje të përshtatshme". [249] Kjo sjell që autoriteti legjitim publik mund dhe duhet "të parashikojë dënime sipas rëndësisë së krimeve" [250] dhe t'i garantojë gjyqësorit "pavarësinë e nevojshme sipas ligjit".[251]

265. Që në shekujt e parë të Kishës, disa ishin qartësisht kundër dënimit me vdekje. Për shembull, Latanci argumentoi se "nuk duhet bërë asnjë dallim: gjithmonë do të jetë krim të vrasësh një njeri".[252] Papa Nikolla nxiste: "Përpiquni që ta lironi nga dënimi me vdekje jo vetëm çdo të pafajshëm, por edhe të gjithë fajtorët".[253] Me rastin e gjyqit kundër disa vrasjeve të priftërinjve, Shën Augustini i kërkoi gjykatësit që të mos ua merrte jetën vrasësve dhe e justifikoi këtë gjë në këtë mënyrë: "Me këtë nuk duam të pengojmë që individëve kriminelë t'u hiqet

liria për të kryer krime, por dëshirojmë që për këtë qëllim të mjaftojë, që, duke i lënë gjallë dhe pa i gjymtuar në ndonjë pjesë të trupit, si dhe duke zbatuar ligje për zhdukjen e krimeve, të largohen prej shqetësimeve të tyre të pashëndetshme me qëllim që të çohen përsëri drejt një jete të shëndetshme dhe të qetë, ose që, pasi të largohen prej veprave të tyre të liga të angazhohen në punë të dobishme. Edhe kjo gjë është një dënim, por kush nuk do ta kuptonte se është më shumë një përfitim sesa një torturë, pasi nuk i lihet fushë e lirë guximit të egërsisë dhe as nuk i hiqet ilaçi i pendimit?[...] Indinjohu kundër paudhësisë, por pa harruar njerëzinë; mos e shfryj turrin e hakmarrjes kundër mizorive të mëkatarëve, por ktheje vullnetin tënd për të shëruar plagët e tyre".[254]

266. Frikat dhe inatet e fshehta lehtësisht çojnë në kuptimin e dënimeve në mënyrë hakmarrëse, në mos mizore, në vend që t'i konsiderojë ato si pjesë të një procesi shërimi dhe ri-integrimi shoqëror. Sot, "si nga disa sektorë të politikës, ashtu edhe nga disa media, ndonjëherë nxiten dhuna dhe hakmarrja, publike dhe private, jo vetëm kundër atyre që janë përgjegjës për

kryerjen e krimeve, por edhe kundër atyre mbi të cilët bie dyshimi, i bazuar ose jo, për shkeljen e ligjit.[...] Ekziston prirja për të krijuar qëllimisht armiq: figura stereotipike, të cilat përqendrojnë në vetvete të gjitha karakteristikat që shoqëria i percepton ose i interpreton si kërcënuese. Mekanizmat e formimit të këtyre imazheve janë të njëjtat që, në kohën e vet, lejuan përhapjen e ideve raciste".[255] Kjo e ka bërë veçanërisht të rrezikshëm zakonin gjithnjë e më të pranishëm në disa vende të përdorimit të paraburgosjes, të burgimit pa gjykim dhe sidomos të dënimit me vdekje.

267. Dëshiroj të theksoj se "është e pamundur të imagjinohet që sot Shtetet nuk mund të kenë një mjet tjetër përveç dënimit me vdekje për ta mbrojtur jetën e personave të tjerë nga agresori i padrejtë". Një rëndësi të veçantë kanë ekzekutimet e ashtuquajtura jashtëgjyqësore ose jashtëligjore, të cilat "janë vrasje të qëllimshme të kryera nga disa shtete dhe nga agjentët e tyre, shpesh të paraqitura si përplasje me kriminelë apo si pasoja të padëshirueshme të përdorimit të arsyeshëm, të nevojshëm dhe proporcional të forcës për të zbatuar ligjin".[256]

268. “Argumentet kundër dënimit me vdekje janë të shumta dhe të njohura. Kisha ka theksuar m evend disa prej tyre, si mundësia e ekzistencës së gabimit gjyqësor dhe përdorimi që i bëjnë këtij dënimi regjimet totalitare dhe diktatoriale, të cilët e përdorin atë si një mjet për të shtypur mendimin politik ndryshe ose për të përndjekur pakicat fetare dhe kulturore, të gjitha viktima që sipas ligje të tyre janë “kriminele”. Të gjithë të krishterët dhe njerëzit vullnetmirë janë të thirrur sot që të luftojnë jo vetëm për heqjen e dënimit me vdekje, qoftë i ligjshëm apo i paligjshëm, si dhe në të gjitha format e tij, por edhe për përmirësimin e kushteve të burgjeve, për respektimin e dinjitetit njerëzor të personave të privuar nga liria. Dhe këtë, unë e lidh me burgimin e përjetshëm.[...] Burgimi i përjetshëm është një dënim me vdekje i fshehur”.[257]

269. Duhe të kujtojmë se “as vrasësi nuk e humb dinjitetin e tij personal dhe vetë Hyji hyn garant për të”.[258] Refuzimi i prerë i dënimit me vdekje tregon se deri në ç’pikë është e mundur që të njihet dinjiteti i patjetërsueshëm i çdo qenieje njerëzore dhe të pranohet se ai ka një vend në këtë botë.

Pasi, nëse nuk ia mohoj atë kriminelëve më të këqinj, nuk do t'ia mohoj askujt, të gjithëve do t'ua jap mundësinë për ta bashkëndarë këtë planet me mua, pavarësisht nga ajo që mund të na ndajë.

270. Të krishterët që dyshojnë dhe ndihen të tunduar që t'i nënshtrohen çdo forme dhune, i ftoj që të kujtojnë kumtimin e librit të Isaisë: "Shpatat e veta do t'i kthejnë në plore" (Is 2,4). Për ne kjo profeci mishërohet në Jezu Krishtin, i cili një nxënësi që donte ta mbronte i tha me vendosmëri: "Ktheje shpatën tënde në vend të vet! Sepse të gjithë ata që kapën për shpate, prej shpatës edhe do të vdesin" (Mt 26,52). Ishte një jehonë e atij paralajmërimi të lashtë: "Do të kërkoj llogari prej njeriut për jetën e njeriut, prej secilit gjakun e vëllait të vet. Kush derdh gjakun e njeriut, gjaku i tij të derdhet prej njeriut" (Zan 9,5-6). Ky reagim i Jezusit, që doli spontanisht nga zemra e tij, kapërcen distancën e shekujve dhe arrin sot si një kujtesë e vazhdueshme.

KAPITULLI I TETË

BESIMET FETARE NË SHËRBIM TË VËLLAZËRISË NË BOTË

271. Besimet e ndryshme fetare, duke filluar nga njohja e vlerës së çdo personi njerëzor si krijesë e thirrur për të qenë bir apo bijë e Hyjit, ofrojnë një kontribut të çmuar për ndërtimin e vëllazërisë dhe për mbrojtjen e drejtësisë në shoqëri. Dialogu midis personave me besim të ndryshëm fetar nuk bëhet vetëm për diplomaci, mirësjellje ose tolerancë. Siç kanë mësuar Ipeshkvijtë e Indisë, "objektivi i dialogut është vendosja e miqësisë, e paqes, e harmonisë dhe bashkëndarja e vlerave dhe e përvojave morale e shpirtërore në një shpirt të vërtete dhe dashurie".[259]

Themeli i fundit

272. Si besimtarë mendojmë se, pa një hapje ndaj Atit të të gjithëve, nuk mund të

ketë arsye të forta dhe të qëndrueshme për thirrjen për vëllazërim. Jemi të bindur se "vetëm me këtë vetëdije si bij që nuk janë jetimë mund të jetojmë në paqe mes nesh".[260] Sepse "arsyeja, e vetme, është në gjendje ta kuptojë barazinë mes njerëzve dhe të vendosë një bashkëjetesë shoqërore mes tyre, por nuk arrin ta krijojë vëllazërinë".[261]

273. Në këtë perspektivë, do të doja të kujtoj një tekst të paharrueshëm: "Nëse nuk ekziston një e vërtetë transhendente, duke iu bindur të cilës njeriu fiton identitetin e vet të plotë, atëherë nuk ekziston asnjë parim i sigurt që garanton marrëdhënie të drejta midis njerëzve. Interesi i tyre klasor, grupor dhe kombëtar i vë në mënyrë të pashmangshme kundër njëri-tjetrit. Nëse e vërteta transhendente nuk njihet, atëherë forca e pushtetit triumfon dhe secili tenton t'i përdorë deri në fund mjetet që ka në dispozicion për të diktuar interesin ose mendimin e vet, pavarësisht nga të drejtat e tjetrit.[...] Pra, rrënja e totalitarizmit modern duhet të shihet në mohimin e dinjitetit transhendent të personit njerëzor, shëmbëlltyrë e dukshme e Hyjit të padukshëm dhe, pikërisht për këtë arsye,

për vetë natyrën e vet, subjekt të drejtash që askush nuk mund t'ia dhunojë: as individi, as grupi, as klasa, as kombi dhe as shteti. Nuk mund ta bëjë as shumica e një organi shoqëror, duke u vënë kundër pakicës".[262]

274. Duke u nisur nga përvoja jonë e besimit dhe nga urtia e grumbulluar përgjatë shekujve, duke mësuar edhe nga shumë dobësi dhe dështime tonat, si besimtarë të besimeve të ndryshme fetare e dimë se bërja e pranishme e Hyjit është një e mirë për shoqëritë tona. Kërkimi i Zotit me zemër të sinqertë, për sa kohë që nuk e errësojmë atë me interesat tona ideologjike ose instrumentale, na ndihmon që ta njohim veten si bashkëudhëtarë, vërtet vëllezër. Besojmë se "kur, në emër të një ideologjie, dikush dëshiron ta përjashtojë Zotin nga shoqëria, përfundon duke adhuruar idhuj dhe shumë shpejt njeriu humbet vetveten, dinjiteti i tij është i shkelur, të drejtat e tij të dhunuara. Ju e dini mirë se në çfarë brutalitetesh mund të çojë privimi i lirisë së ndërgjegjes dhe i lirisë fetare dhe se si nga kjo plagë njerëzimi varfërohet rrënjësisht, sepse i mungon shpresa dhe referimet ideale".[263]

275. Duhet të njihet se "ndër shkaqet më të rëndësishme të krizës të botës moderne janë ndërgjegjja njerëzore e anestetizuar dhe largimi nga vlerat fetare, si dhe mbizotërimi i individualizmit dhe i filozofive materialiste që hyjnizojnë njeriun dhe vendosin vlerat e botës dhe ato materiale në vend të parimeve supreme dhe transhendente".[264] Nuk është e pranueshme që në debatin publik të kenë zë vetëm të pushtetshmit dhe shkencëtarët. Duhet të ketë një hapësirë për reflektimin që buron nga një sfond fetar, që përmbledh shekuj përvoje dhe mençurie. "Tekstet fetare klasike mund të ofrojnë një domethënie që i drejtohet çdo epoke dhe zotërojnë një fuqi motivuese që hap gjithnjë horizonte të reja, nxit të menduarit, zgjeron mendjen dhe perceptueshmërinë".[265]

276. Për këto arsye, edhe pse Kisha respekton autonominë e politikës, ajo nuk e syrgjynos misionin e vet në sferën private. Përkundrazi, "nuk mund dhe nuk duhet as që të mbetet anash" në ndërtimin e një bote më të mirë, as të neglizhojë që "t'i rizgjojë forcat shpirtërore"[266] të cilat mund të ngjizin tërë jetën shoqërore. Është e vërtetë që mbarështuesit fetarë nuk duhet të merren

me politikë partiake, tipike e laikëve, por as nuk mund të heqin dorë nga përmasa politike e ekzistencës[267], që kërkon një vëmendje të vazhdueshme ndaj të mirës së përbashkët dhe shqetësimin për zhvillimin tërësor njerëzor. Kisha "ka një rol publik që nuk kufizohet në aktivitetet e saj të ndihmës apo të edukimit", por që vihet "në shërbim të nxitjes së njeriut dhe të vëllazërisë universale".[268] Nuk aspiron të konkurrojë për pushtete tokësore, por përkundrazi që të ofrohet si "një familje midis familjeve - kjo është Kisha -, e hapur për t'i dëshmuar [...] botës së sotme fe, shpresë dhe dashuri për Zotin dhe për ata që Ai do në mënyrë përzgjedhëse. Një shtëpi me dyer të hapura. Kisha është një shtëpi me dyer të hapura, sepse ajo është nënë".[269] Dhe si Maria, Nëna e Jezusit, "duam të jemi një Kishë që shërben, që del nga shtëpia, që lë tempujt e vet, sakrestitë e veta, për të shoqëruar jetën, për të mbështetur shpresën, për të qenë shenjë njësie [...] për të hedhur ura, për të prishur mure, për të mbjellë pajtim".[270]

Identiteti i krishterë

277. Kisha e vlerëson veprimin e Hyjit në

besimet e tjera fetare dhe "nuk hedh poshtë asgjë që është e vërtetë dhe e shenjtë në këto fe. Ajo i vlerëson me një respekt të sinqertë ato mënyra veprimi e jete të feve të tjera, ato norma e doktrina që […] jo rrallë reflektojnë një rreze të asaj të vërtete që ndriçon të gjithë njerëzit".[271] Megjithatë si të krishterë nuk mund ta fshehim se "nëse muzika e Ungjillit pushon së vibruari në brendësinë tonë, atëherë do ta humbim gëzimin që buron nga dhembshuria, butësinë që vjen nga besimi, aftësinë e pajtimit që e gjen burimin e vet në vetëdijen se jemi të falur-të dërguar. Nëse muzika e Ungjillit pushon së luajturi në shtëpitë tona, në sheshet tona, në vendin e punës, në politikë dhe në ekonomi, do ta kemi fikur melodinë që na shtynte të luftonim për dinjitetin e çdo burri dhe të çdo gruaje".[272] Të tjerë pinë në burime të tjera. Për ne, ky burim i dinjitetit njerëzor dhe i vëllazërisë është Ungjilli i Jezu Krishtit. Prej tij "buron për mendimin e krishterë dhe për veprimin e Kishës parësia që i jepet marrëdhënies, takimit me misterin e shenjtë të tjetrit, bashkësisë universale me të gjithë njerëzimin si thirrje e të gjithëve".[273]

278. E thirrur për t'u mishëruar në çdo

situatë dhe për të qenë e pranishme përgjatë shekujve në çdo vend të tokës - kjo do të thotë "katolike" -, Kisha mund ta kuptojë, duke filluar nga përvoja e saj e hirit dhe e mëkatit, bukurinë e ftesës për dashuri universale Në fakt, "gjithçka që është njerëzore ka të bëjë me ne.[...] Kudo ku konsensuset e popujve bashkohen për të vendosur të drejtat dhe detyrat e njeriut, ne jemi të nderuar, kur të na e lejojnë, të ulemi mes tyre".[274] Për shumë të krishterë, kjo ecje vëllazërie ka edhe një Nënë, me emrin Mari. Ajo e ka marrë në këmbët e Kryqit këtë amësi universale (krh. Gjn 19,26) dhe vëmendja e saj është drejtuar jo vetëm ndaj Jezusit, por edhe ndaj "tepricës së pasardhësve të saj" (Zb 12,17). Me fuqinë e të Ngjallurit, dëshiron të lindë një botë të re, ku të gjithë jemi vëllezër, ku ka një vend për çdo të skartuar nga shoqëritë tona, ku shkëlqejnë drejtësia dhe paqja.

279. Si të krishterë kërkojmë që, në vendet ku jemi pakicë, të garantohet liria, ashtu si ne e favorizojmë atë për ata që nuk janë të krishterë atje ku ata janë pakicë. Ekziston një e drejtë themelore e njeriut që nuk duhet harruar në ecjen e vëllazërimit dhe të paqes: është liria fetare për besimtarët

e të gjitha besimeve fetare. Kjo liri tregon se mund "të gjejmë një marrëveshje të mirë mes kulturave dhe feve të ndryshme; dëshmon se gjërat që kemi të përbashkëta janë aq të shumta dhe të rëndësishme sa është e mundur të identifikohet një udhë bashkëjetese të paqtë, të rregullt dhe paqësore, në pranimin e dallimeve dhe në gëzimin se jemi vëllezër, sepse jemi bij të një Hyji të vetëm".[275]

280. Në të njëjtën kohë, le t'i kërkojmë Hyjit që ta forcojë njësinë në Kishë, njësi e pasuruar nga larmi që pajtohen përmes veprimit të Shpirtit Shenjt. Në fakt, "në një të vetmin Shpirt Shenjt të gjithë jemi pagëzuar për të qenë një trup i vetëm" (1Kor 12,13), ku secili jep kontributin e vet të veçantë. Siç thoshte Shën Augustini, "veshi sheh përmes syrit dhe syri dëgjon përmes veshit".[276] Po ashtu, është urgjente që të vazhdojmë të japim dëshmi të një ecjeje takimi midis konfesioneve të ndryshme të krishtera. Nuk mund ta harrojmë dëshirën e shprehur nga Jezusi: "që të gjithë të jenë një" (Gjn 17,21). Duke dëgjuar ftesën e tij, me dhimbje pranojmë se në procesin e globalizimit mungon ende kontributi profetik dhe shpirtëror i njësisë mes të gjithë

të krishterëve. Megjithatë, "edhe pse jemi ende në ecje drejt bashkimit të plotë, që tani kemi për detyrë të ofrojmë një dëshmi të përbashkët të dashurisë së Hyjit për të gjithë, duke bashkëpunuar në shërbim të njerëzimit".[277]

Besimi fetar dhe dhuna

281. Mes besimeve fetare është e mundur që të bëhet një rrugë paqeje. Pika e nisjes duhet të jetë shikimi i Hyjit. Sepse "Hyji nuk shikon me sytë e tij, Hyji shikon me zemrën e tij. Dhe dashuria e Hyjit është e njëjtë për çdo person, i çfarëdo feje që të jetë. Dhe nëse ai është ateist, është e njëjta dashuri. Kur do të vijë dita e fundit dhe në tokë do të ketë dritë të mjaftueshme për t'i parë gjërat ashtu siç janë, do të kemi shumë surpriza!".[278]

282. Edhe "besimtarët kanë nevojë të gjejnë hapësira për të dialoguar dhe për të vepruar së bashku për të mirën e përbashkët dhe për promovimin e më të varfërve. Nuk bëhet fjalë që të bëhemi të gjithë më *light* apo t'i fshehim besimet tona, me të cilat jemi më të lidhur, në mënyrë që të takohemi me të tjerët që mendojnë ndryshe.[...] Sepse

sa më i thellë, më i fortë dhe më i pasur që të jetë identiteti ynë, aq më shumë ai do të jetë në gjendje që t'i pasurojë të tjerët me kontributin e tij të veçantë".[279] Si besimtarë, ndihemi të shtyrë që të kthehemi në burimet tona për t'u përqendruar te thelbi: adhurimi i Hyjit dhe dashuria për të afërmin, në mënyrë që disa aspekte të doktrinës sonë, jashtë kontekstit të tyre, të mos ushqejnë forma përbuzjeje, urrejtjeje, ksenofobie, mohimi të tjetrit. E vërteta është se dhuna nuk e ka bazën e vet në bindjet themelore fetare, por në shtrembërimet e tyre.

283. Adhurimi i Zotit, i sinqertë dhe i përulur, "nuk çon në diskriminim, urrejtje dhe dhunë, por në respektimin e shenjtërisë së jetës, në respektimin e dinjitetit dhe të lirisë së të tjerëve dhe në angazhimin dashamirës për mirëqenien e të gjithëve".[280] Në realitet, "kush nuk ka dashuri, nuk e ka njohur Hyjin, sepse Hyji është dashuri" (1Gjn 4,8). Prandaj, "terrorizmi i urryer që kërcënon sigurinë e njerëzve, si në Lindje ashtu edhe në Perëndim, si në Veri ashtu edhe në Jug, duke përhapur panik, terror dhe pesimizëm nuk është për shkak të fesë - edhe nëse terroristët e shfrytëzojnë

atë - por është për shkak të interpretimeve të gabuara të teksteve fetare, të politikave të urisë, të varfërisë, të padrejtësisë, të shtypjes, të arrogancës; për këtë arsye është e nevojshme që të ndalohet mbështetja e lëvizjeve terroriste përmes mosfurnizimit të tyre me para, armë, plane ose justifikime, madje edhe përmes mosmbulimit mediatik, dhe të gjitha këto të konsiderohen si krime ndërkombëtare, që kërcënojnë sigurinë dhe paqen botërore. Një terrorizëm i tillë duhet të dënohet në të gjitha format dhe shfaqjet e tij".[281] Bindjet fetare në lidhje me kuptimin e shenjtë të jetës njerëzore na lejojnë që "të njohim vlerat themelore të njerëzimit të përbashkët, vlera në emër të të cilave mund dhe duhet të bashkëpunojmë, të ndërtojmë dhe të dialogojmë, të falim dhe të rritemi, duke bërë të mundur që të gjithë zërat e ndryshëm të formojnë një këngë fisnike dhe harmonike, në vend të britmave fanatike të urrejtjes".[282]

284. Nganjëherë dhuna fondamentaliste shpërthen në disa grupe të çfarëdo besimi fetar nga pakujdesia e udhëheqësve të tyre. Sidoqoftë, "urdhërimi i paqes është shkruar në thellësitë e traditave fetare që

